

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

P nr. 42/14

PP.I. nr. 103/2013

12 shkurt 2015

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, në trupin gjykues të përbërë prej gjyqtares së EULEX-it Franciska Fiser, si kryetare e trupit gjykues, Gjyqtari i EULEX-it Nuno Manuel Ferreira De Madureira dhe gjyqtari i EULEX-it Paulo Duarte De Mesquita Teixeira, me zyrtarin ligjor të EULEX-it Jana Božović si procesmbajtëse në rastin penal kundër:

Đ. K., emri i babait H., emri i vajzërisë i nënës H. S., i lindur më _____ në _____, me vendbanim në _____, në lagjen “_____” , pa numër, kombësia _____, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, _____ me profesion, i punësuar si _____, me zyre _____, gjendje të mesme ekonomike, në paraburgim që nga 3 qershori 2013;

Akuzuar për:

Akuza 1 Keqpërdorimi seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet, në kundërshtim me nenin 198, paragrafi (1) në lidhje me paragrafin (5), nën-paragrafin (3) të Kodit Penal të Kosovës (tani e tutje: KPK);

Akuza 2 Mundësimi i prostitucionit, në kundërshtim me nenin 201, paragrafi (4) në lidhje me paragrafin (1) dhe neni 20 i KPK;

Akuza 3 Sulmi seksual, në kundërshtim me nenin 195, paragrafi (4) në lidhje me paragrafin (1) të KPK;

Akuza 4 Keqpërdorimi seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet, në kundërshtim me nenin 198, paragrafi (1) në lidhje me paragrafin (5), nën-paragrafi (3) dhe (4) i KPK;

Akuza 5 Dhunimi, në kundërshtim me nenin 193, paragrafi (4) në lidhje me paragrafin (2) nën-paragrafi (2) i KPK;

Akuza 6 Dhunimi, në kundërshtim me nenin 193, paragrafi (3) nën-paragrafi (4) i KPK;

Akuza 7 Sulmi seksual, në kundërshtim me nenin 195, paragrafi (2) nën-paragrafi (2) dhe (3) në lidhje me nenin 20 të KPK;

Akuza 8 Dhunimi, në kundërshtim me nenin 193, paragrafi (2) nën-paragrafi (3) i KPK; dhe

Akuza 9 Mundësimi ose detyrimi në prostitucion, në kundërshtim me nenin 241, paragrafi (3) i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tani e tutje: KPRK);

Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, i mbyllur për publikun, më 15, 16, 17 dhe 20 tetor 2014, më 10 nëntor 2014, më 2, 8 dhe 9 dhjetor 2014, më 27 dhe 28 janar 2015, më 11 shkurt 2015, në prani të avokatit mbrojtës të **D. K.**, avokati i tij mbrojtës Kapllan Baruti dhe Habib Hashani, prokurori i EULEX-it Lili Oprea Steluta, përfaqësuesi i palës së dëmtuar Burhan Maxhuni, duke u bazuar në aktvendimin në bazë të kërkesës së prokurorit për masa mbrojtëse të datës 8 shtator 2014 gjatë dëshmisë së dëshmitareve të palëve të dëmtuara A. F. më 16 tetor dhe 8 dhjetor 2014, N. T. më 17 tetor dhe 8 dhjetor 2014, A. L. më 20 tetor dhe 8 dhjetor 2014, S. N. më 10 nëntor dhe 9 dhjetor 2014 dhe dëshmitarja H. P. më 17 tetor dhe 8 dhjetor 2014, R. A. 20 tetor dhe 8 dhjetor 2014 dhe B. F. më 2 dhjetor 2014 i pandehuri ishte zhvendosur nga salla e gjyqimit;

Pas shqyrtimit nga trupi gjyqësor dhe votimit të mbajtur më 11 shkurt 2015;

Pas shpalljes së aktgjyqimit në publik në bazë të neneve 359 dhe 366 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (tani e tutje: KPPK) më 12 shkurt 2015 dhe në prezencë të akuzuarit, avokatit mbrojtës të tij dhe prokurorit të EULEX-it ;

Në bazë të neneve 369 dhe 370 të KPPK;

Vendos si në vijim:

AKTGJYKIM

I.

Nën akuzën 1

D. K. gjendet **FAJTOR** pasi që :

Është dëshmuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri në data të panjohura në mes të _____ dhe _____, në shtëpinë e tij në _____, në lagjen “_____”, duke e ditur moshën e saj, ka pasur më shumë se një herë marrëdhënie seksuale me S. N., të lindur më _____.

PRANDAJ, **D. K.** është **DËNUAR** për kryerjen e veprës penale *Keqpërdorimi seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet*, në kundërshtim me nenin 198, paragrafi (1) i KPK, duke e ri kualifikuar akuzën origjinale të *Keqpërdorimit seksual të personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet*, në kundërshtim me nenin 198, paragrafi (1) në lidhje me paragrafin (5), nën –paragrafin (3) të KPK.

Nën akuzën 2

D. K. gjendet **FAJTOR** pasi që:

Është dëshmuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri në data të panjohura në mes të _____ dhe _____ në shtëpinë e tij me lokacion në lagjen “_____”, i ka propozuar S.N., e lindur më _____, që të ketë marrëdhënie seksuale me persona të panjohur, në mesin e tyre edhe me personel tjerë të UNMIK-ut, vëllain e tij dhe një person serb, për një shumë prej 50 eurove, e cila shumë do të ndahej në pjesë të barabarta ne mes të pandehurit dhe palës së dëmtuar S.N., por pala e dëmtuar ka refuzuar të bëjë këtë.

PRANDAJ, **D. K.** është **DËNUAR** për kryerjen e veprës penale tentim për mundësim të prostitucionit, në kundërshtim me nenin 201, paragrafi (4) në lidhje me paragrafin (1) dhe nenin 20 të KPK.

Nën akuzën 3

D. K. gjendet i **PAFAJSHËM** pasi që:

Nuk është provuar përtej dyshimit të bazuar se në datat dhe kohët e panjohura në _____, në veturën e tij të tipit "_____" i pandehuri e ka prekur me qëllim seksuale të miturën S.T., e cila ishte 15 vjeçare, në mënyrën në vijim: përderisa i pandehuri ishte duke e ngase veturën e tij, e mitura S.T. ishte ulur në ulësen e bashkë vozitësit, përderisa pala e dëmtuar S.N. ishte ulur në ndenjësën e pasme. I pandehuri kishte filluar ta përkëledh me qëllime seksuale palën e dëmtuar S.T. në këmbën e saj të majtë.

PRANDAJ, D. K. LIROHET nga akuza për kryerjen e veprës penale të Sulmit seksual, në kundërshtim me nenin 195, paragrafi (4) në lidhje me paragrafin in (1) të KPK.

Nën akuzën 4

D. K. gjendet i **PAJASHËM** pasi që:

Nuk është provuar përtej dyshimit të bazuar se më datën _____ në të njëjtin vend si në akuzën 1 të dispozitivit, i pandehuri e ka detyruar palën e dëmtuar nën moshën 16 vjeçare, për të kryer marrëdhënie seksuale dhe me qëllim e ka dehur me alkool personin nën moshën 16 vjeçare-palën e dëmtuar-të miturën S.T. e cila ishte 15 vjeçare me qëllim të mposhtje së rezistencës së saj dhe duke ia treguar armën e zjarrit, një pistoletë të markës dhe kalibrit të panjohur, të cilën ai e ka mbajtur në dollap dhe e ka incizuar marrëdhënien seksuale me video kamerë.

PRANDAJ, **Đ. K. LIROHET** nga akuza për kryerjen e veprës penale Keqpërdorimi seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet, në kundërshtim me nenin 198, paragrafi (1) në lidhje me paragrafin (5), nën paragrafin (3) dhe (4) i KPK.

Nën akuzën 5

Đ. K. gjendet i **PAFAJSHËM** pasi që :

Nuk është dëshmuar përtej dyshimit të bazuar, se në datën dhe kohën e panjohur më ____ deri në _____ në vendin si në akuzën 1 të dispozitivit, e ka detyruar palën e dëmtuar S.T. 16 vjeçare për të kryer marrëdhënie seksuale pa pëlqimin e saj. Duke e ditur se ajo është 16 vjeçare, i pandehuri ka kërkuar që ajo të kryej marrëdhënie seksuale me te dhe kur pala e dëmtuar, e mitura S.T. ka refuzuar, i pandehuri me qëllim e ka dehur me alkool me qëllim të mposhtjes së rezistencës nga ana e saj dhe i ka treguar armën e zjarrit, pistoletë e markës dhe kalibrit të panjohur duke i thënë asaj: “Askush nuk mund të më bëjë asgjë, as _____ e as policia pasi që unë i mbaj të gjithë ata në xhep” dhe në këtë mënyrë, ka arrite që ta frikëson palën e dëmtuar S.T., duke e detyruar atë që të kryej marrëdhënie seksuale me të pa dëshirën e saj, për shkak të kësaj ndodhie pala e dëmtuar S.T. ka shkuar në shtëpi të saj dhe tentuar të vetëvritet duke pirë hapa për qetësim dhe Domestos dhe si rezultat i kësaj ajo ishte shtruar në spital”.

PRANDAJ, **Đ. K. LIROHET** nga akuza se ka kryer veprën penale të Dhunimit, në kundërshtim me nenin 193, paragrafi (4) në lidhje me paragrafin (2) nën paragrafi (2) i KPK .

Nën akuzën 6

Đ. K. gjendet i **PAFAJSHËM** pasi që :

Nuk është dëshmuar përtej dyshimit të bazuar se në pranverën e vitit _____ rreth orës ____:____ në shtëpinë e tij në pjesën _____ të _____ me lokacion në lagjen “_____”, i pandehuri e ka detyruar palën e dëmtuar N. T. të kryej marrëdhënie seksuale me të pa

pëlqimin e saj, duke e dehur atë me disa substanca të dyshimta, në atë mënyrë që ka bërë një marrëveshje verbale paraprakisht për shumën prej 20 eurove, që ajo ta pastron shtëpinë e tij të vendosur në pjesën veriore, kështu që i pandehuri e ka dërguar në shtëpinë e tij atë dhe fillimisht ia ka përgatitë një kafe dhe pala e dëmtuar posa e ka pirë atë kanë filluar të iu merren mendtë dhe i ka humbur ndjenjat dhe i pandehuri duke e shfrytëzuar gjendjen e saj të dobët ka kryer marrëdhënie seksuale me të dhe e ka incizuar aktin me kamerë.

PRANDAJ, Đ. K. LIROHET nga akuza se ka kryer veprën penale të Dhunimit, në kundërshtim me nenin 193, paragrafi (3) nën paragrafi (4) i KPK.

Nën akuzën 7

Đ. K. gjendet **FAJTOR** pasi që :

Është dëshmuar përtej dyshimit të bazuar se në fund të muajit ____ ____ në një vend të panjohur në fshatin _____ – Komuna e _____, i ka propozuar dhe e ka dërguar palën e dëmtuar A. L., të lindur më __ ____ ____, një studente, e kombësisë shqiptare kosovare, e cila asnjëherë nuk ka qenë vetëm në _____ dhe ka vuajtur prej një sëmundjeje të lëkurës- akneve në fytyrën e saj, me veturën e tij te një specialist për lëkurë, një doktor ____ në _____ (J. I.) e cila e ka specifikuar diagnozën dhe terapinë. Pas konsultimit me doktorin, përshkrimi i terapisë është marrë nga i pandehuri. Pas kërkimit të medikamenteve në _____ dhe _____, rrugës për në fshatin _____, i pandehuri e ka ndalur veturën e tij afër një pompe të benzinës dhe ka kërkuar nga pala e dëmtuar që në këmbim të medikamenteve të blera nga ai, ajo duhet të kryej marrëdhënie seksuale me të dhe ai ka filluar ta prekë atë në gjoks dhe ka tentuar ta puth. Pala e dëmtuar ka refuzuar këtë dhe ka filluar të bërtas dhe të qaj, ka ikur nga vetura dhe ka tentuar që të kërcej nga ura..

PRANDAJ, Đ. K. është **DENUAR** për kryerjen e veprës penale të Tentim Sulmit Seksual, në kundërshtim me nenin 195, paragrafi (2) nën –paragrafi (3) në lidhje me nenin 20 të KPK, në këtë mënyrë duke e *ri-kualifikuar* akuzën origjinale të tentim Sulmit

Seksual , në kundërshtim me nenin 95, paragrafi (2) nën paragrafi (2) dhe (3) në lidhje me nenin 20 të KPK .

Nën akuzën 8

D. K. gjendet **FAJTOR** pasi që :

Është dëshmuar përtej dyshimit të bazuar se në fund të vitit ____ deri më ____ në shtëpinë e tij të vendosur në lagjen _____ në _____, i pandehuri e ka detyruar palën e dëmtuar A. F0 që të vazhdoj të kryen disa herë marrëdhënie seksuale me të pa pëlqimin e saj, i pandehuri e ka kërcënuar se do të shpërndaj fjalën se ajo ka pasur marrëdhënie seksuale me te në mënyrë që familja e saj ta kuptoj këtë, ai do të shkonte në shtëpinë e saj, do ta turpëronte, do t'i tregonte vëllezërve të saj për marrëdhënien e tyre.

PRANDAJ, **D. K. DËNOHET** për kryerjen e veprës penale të Dhunimit, në kundërshtim me nenin 193, paragrafi (1) i KPK; prandaj duke e *ri-kualifikuar* akuzën origjinale të Dhunimit, në kundërshtim me nenin 193, paragrafi (2) nën-paragrafi (3) i KPK.

Nën akuzën 9

D. K. gjendet **i PAFAJSHËM** pasi që :

Nuk është dëshmuar përtej dyshimit të bazuar se në kohën e panjohur që nga _____ deri më ____ në vendin si në akuzën 1 të dispozitivit me qëllim të përfitimit të paligjshëm për vetvete, ai e ka kërcënuar palën e dëmtuar A. F. për të kryer një akt, kështu që fillimisht i ka dhënë palës së dëmtuar kohë pas kohe para në shuma prej 20 – 50 euro dhe kur pala e dëmtuar i ka thënë se dëshiron ti ndërprejë kontaktet me të, i pandehuri e ka kërcënuar rëndë atë dhe e ka detyruar atë që të kryej marrëdhënie seksuale me të në këmbim të 900 eurove, kur pala e dëmtuar i ka kërkuar atij që t'ia jep dy muaj kohë deri sa të gjen një punë, ai i ka thënë ' një natë seks me mua , dhe 5 euro do të hiqen nga shuma e borxhit tënd'".

PRANDAJ, **Đ. K.** LIROHET nga akuza se ka kryer veprën penale të Mundësimi ose detyrimi në prostitucion në kundërshtim me nenin 241, paragrafi (3) në lidhje me nenin 228, paragrafi (8) i KPRK.

II.

1. PRANDAJ, në bazë të dispozitave të nenit 36, paragrafi (1) nën paragrafi (2) dhe neni 38, paragrafët (1) dhe (2) të KPK, gjykata cakton dënimet në vijim:

- **Đ. K.** pas dënimit për veprën penale nën Akuzën 1 **DËNOHET** me 5 vjet burgim; dhe
- **Đ. K.** pas dënimit për veprën penale nën Akuzën 2 **DËNOHET** me 3 vjet burgim; dhe
- **Đ. K.** pas dënimit për veprën penale nën Akuzën 7 **DËNOHET** me 3 vjet burgim; dhe
- **Đ. K.** pas dënimit për veprën penale nën Akuzën 8 **DËNOHET** me 6 vjet burgim.

2. Në bazë të nenit 71, paragrafi (2) nën paragrafi (2) i KPK gjykata e cakton dënimin **UNIK** në vijim:

Đ. K. DËNOHET me 14 vjet burgim.

III.

Në bazë të neneve 365, paragrafi (1) nën paragrafi (1.5) i KPPK koha e kaluar në paraburgim nga **Đ. K.** nga 3 qershori 2013 deri sa Aktgjykimi të merr formën e prerë, do të llogaritet në dënim.

IV.

Gjykata **URDHËRON** që veturat _____, me ngjyrë ____ me tabelat e regjistrimit __-__-__ dhe _____, me ngjyrë të ____ me tabelat e regjistrimit __-__-__ që janë konfiskuar përkohësisht nga Policia, të kthehen menjëherë pasi që aktgjykimi në këtë rast të merr formën e prerë.

V.

Në bazë të nenit 453, paragrafët (1) dhe (2) i KPPK, **Đ. K.** do të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 300 eurove jo më vonë se 30 ditë nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

VI.

Në bazë të neneve 458, 459, 460 dhe 463, paragrafët (1) dhe (2) të KPPK, kërkesa pronësore juridike e paraqitur nga dëshmitarët R. A. dhe H. P. janë refuzuar, palët e dëmtuara S. N., N. T. dhe A. L. udhëzohen që mund të vazhdojnë me kërkesat pronësore juridike në kontest civil.

Arsyetimi

I. Historiku procedural

1. Më 31 mars 2014, Prokurori shtetëror i Prokurorisë Themelore me zyre në Mitrovicë ka paraqitë aktakuzën PP.I. nr. 103/2013 kundër të pandehurit për veprat penale Keqpërdorimi seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet, në kundërshtim me nenin 198, paragrafi (1) në lidhje me paragrafin (5), nën-paragrafin (3) të Kodit Penal të Kosovës ; Dhunim, në kundërshtim me nenin 193, paragrafi (4) në lidhje me paragrafin (2) nën paragrafin (3) i KPK; Trafikimi me qenie njerëzore, në kundërshtim me nenin 139, paragrafi (1) dhe (2) në lidhje me paragrafin (7) dhe neni 20 i KPK; Sulm seksual , në kundërshtim me nenin 195, paragrafi (4) në lidhje me paragrafin (1) të KPK;

Keqpërdorimi seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet, në kundërshtim me nenin 198, paragrafi (1) në lidhje me paragrafin (5), nën paragrafin (3) dhe (4) të KPK; Dhunim, në kundërshtim me nenin 193, paragrafi (4) në lidhje me paragrafin (2) nën paragrafin (2) i KPK; Dhunim, në kundërshtim me nenin 193, paragrafi (3) nën paragrafi (4) i KPK; Sulm seksual , në kundërshtim me nenin 195, paragrafi (2) nën paragrafi (2) dhe (3) në lidhje me nenin 20 të KPK; Dhunim, në kundërshtim me nenin 193, paragrafi (4) në lidhje me paragrafin (2) nën paragrafi (3) i KPK; Detyrim, në kundërshtim me nenin 340, paragrafi (1) i KPK.

2. Më 15 prill 2014, Presidenti i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it e ka caktuar rastin në fjalë te gjyqtarët e EULEX-it në Gjykatën Themelore në Mitrovicë në pajtim me Ligjin mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë ¹ (tani e tutje: Ligji nr. 03/L-053).
3. Më 29 maj 2014, dëgjimi i parë mbi aktakuzën është mbajtur në bazë të nenit 245 të KPK, në të cilin i akuzuari është deklaruar i pafajshëm për veprat penale të lartshënuara.
4. Në dëgjimin fillestar të Aktakuzës, i pandehuri **D. K.** ka ngritë çështjet e përkthimeve në lidhje me versionin në shqip dhe anglisht të aktakuzës. Kryetari i trupit gjykues ka kërkuar që Prokurori të përgjigjet te trupi gjykues në lidhje me këto çështje dhe se cili version është në origjinal në gj. shqipe apo angleze. Më 3 qershor 2014, prokurori shtetëror Zejnije Kela në bashkëpunim me prokurorin e EULEX-it Neeta Amin, kanë hartuar aktakuzën në gj. Shqipe dhe është paraqitë në gjykatë dhe ndaj palëve . Të dy versionet e Aktakuzës janë kontrolluar thellësisht dhe janë korrigjuar. Versioni në gj. angleze dhe shqipe janë origjinale në bazë të nenit 16 të Ligjit nr. 03/L-053.
5. Afati kohor prej 30 ditësh në bazë të nenit 245, paragrafi (5) i KPPK është caktuar për parashtresat me shkrim mbi çfarëdo kundërshtimi të provave apo kërkesa për të hedhur poshtë Aktakuzën. Më 23 qershor 2014, avokati mbrojtës i ka paraqitur parashtresat e tyre. Më 15 korrik , prokurori shtetëror ka paraqitur përgjigjen në parashtresat e mbrojtjes. Më 25 korrik 2014, Kryetari i trupit gjykues ka nxjerr aktvendimin, duke e aprovuar pjesërisht kërkesën e mbrojtjes për të hedhur poshtë Aktakuzën dhe ka dorëzuar rastin për shqyrtim gjyqësor. Nga i njëjti aktvendim, kryetari i trupit gjykues i ka refuzuar

¹ Ligji nr. 03/L-053

të gjitha kundërshtimet për pranueshmërinë e provave si të pabazë, dhe gjithashtu e ka hedhur poshtë akuzën për Dhunim nga neni 193, paragrafi (4) në lidhje me paragrafin (2) nën paragrafi (3) i KPK si në akuzën 2 të dispozitivit.

6. Shqyrtimi gjyqësor ishte mbajtur i mbyllur për publikun më 15, 16, 17 dhe 20 tetor 2014, më 10 nëntor 2014, më 2, 8 dhe 9 dhjetor 2014, më 27 dhe 28 janar 2014 dhe më 11 shkurt 2015.
7. Vendimi është shpallur më 12 shkurt 2015.
8. Në bazë të nenit 369, paragrafi (1) i KPK me nxjerrjen e aktvendimit nga kryetari i gjykatës themelore GJA.Nr.99/2015 të datës 27 shkurt 2015 afati kohor për aktgjykim që të hartohet është zgjatuar për 60 ditë më shumë.

II. Kompetenca e gjykatës

9. Në bazë të nenit 11 dhe nenit 9, paragrafi (2) i Ligjit mbi gjykata, Gjykata Themelore në Mitrovicë është organi kompetent gjyqësor për të gjykuar këtë rast penal.
10. EULEX i ka kompetencat mbi këtë rast në bazë të Ligjit nr. 04/L-273 për Ndryshim Plotësimin e Ligjeve në lidhje me mandatin e Misionit të Bashkësisë Evropiane për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës (tani e tutje: Ligji mbi kompetencat), Marrëveshjes në mes të Shefit të Misionit të EULEX-it dhe Këshilli Gjyqësor të Kosovës mbi Aspektet Relevante të Aktiviteteve dhe Bashkëpunimit të gjyqtarëve të EULEX-it dhe prokurorëve në Kosovë të datës 18 qershor 2014 (tani e tutje: Marrëveshja) dhe Vendimi për Aproximin e Kërkesave nga EULEX-i për vazhdimin e gjykimeve në lidhje me rastet të cilat i janë caktuar Gjyqtarëve të EULEX-it në mes të 15 prillit dhe 30 majit të vitit 2014 në Gjykatën Themelore në Mitrovicë të datës 2 korrik 2014 (tani e tutje: Vendimi).
11. Trupi Gjykues përbëhet prej Gjyqtarës së EULEX-it Franciska Fiser, duke vepruar si Kryetare e trupit gjykues dhe Gjyqtari i EULEX-it Nuno Manuel Ferreira De Madureira dhe Gjyqtari i EULEX-it Paulo Duarte De Mesquita Teixeira si anëtar të trupit gjykues.
12. Prokurori shtetëror në ankesën e datës 15 shtator 2014 e ka kundërshtuar përbërjen e trupit gjykues dhe ka pohuar se në bazë të nenit 51 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur

trupi gjykues duhet të përbëhet prej gjyqtareve për të mitur në mënyrë që të mbrohen të drejtat e palës së dëmtuar të cilat kanë qenë të moshës së mitur.

13. Gjykata e Apelit në aktvendimin e saj të datës 9 tetor 2014 në pikën 'J' në mes tjerash ka deklaruar se , “Trupi gjykues vlerëson se para se të merrej ky vendim, rasti iu ka caktuar departamentit për të mitur në gjykatën e Mitrovicës. Prandaj rasti iu është caktuar gjyqtarëve të EULEX-it pavarësisht prej kërkesës në Kodin e Drejtësisë për të Mitur që rasti të gjykohet nga trupi gjykues për te mitur.” Dhe në pikën 'K' Gjykata e Apleit iu ka referuar Marrëveshjes në bazë të cilit aktualisht e ka caktuar trupin gjykues të gjyqtarëve të EULEX-it duhet të vazhdoj dhe të shqyrtojë rastin dhe ta gjykoj.
14. Prokurori i EULEX-it në seancën e cila është mbajtur më 15 tetor 2014 e ka kundërshtuar përsëri juridiksionin e trupit gjykues pasi që gjyqtarët e EULEX-it nuk kane juridiksion të trupit gjykues pasi që gjyqtarët e EULEX-it nuk kanë juridiksion me dispozita ligjore për këtë rast për shkak të arsyeve në vijim. Së pari, gjyqtarët e EULEX-it nuk mund ta bazojnë juridiksionin e tyre në nenin 3, nën-paragrafin (1) dhe (3.1) të Ligjit mbi Juridiksionin pasi që ata janë caktuar për rastin aktual, duke u bazuar në kërkesën e të pandehurit, vetëm me datën 15 prill 2014 dhe jo para datës 15 prill 2014. Përveç kësaj, Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk e ka një autoritet të tillë. Dhe së dyti , prokurori ka qenë i mendimit se në bazë të dispozitave të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, në bazë të nenit 51, paragrafit (1), përbërja e trupit gjykues duhet të jetë, kryetari i trupit gjykues me qenë gjyqtar për të mitur, dhe dy gjyqtarë laik.
15. Pasi që Gjykata e Apelit në vendimin e saj të datës 9 tetor 2014 tashme i ka marrë në konsideratë të dy argumentet e paraqitura nga prokurori, trupi gjykues në seancën e datës 15 tetor 2014 e ka refuzuar kundërshtimin e prokurorit. Përveç kësaj trupi gjykues gjithashtu e ka theksuar se në nenin 2, nën paragrafin (2.3) të Ligjit mbi juridiksionin ku është paraparë “sipas nevojës, aspektet relevante të aktivitetit dhe bashkëpunimit të gjyqtarëve të EULEX-it me gjyqtarët që punojnë në gjykatat vendore do të përcaktohen me tutje, për aq sa është e nevojshme, me anë të një marrëveshje të veçantë ndërmjet Shefit të EULEX KOSOVË dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës.
Duke u bazuar në dispozitën e cituar, marrëveshja e veçantë në mes të Shefit të EULEX-it në Kosovë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës është nënshkruar më 18 qershor 2013, e cila parasheh edhe fazën kalimtare; kjo nënkupton periudhën në mes të 15 prillit dhe 30

majit 2014. Dhe duke u bazuar në këtë marrëveshje të veçantë , një vendim i veçantë është nxjerrë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës më 2 korrik 2014, ku në pikën 2 është listuar edhe rasti penal P.Nr. 42/14.

III. Ligji i zbatueshëm

16. Në bazë të nenit 539 të KPPK, Kodi i procedurës i cili aplikohet gjatë shqyrtimit gjyqësor është KPK.
17. Megjithatë, më 1 janar 2013 KPRK ka hyrë në fuqi. Në bazë të nenit 3, paragrafi (1) i këtij Kodi, ligji në fuqi në kohën kur është kryer vepra penale, do të zbatohet. Në rast të ndje ndryshimi në ligjin e zbatueshëm të një rasti të caktuar para marrjes së vendimit përfundimtar në bazë të paragrafit 2 të të njëjtit nen, çështja e ligjit më të favorshëm do të vlerësohet në vazhdimësi të arsyetimit me shkrim të aktgjykimit.

IV. Shqyrtimi gjyqësor

18. Seancat e shqyrtimit gjyqësor janë mbajtur më 15, 16, 17 dhe 20 tetor 2014, më 10 nëntor 2014, më 2, 8 dhe 9 dhjetor 2014, më 27 dhe 28 janar 2015 dhe më 11 shkurt 2015.
19. Të gjitha dëgjimet kane qene te mbyllura për publikun duke u bazuar në aktvendimin e datës 8 shtator 2014, të nxjerrë. Në bazë të kërkesës së prokurorit për masat mbrojtëse. Në bazë të të njëjtit aktvendim , i pandehuri është larguar nga salla e gjykimit gjatë dëshmimeve të dëshmitareve të palës së dëmtuar A. F. më 16 tetor 2014, N. T. më 17 tetor 2014, A. L. më 20 tetor 2014 dhe S. N. më 10 nëntor 2014, dhe dëshmitarja H. P. më 17 tetor 2014 dhe R. A. më 20 tetor 2014.
20. E drejta e të pandehurit për t'i bërë pyetje dëshmitarëve është plotësuar në mënyrën në vijim. Dëshmitaret janë marrë në pyetje në bazë të dispozitave të KPPK, nenit 333, nenit

334 dhe nenit 335. Të pandehurit më vonë i janë dhënë procesverbalet e përkthyer në gj. shqipe dhe i është dhënë një afat kohor për t'i përgatitur pyetjet për dëshmitaret. Pyetjet së pari janë shqyrtuar nga trupi gjykues; në bazë të nenit 258, paragrafi (2) i KPPK, pyetjet jo relevante, të përsëritura dhe të panevojshme janë përjashtuar; të tjerat i janë parashtruar dëshmitareve në dëgjimet që janë mbajtur më 8 dhe 9 dhjetor 2014.

21. Dëshmitarja B. F. është propozuar nga prokurori gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe e ka dhënë dëshminë e saj në dëgjimin e mbajtur më 2 dhjetor 2014. Përderisa e ka dhënë dëshminë, e njëjta masë mbrojtëse e urdhëruar si në aktvendimin e datës 8 shtator 2014 është zbatuar. Avokat mbrojtës është pajtuar që nuk ka pasur shkelje materiale për mbrojtjen dhe se është vepruar tërësisht në bazë të aktvendimit të nxjerrë 8 shtator 2014.
22. Pala e dëmtuar S. T. dhe dëshmitari Xh. S. nuk kanë qenë të disponueshme për gjykatën . Prokurori ka propozuar që të lexohen deklaratat të cilat janë dhëne gjatë hetimeve; dëshmitarja S. T. deklarata e dhënë në polici më 13 gusht 2013 dhe prokurori më 4 shtator 2013, dëshmitarja Xh. S. deklarata e dhënë në polici më 24 maj 2014. Trupi gjykues e ka refuzuar² propozimin e prokurorit pasi që deklaratat e dhënë në polici dhe prokurori nuk i plotësojnë kushtet në bazë të nenit 338, paragrafi (1) i KPPK . Trupi gjykues gjen se deklaratat nuk janë marrë si një dëshmi në bazë të nenit 132 të KPPK. Përveç kësaj, s ai përket S. T., trupi gjykues konsideron se i pandehuri dhe avokati i tij mbrojtës nuk janë informuar në mënyrë të duhur në lidhje me intervistën e dëshmitarit.
23. Në fjalën hyrëse³ mbrojtja e kanë refuzuar pranueshmërinë e kallëzimit penal nr. 2013-DHTQNJ-43 të datës 6 qershor 2013, raporti i oficerit të policisë, i datës 4 qershor 2013 dhe raporti informues më 8 dhe 12 mars 2013. Sa i përket raportit informues të datës 12 mars 2013, prokuroria me parashtrësën e datës 25 nëntor kanë shpjeguar se në aktakuzë është bërë një gabim teknik dhe në vend të datës 12 mars 2013 duhet të jetë data 12 prill 2014.
24. Ndonëse, dokumentet e cituara nuk kanë fuqinë e provave në kuptimin ligjor penal, pasi që ato janë akte zyrtare për qëllime të informimit të brendshëm deh sit ë tilla në bazë të nenit 361 paragrafi (2) i KPPK, të gjitha këto prova nuk kanë kuptimin e provave

² Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 9 dhjetor 2014, faqet 9 dhe 10.

³ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i mbajtur më 15 tetor 2014.

procedurale, në bazë të të cilave gjykata mund ta bazon aktgjykimin apo vendimin e procedurave gjyqësore, trupi gjykues në dëgjimin e mbajtur më 9 dhjetor ⁴ 2014 ka vendosë që provat e tilla nuk mund të shpallën si të papranueshme.

25. Duke u bazuar në të njëjta arsye trupi gjykues e ka refuzuar ⁵ kërkesën e mbrojtjes dhe i ka shpallur provat në vijim si të pranueshme: Raporti informativ i policisë në faqe 235, Raporti informativ i policisë në faqet 237 deri 239, Raporti informativ në faqet 333 dhe 334, Raporti i oficerit në faqe 480, Raporti njoftues në faqet 482 dhe 483, Raporti i oficerit në faqe 486, Njoftimi mbi ndërmarrjen e veprimit në faqe 488, Raporti Informativ në faqet 492 dhe 493, Lista e provave në faqe në faqet 496, njoftimi mbi veprimet hetuese në faqet 566 dhe 567 dhe njoftimi mbi masat e fshehta dhe teknike të hetimeve në faqet 570 dhe 571.
26. Gjatë shqyrtimit gjyqësor i pandehuri e ka dhënë deklaratën e tij më 27 dhe 28 janar 2015.
27. Administrimi i provave është bërë më 28 janar 2015.
28. Në shqyrtimin gjyqësor që është mbajtur më 28 janar 2015 prokurori në bazë të nenit 350 të KPPK e kanë ndryshuar aktakuzën verbalisht siç vijon.⁶ Sa i përket akuzës së parë të dispozitivit, pjesa e fjalisë “ Që nga mesi i viti ____ deri në _____ ” është zëvendësuar me “Nga data _____ deri më _____”. Në akuzën e dytë fjalët “Stafi i _____” janë fshirë dhe akuza është ri-kualifikuar në veprë penale të Mundësimit të prostitucionit, në kundërshtim me nenin 201, paragrafi (1) dhe (4) në lidhje me nenin 20 të KPK. Në lidhje me akuzën 3 përshkrimi faktik është zëvendësuar me tekstin “ Në kohët të panjohur në _____, në veturën e tij _____ i pandehuri e ka prekur me qëllime seksuale të miturën S.T., e cila ishte 15 vjeçare, në mënyrën në vijim: përderisa i pandehuri ishte duke e ngasë veturën e tij, e mitura S.T. ishte ulur në ulësen e bashkë-voztësit , ndërsa pala e dëmtuar S.N. ishte ulur në ulësen e pasme. I pandehuri kishte filluar ta përkëledh në këmbën e majtë palën e dëmtuar S.T.” Sa i përket akuzës katër data “ _____ ” është zëvendësuar me datën “ _____.” Në akuzën 5 pas fjalisë së fundit, është shtuar një fjali e re “Për shkak të kësaj kur pala e dëmtuar S.T ka shkuar në shtëpi, ajo ka tentuar të bëjë vetëvrasje duke pirë hapa për

⁴ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 9 dhjetor 2014, faqe 9.

⁵ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 9 dhjetor 2014, faqe 11.

⁶ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor i mbajtur më 28 janar 2015, faqe 32.

qetësim dhe Domestos dhe si rezultat i kësaj ajo është shtruar në spital. “ Në akuzën 7 emri i palës së dëmtuar “A. L.” është shtuar . Prokurori e ka ri-kualifikuar akuzën 8 në veprën penale të Dhunimit në kundërshtim me nenin 193, paragrafi (2) nën-paragrafi (3) e KPK. Dhe përfundimisht prokurori e ka ri-kualifikuar akuzën 9 the në veprën penale të Mundësimit apo detyrimit në prostitucion në kundërshtim me nenin 241, paragrafi (3) sa i përket nenit 228, paragrafi (8) i KPK.

29. Aktgjykimi është shpallur më 12 shkurt 2015.

V. Lisat e provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

30. Gjatë zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor , janë dëgjuar palët e dëmtuara në vijim:

- A. F.;
- N. T.;
- A. L.;
- S. N.;
- H. P.;
- R. A.; dhe
- B. F..

31. Dokumentet në vijim janë pranuar si prova dhe lexuar në procesverbal:

- Procesverbali i intervistimit të palës së dëmtuar S. N., faqet 64-68 dhe 74-77;
- Procesverbali i intervistimit të palës së dëmtuar R. A., faqet 82-84 dhe 88-91;
- Procesverbali i intervistimit të palës së dëmtuar H. P., faqet 101-104;
- Procesverbali i intervistimit të palës së dëmtuar A. L., faqet 109-111 dhe 115-119;
- Procesverbali i intervistimit të palës së dëmtuar A. F., faqet 125-127 dhe 131-134;
- Procesverbali i intervistimit të dëshmitarit N. J., faqet 155-157 dhe 161-163;
- Procesverbali i intervistimit të dëshmitarit B. F., faqet 167-169;
- Procesverbali i intervistimit të palës së dëmtuar N. T., faqet 173-177 dhe 183-185;

- Certifikata mbi konfiskimin e përkohshëm të gjësendeve, faqe 196;
- Albumi me foto, faqe 198 – 210;
- Raporti i ekspertizës nga laboratorit mbi ekspertizën e kompjuterëve , faqet 211-212;
- Raporti i kontrollit të lokaleve, shtëpive dhe personave, faqet 215-216;
- CD nga laboratorit e vendosur në mes të faqeve 222 dhe 223;
- Raporti i ekzaminimit të veturës, faqet 227-228;
- Raporti i kontrollit të lokaleve, shtëpive dhe personave, faqet 231-232;
- Raporti informativ i policisë, faqe 235;
- Raporti informativ i policisë, faqet 237-239;
- Transkriptat, faqet 281-316;
- Raporti informativ, faqet 333-334;
- Përgjigje nga qendra komunale e regjistrimit civil, faqet 337-338;
- Certifikata e lindjes e S. T., faqe 343;
- Certifikata e lindjes e S. N., faqe 344;
- Certifikata e lindjes e Xh. S., faqe 345;
- Certifikata e lindjes e H. P., faqe 346;
- Certifikata e lindjes e A. L., faqe 347;
- Certifikata e lindjes e R. A., faqe 348;
- Certifikata e lindjes e N. T., faqe 349;
- Kopja e letërnjoftimit dhe pasaportës së N. T., faqe 353;
- Kopja e letërnjoftimit dhe pasaportës së R. A., faqe 354;
- Kopja e letërnjoftimit dhe pasaportës së H. P., faqe 355;
- Kopja e letërnjoftimit dhe pasaportës së A. L., faqe 356;
- Certifikata e lindjes së A. F., faqe 362;
- CD-të nga IPKO, Z-MOBILE dhe VALA të vendosura në mes të faqeve 369-370;
- Lista e SMS-ve nga Z mobile, faqet 406-407;
- Lista e SMS-ve nga Z mobile, faqe 410;
- Raporti i oficerit , faqe 480;
- Raporti njoftues, faqet 482-483;
- Raporti i oficerit , faqe 486;
- Njoftim mbi veprimet e ndërmarra, faqe 488;

- Raporti informativ, faqet 492-493;
- Lista e provave, faqe 496;
- Raporti i kontrollit, faqe 501;
- Certifikata mbi konfiskimin e gjësendeve, faqe 508;
- Të dhënat nga operatori IPKO, faqe 518;
- Të dhënat nga operatori Z-MOBILE, faqe 520;
- Të dhënat nga operatori Z-MOBILE, faqe 526;
- Të dhënat nga operatori IPKO, faqe 528;
- Të dhënat nga operatori PTK, faqe 530;
- Të dhënat nga operatori PTK, faqe 532;
- Të dhënat nga operatori IPKO, faqe 536;
- Njoftimi mbi veprimet hetuese faqe 566-567; dhe
- Njoftim: masat e fshehta dhe teknike të hetimeve, faqe 570-571.

VI. Gjetjet faktike dhe analiza e provave

A. Akuza 1

32. Nën akuzën 1, i pandehuri është akuzuar që ai nga data __ _____ __ deri më __ _____ __, në shtëpinë e tij të vendosur në _____, lagjen “ _____ - _____ ”, e ka detyruar personin nën moshën 16 (gjashtëmbëdhjetë) vjeçare për të kryer marrëdhënie seksuale me të në atë menysë që e ka kërcënuar se ai do t’i vras anëtarët e familjes së tij, vëllain e saj dhe babain si dhe të miturën nëse ajo refuzon të ketë marrëdhënie seksuale me të dhe i ka treguar armën e zjarrit, një pistoletë të zezë të një marke dhe kalibrit të panjohur, të cilën e ka mbajtur në dollap në dhomën e ndejës dhe pastaj e ka incizuar me kamerë marrëdhënien me të; në këtë mënyrë duke e kryer veprën penale Keqpërdorimi seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet, në kundërshtim me nenin 198, paragrafi (1) në lidhje me paragrafin (5), nën –paragrafin (3) të KPK.
33. Nga deklarata e S. N. në shqyrtimin gjyqësor më __ _____ __ rezulton se ajo ishte 15 vjeçare kur është njoftuar me të pandehurin për herë të parë. Ajo është njoftuar

me të përmes shoqes së saj S. T., e cila e ka prezantuar atë si daja i saj. I pandehuri ka ardhur me një ____ të ____ dhe i ka marr në veturë S. N. dhe S. T. në sallonin ku ka punuar S. N.. Ata janë vozitur me veturë dhe kur i pandehuri ka filluar ta prekë S. T., S. N. e ka kuptuar se i pandehuri nuk është daja i S. T.⁷.

34. Dëshmitarja S. N. ka theksuar se pak para se me i mbushur 18 vjet, ajo është fejuar dhe në atë kohë ajo i ka ndërprerë kontaktet me të⁸.
35. Ajo ishte në klasën e 8-të, kur është njoftuar për herë të parë me të pandehurin. Ajo nuk e ka përfunduar shkollën fillore, ajo është dashur të shkojë edhe në klasën e 9-të por e ka braktisë shkollën dhe ka filluar të punojë⁹.
36. Dëshmitari gjithashtu ka theksuar se i pandehuri e ka ditë se ajo ishte 15 vjeçare. Kur ai e ka kuptuar moshën e saj, ai ka thënë “ se edhe fëmijët e sotit dinë gjithçka.”¹⁰ Ishte dëshmia e saj se i pandehuri e ka pyetur për moshën e saj dhe ajo i ka treguar se është 15 vjeç.¹¹
37. Herën tjetër kur S. N. është takuar me të pandehurin pas një jave pas takimit të parë. S. T. i është drejtuar dëshmitares S. N. dhe i ka thënë asaj se i pandehuri e ka ftuar me dal së bashku S. N. n.¹² Kur S. N. ka thënë se ajo nuk mund të del me një person të moshuar si ai, i pandehuri ka insistuar duke thënë se ajo duhet të dal me të përndryshe ai do ti ndërmerr veprimet e tij, duke i thënë dëshmitares se “kushdo që hip në veturën e ti do të bëhet e tij”; “do të kalojnë mirë”; “do të kënaqesh”; ai ka theksuar se ai ka para.¹³
38. Në këtë takim in e dytë, i pandehuri i ka dërguar ato, S. N. dhe S. T., në shtëpinë e tij në veri. Ai ka filluar të kryej marrëdhënie seksuale me S. T., dhe pastaj ju ka drejtuar S. N. dhe ka kërkuar të njëjtën gjë prej saj. Në fillim S. N. ka refuzuar të ketë seks me të por i pandehuri i ka thënë të zhvishet; ajo ka dashur të ikë prej shtëpisë por dera ka qenë e mbyllur. I pandehuri e ka kapur atë, e ka dërguar në dhomë dhe ia ka

⁷ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 10 nëntor 2014, faqe 5.

⁸ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 10 nëntor 2014, faqe 12.

⁹ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 10 nëntor 2014, faqe 17.

¹⁰ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 10 nëntor 2014, faqe 6.

¹¹ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 10 nëntor 2014, faqe 17.

¹² Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 10 nëntor 2014, faqe 18.

¹³ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 10 nëntor 2014, faqe 19.

drejtuar pistoletën asaj,¹⁴ të cilën e ka mbajtur nën krevet.¹⁵ Me këtë, i pandehuri e ka shtyrë atë që të kryej marrëdhënie seksuale me të dhe pastaj i ka lënë atë dhe S. T. në vendin ku i ka marrë në fillim me veturë.

39. Pas kësaj ndodhie i pandehuri e ka nxitë vazhdimisht S. N. që të del me të. S. N. ka theksuar se ajo ka pasur marrëdhënie seksuale me të pandehurin tre apo katër herë në javë në një periudhë prej 2 vjet e gjysmë , përafërsisht 3 vjet, zakonisht gjatë pauzës së tij në orën __:__.¹⁶
40. S. N. ka theksuar se ajo është detyruar që të kryej marrëdhënie seksuale me të pandehurin. Ai e ka thirrë në telefon atë, ajo e ka ndërruar numrin e telefonit por ai e ka gjetur numrin e telefonit përsëri. ¹⁷ Në fillim i pandehuri e ka kërcënuar atë në lidhje me familjen e saj; më vonë ai e ka kërcënuar atë me incizime dhe fotografi.¹⁸ I pandehuri e ka thirrë në telefon atë; ai e ka ftuar atë për të dalë dhe kur ajo ka refuzuar, ai ka thënë se do të shkonte te vëllai i saj dhe babai, se ai do ti publikon në internet incizimin dhe fotografitë.¹⁹
41. S. N. ka dëshmuar se njëherë i pandehuri ka shkuar në shtëpi të saj; ai është shfaqur në derë të saj dhe kur babai i saj ka dalë jashtë, ai është larguar . Pastaj ai i ka dërguar mesazh me tekst dëshmitares duke i thënë” mos mendo se jam duke bërë shaka ”.²⁰
42. Dëshmitarja ka dhënë dëshmi se ajo nuk ka pasur guxim që t’i tregonte të vërtetën familjes së saj; ajo ka theksuar se pos qe se do të kishte guximin për t’i treguar atyre të vërtetën, ajo nuk e kishte lejuar të pandehurin që të luante me të për një kohë aq të gjatë; ajo ishte një fëmijë 15 vjeçare dhe duke e marrë parasysh se ishte shumë e re, ajo i ajo i ka marrë shumë seriozisht kërcënimet e tij.²¹
43. Ajo ka qenë ende 16 vjeçare kur i pandehuri ka hyrë në sallon dhe i ka thënë nënës së saj “ vajza e juaj mi ka borxh 180 euro”. Dhe nëna e saj i ka thënë “Unë nuk besoj që ajo të ka borxh ty,” pasi që ajo ishte e befusuar se si një person i vjetër sa ai kishte ardhur për vajzën e saj. I pandehuri pastaj i ka thënë nënës së saj “ vajza e juaj duhet të mi kthej

¹⁴ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 10 nëntor 2014, faqe 10 dhe 20.

¹⁵ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 10 nëntor 2014, faqe 16.

¹⁶ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 10 nëntor 2014, faqet 7 dhe 12.

¹⁷ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 10 nëntor 2014, faqe 5.

¹⁸ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 10 nëntor 2014, faqe 25.

¹⁹ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 10 nëntor 2014, faqe 21.

²⁰ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 10 nëntor 2014, faqe 26.

²¹ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 10 nëntor 2014, faqe 15.

paratë pasi që ajo e din se çka mund të shfrytëzoj une kundër saj .” dhe “mos e lejo vajzën tënde që të nxitë me i postuar ato në internet; pasi që unë mund të jem i keq nëse dua.”²² Pastaj S. N. i ka treguar nënës së saj në lidhje me kërcënimet; por ajo nuk i ka treguar haptas të gjitha pasi që nuk i ka treguar hollësisht.²³ Më vonë kur ka kuptuar edhe vëllai i saj në lidhje me kërcënimet, nëna e saj dhe vëllai e kanë raportuar të pandehurin në polici. Policia e kanë marrë në pyetjet atë, por nuk kanë ndërmarrë asgjë. S. N. i ka parë personat para të cilëve e ka dhënë dëshminë se kishin biseduar me të pandehurin .²⁴ Kur babai i saj e ka kuptuar se si qëndron puna në lidhje me të pandehurin, ai e ka detyruar dëshmitaren të tregon për të gjitha; por edhe atëherë dëshmitarja nuk ka pasur guxim që të i tregon të gjitha pasi që e ka konsideruar të pandehurin si shumë të rrezikshëm dhe për shkak të kërcënimeve të tij ajo nuk ka pasur guxim të flas .²⁵

44. S. N. nuk i kujtohej se sa herë ka pasur marrëdhënie seksuale me të pandehurin para se t'i mbushte 16 vjet dhe se sa here ka kryer marrëdhënie pasi që i ka mbushur 16 vjet. Së paku katër herë në javë ai e ka thirre atë dhe i ka ardhur asaj në sallon; ka ndodhë që ai ka thirre edhe dy herë në ditë .²⁶ Ka ndodhur shpeshherë që S. N., S. T. dhe i pandehuri kanë pasur sek së bashku .²⁷ Dëshmitarja ka theksuar se shumicën e kohës i pandehuri i ka ofruar asaj alkool; dhe pastaj ajo është ndier e dobët, ajo nuk është ndier mirë.²⁸ Ajo ka dëshmuar se ajo e ka kaluar dy herë natën në shtëpinë e tij gjatë tërë periudhës .²⁹
45. I pandehuri kishte fotografi dhe incizime të saj por dëshmitarja ka dëshmuar se ajo nuk ishte në dijeni për këtë.³⁰
46. Gjatë shqyrtimit gjyqësor më 9 dhjetor 2014 S. N. është përgjigje në pyetjet e përgatitura i pandehuri, të cilat ishin relevante për akuzat dhe kanë shpjeguar disa mospërputhje në deklaratat e saja që i janë dhënë prokurorit dhe në gjykatë. Para Prokurorit³¹ S. N. ka dëshmuar se i pandehuri “ka shkuar në shtëpinë time dhe i ka thënë babait tim, vajza e juaj i ka harruar ndërresat e brendshme tek .” Në gjykatë ajo ka dëshmuar “Ai ka ardhur

²² Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 10 nëntor 2014, faqe 25.

²³ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 10 nëntor 2014, faqe 26.

²⁴ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 10 nëntor 2014, faqe 11.

²⁵ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 10 nëntor 2014, faqe 11.

²⁶ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 10 nëntor 2014, faqe 12.

²⁷ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 10 nëntor 2014, faqe 14.

²⁸ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 10 nëntor 2014, faqe 15.

²⁹ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 10 nëntor 2014, faqe 15.

³⁰ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 10 nëntor 2014, faqe 26.

³¹ Procesverbali i intervistës së pales së dëmtuar-viktimës, dosja 1, faqe 76.

në derën time dhe mi ka treguar ato mua .” Dëshmitari ka shpjeguar se i pandehuri ka ardhur në sallon– në fillim i floktarisë , ku ajo ishte së bashku me S. T., ai është ndalur te dera e sallonit dhe i ka treguar asaj ato gjëra dhe pas asaj, ai ka shkuar te shtëpia e saj dhe aty babi i saj ka dalë jashtë dhe i pandehuri i ka gjuajtur ato ndërresa në tokë, duke i treguar babait të S. N. se “këto i takojnë vajzës tënde ” dhe pastaj ai është larguar .³²

47. Deklarata nga S. N. është mbështetur nga deklaratat e dëshmitares R. A., A. L., H. P. dhe A. F..

48. R. A. e ka dhënë deklaratën gjatë shqyrtimit gjyqësor të datës 20 tetor 2014 dhe 8 dhjetor 2014. Ajo ka dëshmuar se e ka njohur S. N. si dhe H. P. që nga shkolla fillore , klasa e 3-të apo e 4-të.³³ R. A. ka theksuar se ajo kishte qenë 15 apo 16 vjeçare, kur ajo, H. P. dhe S. N. janë njoftuar me të pandehurin; H. P. kishte qenë pak më e vjetër , përderisa S. N. kishte qenë më e re se R. A..³⁴ R. A. gjithashtu ka deklaruar se ishte shoqe me S. N., jo shoqe të ngushta ; por kishte dalë ndonjëherë jashtë me S. N. dhe shoqet tjera dhe gjithashtu edhe në një rast me të pandehurin. Ato ishin të reja dhe të prira që të voziteshin me vetura.³⁵

49. A. L. ka dhënë deklaratë s më 20 tetor 2014 dhe 8 dhjetor 2014. Në deklaratën e saj të parë, ajo ka theksuar se përderisa ishin duke u kthyer nga mjeku, i pandehuri i ak treguar asaj se ka pasur seks me S. N. dhe se R. A. ishte e dashura e tij e vetme .³⁶

50. H. P. ka dëshmuar më 17 tetor 2014 dhe ka konfirmuar se ajo ka dalë me të pandehurin dhe se edhe S. N. i është bashkëngjitë atyre . S. N. në atë kohë ishte rreth 14 deri në 15 vjeçare ³⁷. H. P. gjithashtu ka dëshmuar se ajo nuk ka pasur shumë raste të rin me S. N. por ajo ka dëgjuar më pas se S. N. do të dilet me ta në veturën e të pandehurit. Ajo gjithashtu i a ka parë ata vetëm një herë .³⁸ H. P. nuk ishte shoqja e saj e ngushtë, ato nuk kishin pasur shumë biseda por në anën tjetër ata kanë kaluar shumë kohë së bashku.³⁹

³² Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 9 dhjetor 2014, faqe 6.

³³ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 20 tetor 2014, faqe 4.

³⁴ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 20 tetor 2014, faqe 5.

³⁵ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 20 tetor 2014, page 9.

³⁶ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 20 tetor 2014, page 23.

³⁷ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 17 tetor 2014, faqet 5 dhe 13.

³⁸ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 17 tetor 2014, faqet 8 dhe 9.

³⁹ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 17 tetor 2014, faqe 16.

51. A. F. para Prokurorit më 4 qershor 2013 ka theksuar se i pandehuri i ka thënë asaj se si i ka dërguar të brendshmet e S. N. në shtëpinë e saj; babai i saj ishte shfaqur në derë; ai kishte qarë kur i pandehuri i kishte thënë atij se shiko se çfarë vajze e ke.⁴⁰
52. Pohimet se i pandehuri e kishte një armë e kanë konfirmuar edhe dëshmitaret N. T. dhe A. F., edhe pse ato kanë deklaruar se e ka mbajtur armën në dollap.⁴¹
53. Për gjykatë është me rëndësi gjithashtu fakti se deklaratat e dhëna nga S. N. gjatë fazës së hetimeve, në pikat e tujre më të rëndësishme, të mos e kundërshtojnë deklaratën e saj që është dhënë gjatë shqyrtimi gjyqësor. Ajo ia ka dhënë deklaratën policisë më 27 mars 2013 dhe ajo ka deklaruar se është njoftuar me të pandehurin kur i ka pasur 15 vjet. Ajo është njoftuar me ate përmes shoqes së saj S. T. e cila në atë kohë ishte 14 vjeçare. Para policisë ajo ka theksuar se pas tre muajve më vonë pasi që është njoftuar me të pandehurin , ai i ka dërguar ato të dyja së bashku me S. T. në shtëpinë e tij në veri. Kur ata kanë hyrë brenda, ai fillimisht i ka thënë atyre se nuk duhet të frikësohen pasi që nuk ka kamera në shtëpi dhe pastaj ai ka filluar ta zhveshë S. T. dhe të kryen marrëdhënie seksuale me të. Pastaj i ka kërkuar S. N. që të zhvishet dhe të kryen seks edhe me të. Por S. N. nuk ka pranuar dhe ka dashur të ikë por i pandehuri e ka mbyllur derën nga brenda dhe iu ka kërcënuar asaj dhe në një moment e ka nxjerrë armën e tij nga sofa dhe iu ka kërcënuar asaj duke i thënë se askush nuk mund t'i ndihmojë asaj , as policia pasi që ai kishte njerëz që i njihje në polici.⁴² S. N. ka theksuar se ajo kishte qenë shumë e frikësuar dhe për këtë arsye ajo ka pranuar të kryen marrëdhënie seksuale me të pandehurin dhe njëkohësisht edhe me S. T..
54. S. N. ka dhënë deklaratën e saj në prokurori më 31 tetor 2013. Ajo ka konfirmuar përsëri se ajo kishte qenë 15 vjeçare kur është njoftuar me të pandehurin dhe se ajo është takuar me të përmes shoqes së saj S. T.. Ajo ka deklaruar se i pandehuri e ka përcjell ate dhe iu ka kërcënuar. Sa i përket kërcënimeve, ajo ka theksuar se i pandehuri ka kërkuar para nga ajo, duke e ngritë shumën; ai ka shkuar ne sallonin e floktarisë së nënës së saj dhe i ka thënë se S. N. i ka borxh atij para, me fjalët “më mirë e ke me mi kthyer

⁴⁰ Procesverbal i intervistës së palës së dëmtuar-viktimës, dosja 1, faqe 133.

⁴¹ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 17 tetor 2014, faqe 24 dhe Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 16 tetor 2014, faqe 7.

⁴² Procesverbal i intervistës së palës së dëmtuar-viktimës, dosja 1, faqe 65.

paratë përndryshe do të kesh probleme me mua .”⁴³ Ajo gjithashtu ka theksuar se nuk e ka ditur se ai ka incizuar me kamerë dhe se ka fotografuar. Në një moment ajo nuk iu është përgjigjur në telefon, ai iu është kërcënuar se do ta vriste vëllain e saj, njëherë i ka dërguar ndërresat e saj në shtëpi të saj dhe iu ka treguar ato prindërve të saj duke iu thënë se “vajza e juaj i ka harruar të brendshmet e saja në shtëpinë time ”.

55. Gjykata konsideron se deklarata e dhënë nga S. N. gjatë shqyrtimit gjyqësor më 10 nëntor 2014 dhe 9 dhjetor 2014 është e besueshme dhe e mbështetur me provat tjera. Ajo ka dhënë shpjegime të hollësishme të fakteve esenciale; dëshmitë e saja janë në konsistencë me provat tjera. Deklarata e saj është e besueshme dhe është pranuar si e saktë nga trupi gjykues .
56. Është fakt se në deklaratën e saj para policisë S. N. ka deklaruar se ajo dhe S. T. kanë pasur marrëdhënie seksuale me të pandehurin tre muaj pasi që janë njoftuar me të për të parën herë. Para trupit gjykues ajo ka theksuar se kjo ka ndodhur vetëm një javë më pas. Përkundër mospërputhjeve të tilla për trupin gjykues deklarata e S. N. është ende e besueshme. Kur ajo e ka dhënë deklaratën në polici, kujtesa e saj ishte më e freskët; përveç kësaj nga përgjigjet e saj para trupit gjykues mund të konsiderohen se ajo nuk ishte sigurve për kohën e saktë. Por nisur nga fakti se deklarata e saj ishte konsistente kur ka deklaruar se ka pasur marrëdhënie seksuale me të pandehurin përderisa ajo ishte ende më e re se 16 vjet, është me rëndësi dhe bindëse.
57. I pandehuri ka deklaruar gjatë shqyrtimit gjyqësor më 27 janar 2015 se S. N. është njoftuar me të përmes S. T. dhe se ai ka pasur marrëdhënie seksuale me S. N. dy vite pasi që janë njoftuar , ka ndodhur në mesin e qershorit 2011. Para kësaj kohe, ata kanë pasur kontakte të kohë pas kohshme, sepse S. N. ka pasur një të dashur me emrin Zh.. Ata dilnin së bashku me S. T. dhe vëllain e saj të vogël; më vonë ata janë afruar më shumë dhe kanë filluar të kenë marrëdhënie seksuale. ⁴⁴
58. I pandehuri ka deklaruar se duke u bazuar në certifikatën e saj të lindjes, e cila ka hyrë në shkresat e lëndës, S. N. ishte 17 vjeçare dhe një muaj kur ata kanë pasur marrëdhënie seksuale për herë të parë. Pas marrëdhënies së parë seksuale, ata nuk kanë vazhduar me marrëdhënie intime, pasi që S. T. i ka treguar të dashurit të S. N. për ata të dy

⁴³ Procesverballi i intervistës së palës së dëmtuar-viktimës, dosja 1, faqe 76.

⁴⁴ Procesverballi i shqyrtimit gjyqësor më 27 janar 2015, faqe 3.

dhe në atë pikë ata e kanë ndërprerë në njëfarë mënyre marrëdhënien e tyre dhe pas dy apo tri ditësh i pandehuri gjithashtu është ndarë nga S. N.. Ata e kanë filluar marrëdhënien e tyre në fund të muajit ____ dhe ata kanë pasur marrëdhënie seksuale për herë të fundit më ____; tre ditë pasi që ishte fejuar S. N..⁴⁵

59. I pandehuri gjithashtu kishte deklaruar se nuk ka pasur nevojë që ta detyron S. N. apo dëshmitaret tjera; në veçanti jo me S. N. dhe S. T., pasi që ato kishin propozuar për të kryer marrëdhënie seksuale me to.⁴⁶

60. S ai përket ngjarjes kur i pandehuri i ka sjellë të brendshmet e S. N. në dyqanin e floktarisë së nënës së saj, i pandehuri ka deklaruar se kjo ka ndodhur në fillim; ndoshta një muaj apo dy pasi që ata janë njoftuar me njëri tjetrin. S. N. i ka kërkuar atij që të ushtron në veturën e tij dhe ata janë pajtuar për një pagesë prej 10 eurove për një orë. Një të shtunë ajo ka vozitur veturën për pesë orë dhe ajo është dashur të paguajë 50 euro për këtë. Për disa ditë me radhë S. N. nuk i është përgjigje në telefon dhe kur ajo është përgjigje , ajo ka thënë “bisedo me nënën time.” I pandehuri ka biseduar me nënën e S. N. e cila i ka thënë “ përse ia ke dhënë veturën tënde asaj me vozitë, ajo nuk ka faj dhe nuk ka para” dhe gjëra të tilla. S. T. ishte me të pandehurin dhe i ka thënë se në telefon nuk kishte qenë nëna e S. N. dhe se shoqja e S. N., F. është shtirë kinse është nëna e saj. Pas disa ditësh kur S. T. ka bërë shaka në lidhje me këtë, i pandehuri ka shkuar te nëna e S. N. në sallonin e saj të floktarisë për të sqaruar këtë çështje. Ai është takuar me S. N. dhe nënën e saj në dyqan, ato ishin duke e lyer dyqanin dhe ai i ka shpjeguar nënës së S. N. në lidhje me telefonatën dhe se S. N. i ka borxh atij para. I pandehuri ka theksuar se nëna e S. N. nuk ishte e vetëdijshme për këtë dhe ajo kishte thënë “ përse ia ke dhënë veturën asaj pa miratimin tonë” dhe pastaj i pandehuri ka dalë jashtë dyqanit.

61. Sa i përket ndërresave të brendshme dhe çorapeve të S. N., i pandehuri ka deklaruar se S. N. kishte qenë në shtëpinë e tij me vëllain e saj ; ata e kanë kaluar natën aty dhe pasi që e ka bërë një dush , ajo i ka larë të brendshmet e saja dhe çorapet në banjë. I pandehuri e kishte parë vëllain e S. N. duke i kërkuar pantallonat e tij dhe pastaj ai i ka marrë 10 euro. S. N. ishte nevrkosur duke thënë “vëllai im nuk vjedh, nuk kontrollon”; ata janë

⁴⁵ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 27 janar 2015, faqe 4.

⁴⁶ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 27 janar 2015, faqe 5.

veshur dhe i pandehuri i ka dërguar ata në shtëpinë e tyre. Kur i pandehuri është kthyer në shtëpi ai i ka parë ndërresat e S. N. dhe çorapet në banjo, ai i ka larë ato së bashku me rrobat e tij në makinën për larjen e rrobave dhe i ka tharë ato. I pandehuri i ka dërguar një porosi S. N. që ti merr sendet e saja dhe ajo kishte thënë “Nuk ma ndien”. I pandehuri i ka thënë asaj se “a do vish me i marr rrobat tuaja apo ti çoj ato në shtëpinë tënde”; pastaj S. N. i ka thënë “bën si të duash” dhe i pandehuri i ka thënë asaj se “Unë do t’i çoj ato në shtëpinë tënde dhe do t’ia jap nënës tënde.” Ishte e shtunë kur ai shkoi në shtëpinë e S. N., gjyshi i saj ishte para derës kryesore; i pandehuri kishte pyetur nëse nëna e S. N. ishte në shtëpi. Kur babi i S. N. e kishte dëgjuar këtë, ai kishte dalë dhe i pandehuri i kishte thënë atij “merri këto se S. N. i ka harruar në shtëpinë time.” Babai i S. N. i kishte marrë gjësendet, të cilat ishin mbështjellë në një letër, ka hyrë në shtëpi dhe i pandehuri kishte shkuar.⁴⁷

62. I pandehuri ka deklaruar se kjo ngjarje ka ndodhë një apo dy muaj para se me pasur marrëdhënie seksuale; në fakt ata nuk kanë pasur marrëdhënie seksuale pasi që vëllai i saj nuk ka fjetur dhe ata kanë ndenjur të zgjuar natën, duke biseduar.⁴⁸
63. Sa i përket armës, i pandehuri ka deklaruar se ai kurrë nuk ka pasur armë; ai nuk di si të përdorë një armë pasi që kurrë nuk ka shërbyer në ushtri. Deh nuk është gjete gjatë kontrollit të shtëpisë.⁴⁹
64. Kur është pyetur nga prokurori, i pandehuri ka deklaruar se ai e ka zbuluar moshën e S. N. kur kishte qenë në burg dhe ka përsëritë se ata ishin afruar më shumë nga muaji _____ kur kanë pasur marrëdhënie seksuale për herë të parë.⁵⁰
65. Gjatë fazë së hetimeve i pandehuri kishte dhënë deklaratën në prokurori më 3 qershor 2013. Në lidhje me ngjarjet rreth S. N., ai ka deklaruar se është njoftuar me S. N. përmes S. T..⁵¹ Ai ka theksuar gjithashtu se S. N. kishte qenë një vjet më e madhe se S. T. dhe se ajo kishte letërnjoftimin ku viti i lindjes ishte _____ ndonëse ajo kishte lindur në vitin _____. Ai kishte pasur marrëdhënie seksuale me të dyja për herë të parë në vitin _____, kjo kishte ndodhur kah mesi i qershorit pasi që kanë shkuar në liqenin e _____. S. N. kishte qenë 17 vjeçare dhe një muaj kur ka pasur marrëdhënie

⁴⁷ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 27 janar 2015, faqet 5 dhe 6.

⁴⁸ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 27 janar 2015, faqe 6.

⁴⁹ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 27 janar 2015, faqe 7.

⁵⁰ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 27 janar 2015, faqet 12 dhe 13.

⁵¹ Procesverbali i dëgjimit të pandehurit, dosja 1, faqe 52.

seksuale për herë të parë me te. Ka ndodhur që S. N. ka fjetur në shtëpinë e tij në _____ dhe _____, dy apo tri herë dhe hera e fundit që ajo ka fjetë në shtëpinë e tij ishte më _____ . Ai ka theksuar se ai i ka fotografuar ato me rroba veshur dhe ndonjëherë në ndërresa të brendshme por ai asnjëherë nuk i ka fotografuar ato duke kryer seks me të. Ai nuk i është kërcënuar atyre se nëse ato nuk kryejnë seks me të se ai do ti postojë fotografitë e tyre në Facebook. Ai e ka konfirmuar se ka shkuar në sallonin e floktarisë së nënës së S. N. për ta pyetur atë në lidhje me paratë që ia kishte pasur borxh S. N. atij dhe se ai i kishte dërguar një SMS S. N. vetëm kur i ka kërkuar 50 euro për orët e vozitjes dhe 70 euro të cilat ajo ia ka pasur borxh atij⁵². Ai ka deklaruar se nga shikimi i gjinjve të saj dhe prapanicës ajo është dukur si një 20 vjeçare dhe nëse ai do të dyshonte se ato i kanë nën 16 vjet, atëherë ai sigurisht se nuk do të kishte kryer marrëdhënie seksuale me ato.⁵³

66. Duke u bazuar në të gjitha gjetjet faktike dhe provat e paraqitura, Gjykata konsideron se është dëshmuar fakti se i pandehuri ka pasur marrëdhënie seksuale me palën e dëmtuar S. N. kur ajo ishte më pak se 16 vjet; se ai ka pasur më shumë se një herë marrëdhënie seksuale me të dhe se ai e ka ditur moshën saj.
67. Këto fakte janë dëshmuar me deklaratën e S. N. e cila ka deklaruar se ajo ka qenë 15 vjeçare kur është takuar me të pandehurin për të parën herë. I pandehuri e kishte pyetur se sa vjet i ka dhe kur ajo i ka kallëzuar se i ka 15 vjet, i pandehuri i është përgjigjur “ se edhe fëmijët e sotëm dine gjithçka”. Ata kanë pasur marrëdhënie seksuale tre apo katër herë në javë; zakonisht gjatë pushimit të tij; ka ndodhur edhe që e ka thirre dy herë në ditë. Dëshmitarit nuk i është kujtuar se sa herë ata kanë pasur marrëdhënie seksuale para se ajo me i mbush 16 vjet dhe sa herë pasi që i ka mbushë 16 vjet kanë pasur marrëdhënie; por me rëndësi është se i pandehuri ka pasur marrëdhënie seksuale me S. N. para se ajo me i mbushur 16 vjet dhe se ai e ka ditë moshën saj.
68. I pandehuri ka deklaruar se ai ka pasur marrëdhënie seksuale me S. N. për të parën herë në mesin e muajit _____; ata kanë qenë së bashku me S. T. në Liqenin e _____; pastaj së bashku kanë shkuar në shtëpinë e tij dhe kanë pasur marrëdhënie seksuale, së pari me S. T. e pastaj me S. N..

⁵² Procesverbali i të pandehurit, dosja 1, faqe 53 dhe 54.

⁵³ Record of the Defendant hearing, binder 1, page 56.

69. Gjykata nuk e konsideron deklaratën e tij si të vërtetë. Së pari trupi gjykues konsideron se deklarata e S. N. është e besueshme; deklarata e saj nuk i ka kundërshtuar deklaratat që janë dhënë më herët në polici dhe në prokurori. Së dyti deklarata e S. N. është mbështetur nga deklarata e R. A. e cila e ka njohur S. N. dhe H. P. që nga shkolla fillore, klasa e 3-të apo 4-të. R. A. ka deklaruar se ajo kishet qenë 15 apo 16 vjeçare, H. P. kishte qenë pak më e vjetër dhe S. N. ishte më e re kur është takuar me të pandehurin.
70. Përveç kësaj, A. L. ka theksuar se i pandehuri i ka thënë asaj, përderisa janë kthyer nga doktori, se ai ka pasur seks me S. N.. Ngjarja me A. L. ka ndodhur në fund të _____; kjo do të thotë mesi i _____, kështu që ai ka pasur marrëdhënie seksuale me S. N. para kësaj kohe.
71. Dhe përfundimisht trupi gjykues nuk konsideron se deklarata e të pandehurit është e besueshme dhe e vërtetë kur ka deklaruar se ka pasur marrëdhënie seksuale me S. N. për të parën herë kah mesi i _____ pasi që edhe trupi gjykues nuk beson se ata nuk kanë pasur marrëdhënie seksuale edhe pse ajo ka fjetur në shtëpinë e tij (së bashku me vëllain e saj më të vogël). Fillimisht i pandehuri ka theksuar se S. N. ka fjetur në shtëpinë e tij para se me pasur marrëdhënie seksuale për të parën herë.⁵⁴ Më vonë ai ka deklaruar se S. N. ka fjetur në shtëpinë e tij në _____ dhe _____ të vitit _____ dy apo tre herë.⁵⁵ Versioni i ngjarjes siç është paraqitë nga i pandehuri se si S. N. i ka harruar ndërresat e saj dhe çorapet në shtëpinë e tij dhe insistimi i tij që t'ia kthente prapa asaj, edhe kjo nuk është rrethanë që do të ketë rëndësi në lidhje me kryerjen e veprës penale, tregon se si në fakt ishte marrëdhënia e tyre. Situata, kur ai , si një njeri shumë më i moshuar, ka sjellë ndërresat e brendshme dhe çorapet e saj prindërve të tij është thjesht e çuditshme dhe shumë larg prej kujdesit për gjërat që i kanë takuar tjetërkujt. Kjo mund të tregon vetëm në bazë të supozimit se ai ka dashur ta vë dëshmitaren nën presion.
72. Njësoj, fotografitë⁵⁶ të cilat janë bërë më _____, _____ dhe _____, tregon se marrëdhënia nuk ishte vetëm miqësore, ndonëse S. N. nuk ishte e zhveshur në ato fotografi.

⁵⁴ Shiko pikën 60.

⁵⁵ Shiko pikën 65.

⁵⁶ Lista e provave nr. 13; kopjet nga CD, faqet 1, 5, 6, 21 dhe 23.

73. Llogaritjet e datave siç i ka paraqitur i pandehuri në deklaratën e tij të fundit,⁵⁷ në bazë të së cilës data e seksit të parë do të duhej të ishte _____ dhe llogaritja e datave të cilat mund të tregojnë moshën e S. N., janë çorientuese. Dëshmitari në të vërtetë deklaroi “unë e kam takuar atë para tre viteve”. Trupi gjykues thekson që ajo ka deklaruar “rreth”; por është normale që çdo person është më preciz kur atij i duhet të kujtoj moshën e tij apo të saj sepse ka rrethana të tjera që personi i mban në mendje të tij apo të saj; në vend të mbajtjes në mend të kohës së saktë që ka kaluar.
74. Deklarata e S. N. kur ajo deklaroi që S. T. ishte 14 vjeçare, edhe certifikata e lindjes tregon që ata të dy ishin lindur në vitin _____, nuk është vendimtare.⁵⁸ Është e mundshme që ajo ka menduar dhe që ajo akoma mendon që S. T. është më e re një vit sesa ajo; por është me rëndësi që në të gjitha deklaratat e saja që S. N. i ka dhënë gjatë hetimit dhe para trupit gjykues, ajo ka dhënë provën e njëjtë; kjo do të thotë që ajo ishte më e vogël sesa 16 vjeçare kur ajo kishte marrëdhënie seksuale me të pandehurin dhe që i pandehuri e dinte moshën e saj.
75. Trupi gjykues nuk mund të konstatoj si të dëshmuar faktin që i pandehuri ishte në posedim të armës dhe që ai e ka përdorur atë me qëllim të detyrimit të asaj në marrëdhënie seksuale. S. N. deklaroi që i pandehuri e ka mbajtur armën ndër shtrat; dhe kur ajo nuk pranonte të ketë marrëdhënie seksuale me atë, ai e merrte armën dhe i drejtonte asaj duke i thënë që askush nuk mund të ndihmoj asaj madje as policia. Megjithatë, jo vetëm S. N. por gjithashtu N. T. dhe A. F. deklaroi që i pandehuri iu kishte treguar atyre armën, trupi gjykues nuk e konsideron këtë fakt si dëshmuar. Arma nuk ishte gjetur gjatë bastisjes së shtëpisë; nga deklarata e S. N. rrjedh që ai e kishte përdorur atë vetëm një herë; kjo do të thotë që kur ata kishin marrëdhënie seksuale për herë të parë. Ajo deklaroi që më vonë, i pandehuri iu kërcënuar asaj që ai do të shkonte tek vëllai i saj dhe babai i saj; dhe që ai do të botonte materialin filmik dhe fotografitë në internet por ajo nuk deklaroi që e kishte përdorur armën më tej.
76. Trupi Gjykues vlerësoi provat e paraqitura dhe në bazë të vlerësimit të tillë konstaton si të dëshmuar përveç dyshimit të bazuar që i pandehuri në datat e panjohura ndërmjet _____ dhe _____, në shtëpi të tij që gjendet në _____, në lagjen

⁵⁷ Deklarata e fundit me shkrim e të pandehurit, faqe 3.

⁵⁸ Deklarata e përfundimtare me shkrim e të pandehurit, faqe 4.

“ _____ ”, duke e ditur moshën e saj, kishte më tepër se një herë marrëdhënie seksuale me S. N. e lindur më datën _____.

77. Prandaj, trupi gjykues e ri-kualifikoi akuzën fillestare të keqpërdorimit seksual të personit nën moshën 16 vjeç, në kundërshtim me nenin 198, paragrafi (1) në lidhje me paragrafin (5), nën paragrafi (3) të KPK dhe e dënoi të pandehurin për kryerje të veprës penale të Keqpërdorimit seksual të personit nën moshën 16 vjeç, në kundërshtim me nenin 198, paragrafi (1) të KPK.

B. Pika 2

78. Sipas pikës 2 të pandehurit iu ishte treguar që prej _____ deri në fund të vitit _____ në shtëpinë e cila gjendet në lagjen “ _____ ”, duke qenë zyrtar – asistent konsulent në _____ në _____, mori pjesë në trafikim të qenieve njerëzore – të miturën S. N. Në mënyrë që pas marrëdhënies seksuale me të, tentoi të trafikonte atë tek të tjerët për ofrim të shërbimeve seksuale për një shumë prej 50 EURO shumë e cila do të ndahej në pjesë të barabarta kështu që i pandehuri **D. K.** do të merrte 25 euro si ndërmjetësues dhe pjesa tjetër – shuma prej 25 eurove do t’i jepej palës së dëmtuar S. N. por pala e dëmtuar refuzoi të bëjë kështu; kështu kreu vepër penale të mundësimit të prostitucionit, në kundërshtim me nenin 201, paragrafi (4) në lidhje me paragrafin (1) dhe nenin 20 të KPK.

79. Ajo ishte dëshmia e S. N. gjatë seancës gjyqësore të datës _____ që i pandehuri i propozoi asaj të ketë marrëdhënie me të vëllain e tij i cili ishte 65 vjeç, me shokun e tij nga _____ dhe një serb.⁵⁹ Dëshmitari deklaroi që ajo ishte 16 vjeç kur i pandehuri i propozoi asaj tek personat e tjerë dhe ai i propozoi asaj shumë herë të ketë marrëdhënie seksuale me persona të tjerë; ka ndodhur që kurdo që ai ka ardhur ai të marrë atë kurdo.

80. Sa i përket stafit të _____ S. N. deklaroi që njëri nga ata ishte shefi i të pandehurit dhe tjetri punëtor, njëjtë si i pandehuri. Ky nëpunës, shoku i tij, kishte një xhip të kuq dhe

⁵⁹ Procesverbal nga shqyrtimi gjyqësor më datën 10 nëntor 2014, faqe 6.

ishite pak i gjatë.⁶⁰ I pandehuri i propozoi asaj të dal me atë nga _____ dhe tha që ai do t'i jap asaj 50 euro por S. N. duhej t'i jepte të pandehurit 25 euro. Kur thoshte të “dal me atë” S. N. shpjegoi që domethënia e kësaj ishte “të ketë marrëdhënie seksuale me atë”.⁶¹

81. S. N. deklaroi që ajo e pa shokun e tij nga _____, ai ishte me veturën e tij; i pandehuri e ndali atë dhe i tha përderisa ishte duke qeshur “a të pëlqen kjo”? më vonë S. N. ishte akoma me të pandehurin, ky shok e thirre atë në këtë numër të telefonit duke i treguar atij “nëse kjo është e vërtetë atëherë sille atë [domethënë S. N.] tek unë.” Dhe pastaj i pandehuri e pyeti S. N. nëse ajo dëshiron të dal dhe të ketë me atë marrëdhënie seksuale⁶².

82. Sa i përket vëllait të pandehurit dhe personit tjetër serb S. N. deklaroi që ata nuk ishin të pranishëm; i pandehuri bisedoi me ata përmes telefonit. Ai i thirri ata duke iu thënë nëse dëshirojnë të vijnë në shtëpinë e tij dhe ajo [duke iu referuar S. N.] do të kërkoj 50 euro dhe pasi që e lëshoi telefonin ai i tregoi S. N. atë që iu tha folësve.⁶³

83. Për trupin gjykues është me rëndësi fakti që deklaratat e S. N. gjatë fazës së hetimit, në pikat më esenciale, nuk bien në kundërshtim me deklaratën e saj të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor. Ajo e dha deklaratën në polici me datën 27 mars 2013 dhe ajo deklaroi që i pandehuri i propozoi asaj të dal me një nga shokët e tij i cili kishte një xhip të kuq dhe ai i tha asaj që ky shok punën për _____; ai ishte rreth të 40-ve. Asaj nuk i kujtohej emri por ajo mund të njihte atë. I pandehuri i tregoi asaj që nëse do të dilte me këtë person, ai do t'i jepte asaj 50 euro, dhe pastaj i pandehuri do t'i jepte asaj gjysmën dhe ai do të mbante gjysmën tjetër për vetë. S. N. nuk pranoi të dilte me këtë person.⁶⁴

84. S. N. e dha deklaratën e saj prokurorit më datën 31 tetor 2013. Kjo ishte dëshmia e saj që në një rast, kur ajo ishte në shtëpinë e të pandehurit, aty ishte punëtori i _____, i cili fliste në shqip dhe i pandehuri i tha S. N. të dal me këtë person, të marrë nga ai 50 euro dhe pastaj të i jap të pandehurit hisen e tij, kështu që 50 euro do të ndaheshin ndërmjet asaj dhe të pandehurit. S. N. përshkroi këtë person si të gjatë, ndoshta 180 cm, i

⁶⁰ Procesverbal nga shqyrtimi gjyqësor më datën 10 nëntor 2014, faqe 14.

⁶¹ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më datën 10 nëntor 2014, faqe 22

⁶² Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më datën 10 nëntor 2014, faqe 23

⁶³ Procesverbal i shqyrtimit kryesor më datën 10 nëntor 2014, faqe 24.

⁶⁴ Procesverbal i intervistës së palës së dëmtuar – viktimës, dosja 1, faqe 65.

formësuar, me flokë të zi, dhe me çehre të mbyllët. I pandehuri kurrë nuk e ka përmendur emrin e tij; ai vetëm e thërriste atë “shoku i tij”. S. N. deklaroi që ajo nuk pranoi⁶⁵.

85. Është një fakt që në lidhje me S. N. trupi gjykues nuk gjeti ndonjë provë direkte konfirmuese, që i pandehuri i ka propozuar asaj të ketë marrëdhënie seksuale me persona të tjerë. Por, trupi gjykues pranon deklaratën e S. N. si të besueshme pasi që e njëjta *modus operandi* ishte shfrytëzuar nga i pandehuri në lidhje me N. T.. N. T. në deklaratën e saj ka dhënë shumë detaje se si i pandehuri e ka detyruar atë të ketë marrëdhënie seksuale për të holla me persona të tjerë⁶⁶ Kështu trupi gjykues mund të arrij në përfundim sjelljen e njëjtë të pandehurit.
86. Trupi gjykues vlerëson që deklaratata e dhënë nga S. N. gjatë shqyrtimit gjyqësor më datën 10 nëntor 2014 dhe 9 dhjetor 2014 është e besueshme. Ajo dha një llogari të detajuar mbi ngjarjet; dëshmitet e saj kanë qenë në përputhje me detajet me rëndësi rreth ngjarjeve në lidhje me akuzën.
87. I pandehuri deklaroi gjatë shqyrtimit gjyqësor më datën 27 janar 2015 që ai kurrë nuk i kishte propozuar S. N. për ndonjë person tjetër⁶⁷
88. Gjatë fazës së hetimit i pandehuri dha deklaratë tek prokurori më datën 3 qershor 2013. Ai deklaroi që nuk është e vërtetë që ai i sugjeroi S. N. të dal me një person tjetër nga _____ dhe që ai do të ndante të hollat me atë.⁶⁸
89. Bazuar në të gjitha konstatimet faktike të përmendura më lart trupi gjykues konsideron si të dëshmuar faktin që i pandehuri i ka ofruar S. N. personave të tjerë kur ajo ishte më tepër se 16 vjeç dhe më pak se 18 vjeç. Me qëllim të përsëritjes së fakteve që dëshmojnë që i pandehuri e dinte moshën e S. N. trupi gjykues në tërësi i referohet shpjegimit të dhënë tashmë nën pikën e mëhershme.
90. Është një fakt që S. N. në deklaratë ne saj në gjykatë gjithashtu përmendi vëllain e tij dhe personin serb edhe pse në fazën hetimore ajo iu referuar vetëm një rasti dhe e përshkroi personin si “shoku i tij punon në _____”. Kjo mundet të shpjegohet për shkak të faktit që para gjykatës asaj iu janë bërë pyetje për më tepër detaje në lidhje me ato fakte, kështu përgjigjet e saja ishin më të sakta.

⁶⁵ Procesverbal i intervistës së palës së dëmtuar – viktimës, dosja 1, faqe 76.

⁶⁶ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më datën 17 tetor 2014, faqet 20 dhe 23

⁶⁷ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më datën 27 janar 2015, faqe 25.

⁶⁸ Procesverbal i shqyrtimit të pandehurit, dosja 1, faqe 54 54.

91. Trupi gjykues konstaton si të dëshmuar faktin që i pandehuri ka vepruar si person zyrtar – asistent konsulent në _____ në _____, edhe pse ai i ka ofruar S. N. ndër personat e tjerë gjithashtu disa shokëve të cilët kanë punuar për _____. Megjithatë, nuk ka nevojë që ky fakt të dëshmohet.
92. Bazuar në faktet e mësipërme trupi gjykues konstaton si të dëshmuar përveç dyshimit të bazuar, që i pandehuri në datat e panjohura ndërmjet _____ dhe _____ në shtëpinë e tij e cila gjendet në lagjen “_____”, i ka propozuar S. N. e lindur më datën _____, të ketë marrëdhënie seksuale me persona të panjohur, ndër të tjerët edhe stafit të _____, vëllait të tij dhe një personi serb, për një shumë prej 50 eurove e cila shumë do të ndahej në pjesë të barabarta ndërmjet të pandehurit dhe palës së dëmtuar S. N. por pala e dëmtuar refuzoi të bëj kështu.
93. Prandaj, trupi gjykues e ka dënuar të pandehurin për kryerje të veprës penale të tentimit të mundësimit të prostitucionit, në kundërshtim me nenin 201, paragrafi (4) të KPK.
94. I pandehuri ndërmori veprimet ndaj kryerjes së veprës së cituar në pikën e mëparshme. Pasi që S. N. refuzoi të ketë marrëdhënie seksuale me personat që i pandehuri i propozoi asaj, vepra penale nuk ishte përfunduar dhe trupi gjykues e dënoi të pandehurin për kryerje të veprës së tentuar penale sipas nenit 20 të KPK.

C. Pika 3

95. Nën pikën 3 i pandehuri ishte akuzuar që në datën dhe kohën e panjohur në _____, në automjetin e tij “_____” ai kishte prekur me qëllim seksual të miturën S. T., e cila ishte 15 vjeçare, në këtë mënyrë: përderisa i pandehuri ishte duke vozitur veturën e tij, e mitura S.T. ishte duke qëndruar ulur në ulësen e bashkë vozitësit, ndërsa pala e dëmtuar S. N. ishte duke qëndruar ulur në ulësen e pasme. I pandehuri filloi të ledhatoj, me qëllim seksual, palën e dëmtuar S.T. në këmbën e saj të majtë; kështu duke kryer vepër penale të sulmit seksual, në kundërshtim të nenit 195, paragrafi (4) në lidhje me paragrafin (1) të KPK.
96. S. T. e dha deklaratën në polici më datën 27 mars 2013 dhe në prokurori më datën 4 shtator 2013. Pasi që deklarata në prokurori nuk ishte dëshmim në bazë të nenit

123 paragrafi (3) të KPP, deklarata nuk ishte lexuar në shqyrtimin gjyqësor siç është paraparë në nenin 338, paragrafi (1) të KPP.

97. Kur S. N. ishte dëgjuar si dëshmitare në seancë, e cila është mbajtur më 10 nëntor 2014, S. N. deklaroi që ajo e ka takuar të pandehurin përmes S. T.. S. N. e ka prezantuar atë tek ajo si daja i saj. ai erdhi për t'i marrë ato në sallonin ku S. N. ishte duke punuar dhe ata shkuan për një vozitje. Kur i pandehuri filloi të prek S. T., S. N. e kuptoi që ai nuk ishte daja i saj.⁶⁹
98. I pandehuri deklaroi gjatë shqyrtimit gjyqësor më 27 janar 2015 që ai e njofti S. T. përmes motrës së saj N. T. e cila punonte me administratorin regional si pastruese⁷⁰ Fillimisht S. T. erdhi me S. N. dhe vëllain e saj më të vogël në shtëpinë e tij me qëllim të shfrytëzimit të internetit. I pandehuri kurrë nuk e ka ftuar atë në shtëpinë e tij; ai deklaroi që ishte iniciative e tyre, S. T. erdhi ose me S. N. apo me S. N. dhe vëllain e saj, dhe më vonë ato i ofruan atij marrëdhënie seksuale në mënyrë shoqërore.⁷¹
99. I pandehuri deklaroi që ai e ka takuar S. T. për herë të parë në _____. Ajo erdhi me të motrën e saj N. T dhe nganjëherë me I. T.. Dhe ai u nda nga ajo në fund të _____⁷².
100. I pandehuri gjithashtu deklaroi që ai e dinte që S. T. ishte 15 vjeçare kur ai i ofroi asaj një unazë për ditëlindje. Ai deklaroi që ajo e kërkoi atë dhe ajo i tregoi atij “është ditëlindja ime” dhe “çfarë do të më blesh mua”.⁷³
101. Në lidhje me fotografitë që ishin paraqitur tek i pandehuri gjatë shqyrtimit gjyqësor ai deklaroi që ato ishin marrë më datën ____ dhe konfirmoi që S. T. dhe ai ishin të zhveshur por ata nuk kishin marrëdhënie seksuale.⁷⁴
102. Gjatë fazës së hetimit i pandehuri dha deklaratë tek prokurori më datën 3 qershor 2013. Ai deklaroi që ai e ka takuar S. T. në banesë të ish _____ të _____ në _____, R. A. 2. ku motra e saj punonte si pastruese dhe gjellëbërëse. Ai nuk e kishte parë atë për pothuajse 5 vite; dhe kur ajo ishte në klasë të tetë, ajo vinte tek ai në _____, ku ai punonte dhe kërkoi të holla. Ajo filloi të kërkoj

⁶⁹ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më datën 10 nëntor 2014, faqe 5.

⁷⁰ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më datën 27 janar 2015, faqe 28.

⁷¹ Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më 27 janar 2015, faqe 29.

⁷² Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor më datën 27 janar 2015, faqe 30 dhe 31.

⁷³ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më datën 27 janar 2015, faqe 31.

⁷⁴ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më datën 27 janar 2015, faqet 31 dhe 32.

për më tepër të holla dhe me qëllim të lirimit nga ajo ai do t'i thoshte asaj “ma jep mua”; ajo i tha atij se ishte e virgjër por ajo kishte një shoqe që quhej S. N. e cila nuk ishte e virgjër dhe që ishte një vit më e vjetër se S. T.. Ai deklaroi që ai kishte marrëdhënie seksuale me të dyja ato për herë të parë në mes të _____ në vitin _____.⁷⁵

103. Ai deklaroi që ai e njihte S. T. si të vogël. Ai kishte marrëdhënie seksuale me atë për herë të parë kur ajo ishte 16 vjeçare dhe pesë muaj e vjetër⁷⁶ Ai e takoi atë për herë të fundit në ____ dhe me iniciativë të saj ata e vazhduan lidhjen.⁷⁷ I pandehuri deklaroi gjithashtu që S. T. kishte një trup të zhvilluar mirë, gjokset e saj dhe të pasmet e saj ishin shumë të zhvilluar duke pasur parasysh moshën e saj, dhe ajo dukej sikur 20 vjeçare.⁷⁸

104. S. T. nuk ishte e arritshme për gjykatën; prokurori nuk mund të ofroj adresën e saj. siç është shpjeguar më parë, dëshmimi i saj i dhënë tek prokurori në fazën e hetimit nuk i përmbush kriteret sipas nenit 338, paragrafi (1) të KPP. Deklarata e saj do të ishte vendimtare pasi që provat tjera ishin shumë të kufizuara.

105. Bazuar në provat e paraqitura dhe të gjitha konstatimet e përmendura faktike trupi gjykues nuk mund të konstatoj si të dëshmuar faktin që i pandehuri e ka prekur S. T. me qëllim seksual dhe të ketë kryer veprën për të cilën ai është akuzuar.

106. Prandaj, sipas nenit 364, paragrafi (1) nën paragrafi (1.3) të KPP trupi gjykues e liroi të pandehurin për kryerje të veprës penale të sulmit seksual, në kundërshtim me nenin 195, paragrafi (4) në lidhje me paragrafin (1) të KPK.

D. Pika 4

107. Sipas pikës 4 i pandehuri ishte akuzuar që më datën ____ në orët e mëngjesit në vendin e njëjtë sikurse nën pikën 1 të dispozitivit, ai e detyroi palën e dëmtuar nën moshën 16 vjeçe, të ketë marrëdhënie seksuale dhe qëllimisht i shkaktoi asaj deheje me alkhol të personit nën moshën 16 vjeç – palës së dëmtuar – të miturës S. T. E cila ishte 15

⁷⁵ Procesverbal i shqyrtimit të të pandehurit, dosja 1, faqet 52 dhe 53.

⁷⁶ Procesverbal i seancës së të pandehurit, dosja 1, faqe 54.

⁷⁷ Procesverbali i seancës së të pandehurit, dosja 1, faqe 55.

⁷⁸ Procesverbal i seancës së të pandehurit, dosja 1, faqe 65.

vjeçe me qëllim të thyerjes së rezistimit të saj dhe duke i treguar asaj armën e zjarrit, një revole me markë të panjohur dhe me kalibër të cilën ai e mbante në dollap dhe ai e incizonte marrëdhënien seksuale me video kamerë; kështu kreu vepër penale të keqpërdorimit seksual të personit nën moshën 16 vjeç, në kundërshtim me nenin 198, paragrafi (1) në lidhje me paragrafin (5), nën paragrafi (3) të KPK.

108. I pandehuri deklaroi gjatë shqyrtimit gjyqësor më datën 27 janar 2015 që ai e takoi S. T. për herë të parë në _____ dhe në atë kohë S. T. ishte 11 vjeçe. Nga ajo kohë ata nuk kanë pasur kontakte për katër vite, pesë vite.⁷⁹

109. Ai deklaroi gjithashtu që ata kishin marrëdhënie seksuale për herë të parë më _____ kur S. T. i ofroi atij të ketë marrëdhënie seksuale si dhuratë për ditëlindje të tij.⁸⁰ Pas kësaj, ai kishte marrëdhënie seksuale me S. T. për dy apo tre herë dhe më vonë 15 deri në 20 herë së bashku me S. N. dhe S. T..⁸¹

110. I pandehuri deklaroi që ai kishte marrëdhënie seksuale me S. T. dhe që ajo ishte çdo herë me pëlqimin e saj. ai incizoi marrëdhënien seksuale me pëlqim të dy nga ata, do të thotë S. T. dhe S. N..⁸²

111. S. T. e dha deklaratën në polici më 27 mars 2013 dhe prokurorit më 4 shtator 2013. Prokuroria i propozoi S. T. të dëgjohet si dëshmitare gjatë shqyrtimit gjyqësor por nuk mund t'i ofroj trupit gjykues adresën e saj; kështu ajo nuk ishte e arritshme për gjykatën. Pastaj prokuroria propozoi për të lexuar deklaratat e saja të mëparshme por trupit gjykues refuzoi një kërkesë të tillë pasi që deklaratat e dhënë në prokurori nuk ishte një dëshmim sipas nenit 123 paragrafi (3) të KPP. Trupi gjykues nuk lejoi leximin e tij në shqyrtim gjyqësor siç është paraparë sipas nenit 338, paragrafi (1) të KPP.

112. Ka fotografi⁸³ në dosje të lëndës të cilat janë marrë më _____, _____ dhe _____ që tregojnë S. T. duke pirë birrë dhe duhan; ka fotografi në të cilat S. T. dhe i pandehuri mund të shihen në poza intime. Sidoqoftë, trupit gjykues konsideron ato fotografi si prova të pamjaftueshme; deklaratat e dhënë nga S. T. do të ishin vendimtare.

⁷⁹Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 27 janar 2015, faqe 34.

⁸⁰Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 27 janar 2015, faqe 33.

⁸¹Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 27 janar 2015, faqe 36.

⁸²Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 27 janar 2015, faqet 32 dhe 33.

⁸³Lista e provave nr. 13; kopjet nga CD.

113. Bazuar në këtë, trupi gjykues nuk mund të dëshmoj si të dëshmuar faktin që i pandehuri më _____ ka kryer veprën të përshkruar në dispozitiv të aktakuzës sipas pikës 4 dhe për këtë, e ka liruar atë sipas nenit 364, paragrafi (1) nën paragrafi (1.3) të KPP.

E. Pika 5

114. Pika 5 i pandehuri ishte akuzuar që në kohën dhe datën e panjohur në vitin _____ deri në _____ në vendin sikurse në pikën I të dispozitivit ai e detyroi palën e dëmtuar S. T. Të moshës 16 vjeçe të ketë marrëdhënie seksuale pa pëlqimin e saj. duke e ditur që ajo është 16 vjeçe, i pandehuri kërkoi që ajo të ketë marrëdhënie seksuale me atë dhe kur pala e dëmtuara, e mitura S. T. Refuzoi, i pandehuri me qëllim shkaktoi dehjen e saj me alkool me qëllim të thyerjes së rezistencës së saj dhe duke i treguar asaj armën e zjarrit, një revole të markës së panjohur dhe me kalibër duke i thënë asaj: “Askush nuk mundet të më bëj mua asgjë, as _____ e as policia sepse unë i kam të gjithë nga ata në xhepin tim” dhe në këtë mënyrë, ia doli të frikësoj palën e dëmtuar S.T, duke e detyruar atë të ketë marrëdhënie seksuale me atë pa dëshirën e saj, sepse kur pala e dëmtuar S. T. shkoi në shtëpi të saj tentoi të bëj vetëvrasje duke pirë barna qetësuese dhe domestos dhe si rezultat ajo ishte shtrirë në spital; kështu kreu veprën penale të dhunimit, në kundërshtim me nenin 193, paragrafi (4) në lidhje me paragrafin (2) nën paragrafi (2) të KPK.

115. I pandehuri deklaroi gjatë shqyrtimit gjyqësor më 27 janar 2015 që ai kurrë nuk i ka thënë këto fjalë sikurse janë përmendur në përshkrimin faktik dhe që të gjithë incizimet ishin bërë me pëlqim të S. T.. I pandehuri deklaroi që ai kishte tre telefona, Nokia 6300, Nokia 6800 dhe Anycool.⁸⁴

116. Ai gjithashtu deklaroi që S. T. fizikisht i ka dhënë përshtypjen e të qenit më tepër se 20 vjet, megjithatë sipas pjekurisë së saj, në veçanti sa i përket përvojës së saj, ajo ka dhënë përshtypje më të lartë, të moshës 30, 40 apo 45 vjeçe.⁸⁵

⁸⁴Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 27 janar 2015, faqe 37.

⁸⁵Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 27 janar 2015, faqe 38.

117. S. T. e dha deklaratën në polici më datën 27 mars 2013 dhe në prokurori më 4 shtator 2013. Tashmë ishte konfirmuar, ajo nuk ishte e arritshme për gjykatën për t'u dëgjuar gjatë shqyrtimit gjyqësor pasi që prokuroria nuk mundi t'i ofroj trupit gjykues adresën e saj. propozimi i prokurorisë për të lexuar deklaratat e saja të mëhershme ishte refuzuar pasi që deklarata e dhënë në prokurori nuk ishte dëshmim sipas nenit 123, paragrafi (3) të KPP. Trupi gjykues nuk lejoi leximin në shqyrtim gjyqësor siç është paraparë në nenin 338, paragrafi (1) të KPP.
118. Dëshmitarja N. T. është motra e S. T.. N. T. deklaroi që ajo zbuloi që S. T. ishte në lidhje me të pandehurin kur S. T. filloi të marr barna, hapa dhe ajo ishte shumë me stres.⁸⁶ Fakti që S. T. tentoi të bëj vetëvrasje është konfirmuese nga transkripti i thirrjes telefonike ndërmjet të pandehurit dhe N. T. më ____ ____ ____ në ora __:__:__.
119. Sa i përket fotografive⁸⁷ të cilat gjithashtu janë paraqitur si prova, trupi gjykues në tërësi i referohet shpjegimit të dhënë në pikën e mëhershme dhe cek mospërputhjen shtesë. Koha e kryerjes së veprës penale është “kohë dhe datë e panjohur në vitin ____ deri në ____ ____” përderisa S. T. tentoi të kryej vetëvrasje në vitin ____, me siguri më ____ apo më herët.⁸⁸
120. Bazuar në të gjitha konstatimet faktike të përmendura më lart dhe provat e paraqitura trupi gjykues nuk mund të konstatoj si të dëshmuar faktin që i pandehuri ka kryer veprat penale në pikën 5 të dispozitivit të aktakuzës dhe prandaj e liroi të pandehurin sipas nenit 364, paragrafi (1), nën paragrafi (1.3) të KPP.

F. Pika 6

121. Sipas pikës 6 i pandehuri ishte akuzuar që në _____ të vitit ____ rreth orës __:__ në shtëpi të tij në anën ____ të _____ që gjendet në lagjen “____ _ _____”, ai e detyroi palën e dëmtuar N. T. të ketë marrëdhënie seksuale me atë pa pëlqimi e saj, duke e dehur atë me disa substanca të dyshimta, në mënyrë që ai bëri një marrëveshje

⁸⁶ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 17 tetor 2014, faqe 25.

⁸⁷ Lista e provave nr. 13; kopjet e CD-ve.

⁸⁸ Transkripti i thirrjes telefonike, faqe 315.

paraprake gojore për një shumë prej 20 eurove, kështu ajo do të pastronte shtëpinë e saj e cila gjendej në ____ kështu i pandehuri e mori atë në shtëpi të tij dhe fillimisht ai i përgatit një kafe për të dhe palën e dëmtuar ku në momentin që ajo filloi për të pirë atë u ndie me marramendje dhe pastaj e humbi vetëdijen dhe i pandehuri duke shfrytëzuar rastin prej saj në mënyrë të pafuqishme kreu veprën e aktit seksual me atë, dhe e incizoi atë me kamerë; kështu kreu veprën penale, të dhunimit, në kundërshtim të nenit 193, paragrafi (3), nën paragrafi (4) të KPK.

122. Ajo ishte prova e N. T. gjatë shqyrtimit gjyqësor më ____ që ajo e takoi të pandehurin në vendin ku ajo punonte, rreth 7 viteve më parë; asaj nuk i kujtohej saktë por në atë kohë ajo ishte 22 vjeçe.⁸⁹ Ajo punonte në _____ në _____, R. A. 2. i cili punonte për _____ dhe i pandehuri ishte vozitësi i tij. dëshmitari deklaroi që ata u takuan pothuajse çdo ditë kur ai erdhi për të marrë R. A. 2..
123. N. T. dëshmoi që i pandehuri e pyeti atë një ditë “a mund të vish dhe të më pastroshe shtëpinë time”⁹⁰ Ai e thirri atë me telefon dhe ata u pajtuan për ditën tjetër. N. T. u pajtua sepse ajo kishte nevojë për të punuar.⁹¹
124. Ditën tjetër gjatë pushimit, pas orës 12:00 i pandehuri dhe N. T. u takuan para ndërtesës së quajtur “_____”. I pandehuri e mori atë me veturë zyrtare dhe e mori atë në shtëpi të tij në _____. Ishte një shtëpi dy katëshe; banesa e të pandehurit ishte në katin e dytë. Ata hynë në një dhomë, me një divan, një tavolinë të TV-së ishte aty, dhe një gardërobë; ajo u ul në divan. Ajo hyri vetëm në atë dhomë, ajo nuk i kishte parë dhomat e tjera.⁹² I pandehuri i ofroi asaj një kafe⁹³ duke i thënë “së pari, unë do të ju ofroj juve një kafe si mysafire në shtëpinë time”.⁹⁴
125. Pasi që N. T. e piu kafën në tërësi, ajo u ndie me marramendje dhe ajo u shtri në divan. Ishte prova e saj që pas kësaj asaj nuk i kujtohej asgjë.⁹⁵ Në një moment ajo erdhi në vetëdije dhe e kuptoi që ajo ishte shtrirë në shpinë të saj, ajo ishte e zhveshur dhe i

⁸⁹ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 17 tetor 2014, faqe 19.

⁹⁰ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 17 tetor 2014, faqe 22.

⁹¹ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 17 tetor 2014, faqe 29.

⁹² Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 17 tetor 2014, faqet 30 dhe 37.

⁹³ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 17 tetor 2014, faqe 30.

⁹⁴ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 17 tetor 2014, faqe 35.

⁹⁵ Procesverbali shqyrtimit gjyqësor më 17 tetor 2014, faqe 31.

pandehuri ishte shtrirë afër saj në divan të njëjtë dhe ai gjithashtu ishte i zhveshur.⁹⁶
Rrobat e saja ishin mbi dysheme, pranë divanit. Ajo i tha të pandehurit “a je normal, a jeni i çmendur” dhe “a jeni psikopat?”⁹⁷

126. I pandehuri iu përgjigj asaj “në rregull asgjë nuk ka ndodhur”; ai i dha asaj të holla dhe i tha asaj të shkoj në shtëpi. Dëshmitari deklaroi që ajo ishte ndier me marramendje; ajo filloi të qaj dhe shkoi në shtëpi.⁹⁸

127. Në pyetjen specifike nëse ajo në atë kohë e kuptoi që ata kishin pasur marrëdhënie seksuale dëshmitari deklaroi që ajo nuk e dinte. Ajo e kuptoi këtë një ditë më pas kur i pandehuri e thirri atë dhe i tregoi asaj incizimet. Ata u takuan në park; ai i tregoi asaj incizimet në telefon dhe ai gjithashtu kishte një kasetë në shtëpi.⁹⁹

128. Përderisa i shikonte incizimet ajo e pa vetën duke bërë seks me të pandehurin; N. T. deklaroi se ajo dukej tmerrshëm, ajo nuk mund të shihte; ajo u ndie keq. Ajo e pa vetën e shtrirë në divan, e zhveshur, i pandehuri ishte mbi të.¹⁰⁰

129. Dëshmitari ishte thirrur prapa më 10 nëntor 2014. Ajo iu përgjigj pyetjeve, të cilat ishin përgatitur nga i pandehuri pasi që atij iu ishte ofruar procesverbali, dhe që ishte lejuar nga trupi gjykues. Ajo gjithashtu ishte ballafaquar me deklaratën e saj të mëhershme të dhënë më 17 tetor 2014. Fillimisht ajo deklaroi që ajo ishte në shtëpinë e të pandehurit në _____ vetëm një herë kur ai e ftoi atë atje për të pastruar shtëpinë dhe kur i pandehuri i shërbeu asaj kafe dhe ajo e humbi vetëdijen. Pastaj ajo deklaroi që ajo ishte në shtëpi 2 deri në 3 herë dhe megjithatë ata ishin në lidhje për dy vite, ata nuk kanë bërë marrëdhënie seksuale.¹⁰¹ Pas një pushimi ajo i shpjegoi që ajo kishte dhënë një deklaratë pasi që ka pasur një procesmbajtës në gjykatore i cili jeton në vend të njëjtë sikur ajo dhe ajo ndihej e turpëruar dhe keq kur ajo e pa atë.¹⁰² Kur procesmbajtësi ishte larguar nga gjykatëria, N. T. shpjegoi mospërputhjet në deklaratën e saj dhe konfirmoi që ajo kishte marrëdhënie seksuale me të pandehurin në shtëpi të tij në _____ për disa herë në periudhën prej dy viteve. Ajo ishte gjithashtu prova e saj që i pandehuri kishte një incizim

⁹⁶ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 17 tetor 2014, faqe 32.

⁹⁷ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 17 tetor 2014, faqe 38.

⁹⁸ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 17 tetor 2014, faqe 38.

⁹⁹ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 17 tetor 2014, faqet 32, 33, dhe 34.

¹⁰⁰ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 17 tetor 2014, faqet 33 dhe 34.

¹⁰¹ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 8 dhjetor 2014, faqet 6 dhe 7.

¹⁰² Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 8 dhjetor 2014, faqe 9.

të ngjarjes kur ajo ishte për herë të parë në shtëpi të tij dhe që ajo ishte detyruar të ketë marrëdhënie seksuale me atë pasi që ai e kishte bërë shantazh asaj.¹⁰³

130. Në fotografinë nr. 10 në faqe 204 ajo e njohu dhomën ku ata kanë qëndruar.

131. Dëshmitë e N. T. që ajo ishte në shtëpinë e të pandehurit më tepër se një herë është vërtetuar nga deklaratat e A. F., e cila deklaroi që ajo ka parë një herë në kompjuterin e të pandehurit dy motrat S. T. dhe N. T. duke bërë marrëdhënie seksuale me të pandehurin.¹⁰⁴

132. N. T. e dha deklaratën tek prokurori më datën 6 shkurt 2014 dhe më 26 mars 2014.

133. Kur ajo ishte intervistuar nga prokurori më 6 shkurt 2014 ajo deklaroi që ajo kishte pastruar si pastruese për R. A. 2., nëpunës i _____, dhe i pandehuri ishte vozitësi i tij. ajo nuk e njohte të pandehurin nga më parë. Ajo e njohu atë prej kur e voziti R. A. 2. në banesë; nganjëherë ka ndodhur që i pandehuri vinte në banesë dhe R. A. 2. kërkonte nga ajo t'i shërbente kafe. Ai vinte shumë shpesh atje për kohë të drekës dhe N. T. kurrë nuk ka vërejtur ndonjë sjellje të keqe tek i pandehuri. Ai e ftoi atë për kafe shumë herë; një ditë ajo pranoi dhe shkoi me të për kafe. Ai e ftoi atë pothuajse çdo ditë në kohën kur N. T. ishte duke shkuar përmes krizave të thella dhe nuk ishte në disponim të mirë për të dalë. Pastaj i pandehuri e pyeti atë nëse ajo do të donte të vinte dhe të pastronte shtëpinë e tij për 10 deri në 20 euro dhe ajo pranoi këtë ofertë. I pandehuri e merrte atë rreth orës __:__ apo __:__ dhe e merrte atë në shtëpinë e tij në __. Shtëpia ishte dy katëshe; kati i parë ishte i dhënë me qira një familje boshnjakë, ata hynë në një dhomë ku shtrati, TV dhe ngrohësja ishin. Ai i shërbeu asaj me kafe dhe lëng; në momentin që ajo filloi të pinte kafën, ajo u ndie me marramendje, asaj i ra të fikët dhe kur ajo u ngrit, ajo e pa të pandehurin dhe vetën të zhveshur. Kur ajo e pyeti atë se “çfar[jeni duke bërë” i pandehuri i tha “nuk prish punë, askush nuk do të dij këtë” dhe i dha asaj 20 eurot e saja. Pas 3 deri në 4 ditë ai e thirri atë dhe e ftoi për kafe. Kur ajo refuzoi, ai i tha asaj “në rregull, por unë e kam një video incizim kur ne kishim marrëdhënie seksuale në atë ditë dhe unë do të lëshoj këtë në internet.” Ditën tjetër ajo shkoi në shtëpinë e të pandehurit, ai e vendosi kasetën në video rekorder dhe e lëshoi atë. N. T. e pa vetën të

¹⁰³ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 8 dhjetor 2014, faqet 7 dhe 8.

¹⁰⁴ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 16 tetor 2014, faqe 7.

zhveshur, duke fjetur dhe i pandehuri ishte mbi të duke bërë marrëdhënie seksuale. Pas kësaj, ajo shkoi dy herë me atë për të pirë kafe duke menduar se ai do të ndryshoj mendjen e tij dhe t'i jap asaj video kasetën.¹⁰⁵

134. N. T. e dha deklaratën e dytë tek prokurori më 26 mars 2014. Ajo dëshmoi që ajo kishte marrëdhënie seksuale me të pandehurin vetëm një herë dhe ata nuk kanë vazhduar; ai e thirri atë por ajo nuk shkoi. Kur ajo e piu kafën, ajo nuk shijoi asnjë ndryshim në kafe; ajo nuk e vërejti ndonjë simptomë përveç atyre të përmendura në deklaratën e saj të parë; ajo u ndie me marramendje dhe ajo u shtrie dhe iku pa vetëdije. Ajo deklaroi që nuk ishte në disponim më të mirë dhe disponimi i saj nuk ndryshoi; ajo nuk ndihej e sëmurë. Kjo ndodhi në shtëpinë e të pandehurit ndërmjet orës __:__ deri në ora __:__ pasdite; kur ajo u nis nga shtëpia ishte pothuajse errësirë.¹⁰⁶
135. Në seancën e cila u mbajt më 17 tetor 2014 dëshmitari deklaroi që ajo ishte në lidhje me të pandehurin për 3 deri në 4 vite dhe që ajo kishte marrëdhënie seksuale më tepër se një herë me të pandehurin.¹⁰⁷ Ajo nuk kishte zgjidhje pasi që ai ishte duke i bërë shantazh asaj, ai tha “unë i kam incizimet” dhe ai i tregoi asaj që do t'i tregoj ato familjes së saj. ai gjithashtu e kishte kafshuar atë, kur ai i tregoi asaj incizimet në park, ai e grushtoi atë në bark të saj dhe ajo ra në tokë.¹⁰⁸ Dëshmitari përsëriti që ajo duhej të shkonte kurdo që ai dëshironte.¹⁰⁹
136. Dëshmitari ishte i trazuar, jo vetëm gjatë kohës kur ajo ishte duke e dhenë deklaratat para trupit gjykues, kjo mund të shihet gjithashtu nga intervista e saj e dytë para prokurorit. në seancën e cila ishte mbajtur më 17 tetor 2014 dëshmitari shprehu nervozizmin e saj me fjalët “ai person më ka bërë mua shumë gjëra të këqija, ai mi ka humbur katër vite të jetës sime, ai më ka shfrytëzuar mua dhe më ka bërë gjëra të këqija mua, [...] përderisa ai është gjallë unë nuk kam jetë, as të martohem e as të krijoj familje [...] Unë dua të krijoj familjen time dhe të jetoj jetën time. Unë dua të jem vetëm dhe të shkatërrohem me gjëra të tilla përsëri.”¹¹⁰

¹⁰⁵ Procesverbal i intervistës së palës së dëmtuar – viktimës, dosja 1, faqet 174 dhe 175.

¹⁰⁶ Procesverbal i intervistës së palës së dëmtuar – viktimës, dosja 1, faqe 184.

¹⁰⁷ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 17 tetor 2014, faqe 26.

¹⁰⁸ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 17 tetor 2014, faqe 27.

¹⁰⁹ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 17 tetor 2014, faqe 34.

¹¹⁰ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 17 tetor 2014, faqe 39.

137. I pandehuri deklaroi gjatë shqyrtimit gjyqësor më 27 janar 2015 që ai e takoi N. T. në pjesën e dytë të _____ në _____ kur erdhi ajo tek një francez me origjinë turke për t'u pajtuar për të ofruar shërbime të pastrimit ¹¹¹
138. I pandehuri deklaroi që më vonë ajo filloi të punonte për R. A. 2. dhe ata takoheshin pothuajse çdo ditë pasi që i pandehuri ishte vozitësi i tij. ¹¹²
139. Ai kishte marrëdhënie seksuale me N. T. nganjëherë në fund të nëntorit, në mes të _____ 2003 në banesën e tij me dy dhoma në Prishtinë. Ajo duhej të bënte praktikën e saj për arsimimin e saj në spitalin e Prishtinës dhe kur ajo e përfundoi, ajo erdhi në shtëpinë e tij dhe ata kishin marrëdhënie seksuale. Ishte dëshmia e saj që ata u pajtuan paraprakisht që të shkonin në _____ dhe të kalonin natën së bashku. ¹¹³
140. I pandehuri deklaroi që lidhja intime me N. T. ka zgjatur për rreth gjashtë vite, deri në vitin _____. Brenda këtyre gjashtë viteve ata kishin marrëdhënie seksuale për qindra herë. Për dy vitet e para, kur i pandehuri kishte një banesë në _____, ata shkonin në _____ dhe kishin marrëdhënie seksuale vetëm atje. Pastaj ata vazhduan në shtëpinë e tij në _____. Ata shpesh shkonin gjithashtu në _____ dhe dy herë ata ishin në _____. Ata i kishin të gjitha marrëdhëniet e tyre seksuale me vullnetin e tyre reciprok, me pëlqimin e N. T.. ¹¹⁴
141. I pandehuri deklaroi që gjatë kësaj periudhe kohore prej gjashtë viteve, ata kishin bërë foto të përbashkëta; ndër ato gjithashtu me përmbajtje erotike; dhe N. T. ishte e vetëdijshme për këtë dhe ajo e dha pëlqimin e saj. ¹¹⁵
142. Kur ata e ndërprejnë lidhjen, ata akoma e thërrisnin njëri tjetrin në telefon, dhe e shihnin njëri tjetrin por ata nuk kishin marrëdhënie seksuale. ¹¹⁶
143. Gjatë fazës së hetimit i pandehuri e dha deklaratën tek prokurori më 3 qershor 2013. Ai deklaroi që ai e takoi N. T. kur ajo ishte 20 vjeçe. Ajo punonte si pastruese dhe bënte ushqim për R. A. 2. dhe ai ishte asistenti dhe vozitësi i tij. ¹¹⁷

¹¹¹ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 27 janar 2015, faqe 39.

¹¹² Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 27 janar 2015, faqe 40.

¹¹³ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 27 janar 2015, faqe 41.

¹¹⁴ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 27 janar 2015, faqet 42 dhe 43.

¹¹⁵ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 27 janar 2015, faqet 45 dhe 46.

¹¹⁶ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 27 janar 2015, faqe 46.

¹¹⁷ Procesverbal i të pandehurit, dosja 1, faqe 52.

144. Bazuar në të gjitha dëshmitë e paraqitura më lart trupi gjykues konstaton mospërputhje në deklaratën e N. T. dhe e cila nuk mund të konstatohet si fakt i dëshmuar që i pandehuri në _____ e vitit ____ e detyroi atë të ketë marrëdhënie seksuale duke e dehur atë për të pasur marrëdhënie seksuale me disa substanca të dyshimta.
145. Para se gjithash, para prokurorisë dëshmitari deklaroi që i pandehuri e mori atë rreth orës __:__ apo __:__ dhe e mori atë në shtëpi të tij në _____. Në gjykatë ajo deklaroi që kjo ka ndodhur gjatë _____, rreth orës __:__¹¹⁸
146. Në deklaratë të saj në prokurori ajo deklaroi që ajo kishte marrëdhënie seksuale me të pandehurin vetëm një herë. Më datën 17 tetor 2014 dëshmitari dëshmoi që ajo ishte në shtëpi të pandehurit vetëm një herë.¹¹⁹ Përderisa dëgjoi përsëri, në seancë që ishte mbajtur më 8 dhjetor 2014, N. T. deklaroi që ajo kishte marrëdhënie me atë disa herë brenda 2 viteve; çdo herë ata ishin në shtëpinë e të pandehurit.¹²⁰
147. Më tej, në deklaratë të saj para prokurorisë ajo përmendi vetëm kasetën dhe që ai e kishte vendosur atë video rekorder dhe e ka lëshuar atë, kur ajo shkoi tek ai në ditën tjetër. Përderisa në gjykatë ajo dëshmoi që i pandehuri e thirri atë ditën tjetër, ata u takuan në park kur ai i tregoi asaj incizimet,¹²¹ dhe më vonë i ka parë incizimet gjithashtu në kasetë në shtëpi të tij.¹²²
148. Dëshmitarja mohoi që kishte qenë ndonjëherë në banesën e të pandehurit në _____.¹²³
149. Trupi gjykues mori përshtypjen që lidhja ndërmjet të pandehurit dhe N. T. nuk ishte ideale siç është paraqitur nga i pandehuri; që N. T. do të donte të harronte atë periudhë kohore dhe të krijoj një jetë të re. Prandaj, ajo nuk kishte vullnet të dëshmoj para trupit gjykues.
150. Nuk ka pasur prova tjera të vërtetuara që mund të dëshmojnë faktet sikurse janë të paraqitura nga prokuroria në përshkrimin faktik sipas pikës 6 të aktakuzës.

¹¹⁸ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 17 tetor 2014, faqe 28.

¹¹⁹ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 17 tetor 2014, faqe 19.

¹²⁰ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 8 dhjetor 2014, faqet 8 dhe 9.

¹²¹ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 17 tetor 2014, faqet 32 dhe 39.

¹²² Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 17 tetor 2014, faqe 34.

¹²³ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 8 dhjetor 2014, faqe 3.

151. Bazuar në çdo gjë, trupi gjykues konsideron që nuk është e dëshmuar jashtë dyshimit të arsyeshëm që i pandehuri ka kryer aktet specifike sikurse janë vënë në akuzë sipas pikës 6 dhe duhet të liroj atë sipas nenit 364, paragrafi (1) nën paragrafi (1.3) të KPP.

G. Pika 7

152. Sipas pikës 7 i pandehuri është akuzuar që në fund të ____ ____ në kohë të panjohur në fshatin ____ – _____, duke e përdorur forcën e ka prekur palën e dëmtuar A. L. me qëllim seksual dhe pa pëlqimin e saj duke e përdorur gjendjen e saj të të miturës ishte e pambrojtur dhe siguria e saj ishte në rrezik dhe fakti që ajo vuante nga një sëmundje e lëkurës – akne në fytyrë të saj me qëllime që i pandehuri të gjej një shërim për atë kështu duke e mashtruar atë ai e dërgon palën e dëmtuar me veturë të tij, _____, me ngjyrë hiri tek një specialist mjek serb në veri (J. I.) e cila ka specifikuar diagnozën dhe terapinë, por përshkrimi ishte marrë nga i pandehuri dhe menjëherë pas arritjes së tij në fshatin _____, afër pompës së karburanteve, ai kërkoi atë në shkëmbim të blerjes së barnave, ajo duhej të kishte marrëdhënie seksuale me atë dhe ai filloi të prek atë në gjoks dhe të puth atë. Pala e dëmtuar refuzoi këtë dhe pastaj i pandehuri i mbylli dyert e automjetit kështu për të ndaluar palën e dëmtuar nga dalja nga vetura. Kjo e fundit filloi të bërtas dhe qaj dhe kjo është paraqitura nga punonjësi i pompës së karburanteve, i cili në atë kohë ishte jashtë pompës së benzinës dhe pastaj hyri brenda pompës së benzinës dhe i pandehuri u frikësua dhe e hapi sërish derën e automjetit, nga e cila pala e dëmtuar iku dhe tentoi të kërcej nga ura në lum; kështu vepra penale e kryer e sulmit seksual, në kundërshtim me nenin 195, paragrafi (2) nën paragrafët (2) dhe (3) në lidhje me nenin 20 të KPK.

153. Ishte dëshmia e A. L. gjatë shqyrtimit gjyqësor më 20 tetor 2014 që ajo e ka takuar të pandehurin përmes shokut të saj L.. Dy nga ata dhe shoqja e saj H. P. ishin në _____. Pasi që ato nuk kishim mjete për të ardhur në shtëpi, L. e thirri të pandehurin; ai i drejtohej atij si “dajë”. I pandehuri erdhi dhe i mori ata, dhe gjatë rrugës për në shtëpi ata nuk folën, ata vetëm dëgjuan muzikë.¹²⁴

¹²⁴ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 20 tetor 2014, faqe 14.

154. A. L. deklaroi që ajo ishte pesëmbëdhjetë apo gjashtëmbëdhjetë vjeçe; H. P. ishte shoqja e saj dhe kur ajo e vizitoi atë në shtëpi të saj, H. P. tha “të dalim për të ecur dhe të thërrasim **D. K.**”. H. P. e thirri të pandehurin dhe ata shkuan në _____ ku ata drekuan. Ata biseduan dhe i pandehuri dukej të ishte njeri i mirë. A. L. kishte disa akne në fytyrë të saj dhe i pandehuri e pyeti atë nëse ajo do të donte t’i largonte ato dhe ai rekomandoi asaj të vizitoj një mjek në anën _____. A. L. nuk i kujtohej nëse ajo i kishte dhënë atij numrin e telefonit për të shkuar dhe parë doktorin.¹²⁵
155. A. L. kërkoi nga shoqja e saj H. P. të shoqëroj atë, pasi që ajo nuk e njohte të pandehurin; përkundër faktit ai dukej të ishte një person i mirë, ai mund të ishte gjyshi i tyre. Kur ata u takuan me të pandehurin, ai tha që H. P. nuk duhet të vij sepse “ne duhet të shkojmë përmes serbëve dhe nuk guxon të ketë shumë persona në veturë.” Kështu A. L. e përqafoi H. P. dhe i tha asaj ajo do të kthehej shpejtë; dhe i tha asaj se nëse do të vonohet i telefon familjes së saj.¹²⁶
156. Kur dëshmitari dhe i pandehuri erdhën tek mjeku, [ajo quhej J. I.], mjekja i bëri disa pyetje në lidhje me aknen e A. L., e largoi jashtë të pandehurin; dhe pasi që dëshmitarja nuk kuptonte serbisht, mjekja e thirri atë përsëri. Mjekja i përshkroi barna por i pandehuri e mori dëftesën për barna dhe nuk i dha atë asaj.¹²⁷
157. Ishte dëshmia e A. L. që i pandehuri e dinte moshën e saj. para se gjithash, ai e dinte moshën e H. P. kështu që ai gjithashtu e dinte moshën edhe të A. L.. Dhe ai gjithashtu ishte në dhomë kur A. L. i tregoi asaj moshën tek mjekja.¹²⁸
158. A. L. deklaroi që rrugës prapa nga mjekja, i pandehuri së pari u ndal në një shtëpi. Ai e ftoi atë për një kafë, por ajo tha “jo, herën tjetër”. Më duhet të kthehem prapa pasi që është vonë”. I pandehuri hyri në shtëpi përderisa dëshmitarja priti në veturë. Pastaj ata vazhduan, rruga ishte me shumë male, nuk kishte shumë komunikacion, dhe ishte një rrugë ku vetëm një veturë mund të voziste. Ata u ndalen në pompë të benzinës. I pandehuri i tregoi A. L. “Unë kam bërë marrëdhënie seksuale me S. N. dhe unë jam në lidhje me R. A., dhe ju duhet të bëni këtë gjithashtu. Unë do të ju blej juve barnat dhe unë do të ju ndihmoj me problemin në fytyrën e juaj nëse ju e bëni këtë për

¹²⁵ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 20 tetor 2014, faqe 15.

¹²⁶ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 20 tetor 2014, faqe 15.

¹²⁷ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 20 tetor 2014, faqet 15 dhe 16.

¹²⁸ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 20 tetor 2014, faqe 16.

mua.”¹²⁹ I pandehuri e vëri dorën e tij në kraharor të saj, donte të afrohej më afër dhe tentoi të puth atë.¹³⁰ Ajo e ktheu kokën dhe ajo bërtiti. I pandehuri i tha “unë do të marr një patent shofer për ju,” dhe provoi të mashtraj atë, “ju do të keni një jetë të mirë.” ajo nuk pranoi, ajo vazhdoi duke bërtitur dhe i tha atij ti largoj duart nga ajo. Ishte një djalë në pompën e benzinës, ai hynte brenda dhe dilte jashtë, dhe ndoshta ai vërejti diçka. I pandehuri i mbylli dyert e veturës me çelës, dhe befas kur dyert u hapën sërish, ajo filloi të vrapoj dhe të qaj. Rrjeti i telefonit nuk punonte dhe kur ajo arriti në urë ajo donte të kërcente prej urës. Ajo frikësohej të shkonte tek pompa e benzinës, e frikësuar që djali mund të kuptoj se ajo është shqiptare. Pastaj, i pandehuri erdhi me veturën e tij, e hapi dritaren e derës, dhe i tha asaj “a dëshiron të mbysësh vetën për asgjë?” Ajo nuk dëshironte të hynte në veturë, dhe pastaj ai i premtoi që nuk do të prekte atë përsëri duke i thënë “vetëm hyr në veturë dhe mos i trego askujt diçka dhe unë do të ju sjell juve në shtëpi”¹³¹

159. Pastaj A. L. hyri në veturë dhe i pandehuri e ktheu atë prapa. Rreth kësaj ngjarje ajo i tregoi shoqes së saj H. P. e cila ishte shoqja e saj e ngushtë në atë kohë.¹³²
160. Deklarata e A. L. është vërtetuar me dëshmimin e dëshmitares H. P. e cila dha dëshmi në seancën e mbajtur më datën 17 tetor 2014. H. P. deklaroi që ajo ishte njoftuar me të pandehurin nga shoku i saj L. i cili tha “të dalim” dhe ai e mori me vete të pandehurin. Ishte viti 2008 apo 2009. Për herë të parë S. N. iu bashkua atyre dhe për herë të dytë A. L..¹³³
161. H. P. deklaroi që A. L. ishte rreth 14 – 15 vjeçe kur ata e takuan të pandehurin.¹³⁴
162. H. P. deklaroi që A. L. ishte shoqja e saj e ngushtë në atë kohë dhe që i pandehuri i tregoi A. L. “e njoh një mjek në _____ dhe unë mundem të ju dërgoj juve atje për t’i larguar aknet.” Dëshmitari deklaroi që ajo nuk donte të linte atë vetëm dhe i tha A. L. “unë do të ju shoqëroj juve” dhe ata shkuan së bashku për të takuar të pandehurin. Por kur H. P. hyri në veturë, i pandehuri i tregoi asaj ‘unë nuk

¹²⁹ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 20 tetor 2014, faqet 23 dhe 24.

¹³⁰ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 20 tetor 2014, faqet 20 dhe 23 dhe procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 8 dhjetor 2014, faqe 17.

¹³¹ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 20 tetor 2014, faqe 16.

¹³² Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 20 tetor 2014, faqe 173.

¹³³ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 7 tetor 2014, faqe 4.

¹³⁴ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 17 tetor 2014, faqe 5.

mundem të shkoj në anën tjetër me dy vajza”.¹³⁵ Ato u përgjigjen të pandehurit “asgjë nuk do të ndodh nëse vijmë të dy nga ne” por i pandehuri tha “nuk ka mundësi tjetër për të kaluar anën tjetër me të dyja nga ju për shkak të policisë.”¹³⁶ Kështu H. P. doli jashtë veturës dhe shkoi në shtëpi.

163. H. P. dëshmoi që A. L. e thirri atë në ditën e njëjtë kur ajo ishte kthyer në shtëpi dhe i tregoi H. P. se çfarë kishte ndodhur. A. L. i tregoi asaj që ajo ishte në kontroll mjekësor dhe mjeku i përshkroi barna që duhej të merrte, dhe në rrugën prapa i pandehuri kishte refuzuar të i jepte barnat A. L.. Ai tha “ju duhet të dilni me mua nëse i doni barnat.”” A. L. doli jashtë veturës. A. L. i tregoi asaj që ajo donte të mbyste vetën tek ura; që i pandehuri e la atë në rrugë, ajo nuk donte të hynte brenda më dhe ai vazhdoi me veturën e tij duke e lënë atë pas; dhe pastaj ai u kthye për të marrë atë. Pasi që ajo nuk kishte zgjidhje tjetër, ajo duhej të hynte në veturë. H. P. deklaroi gjithashtu që i pandehuri i tregoi A. L. “nëse i dëshironi barnat, ju duhet të bëni marrëdhënie seksuale me mua”. A. L. gjithashtu i tregoi H. P. që i pandehuri tentoi të grabit atë dhe tentoi të puth atë.¹³⁷

164. A. L. e dha deklaratën në polici më 29 maj 2013 dhe në atë kohë ajo mohoi të njihje të pandehurin; ajo gjithashtu mohoi që ai e mori atë tek mjeku në pjesën veriore.¹³⁸

165. A. L. e dha deklaratën tek prokurori më 15 gusht 2013. Ajo deklaroi që ajo e takoi të pandehurin kur ajo ishte në _____ me L. dhe H. P.. Pasi që ishte vonë dhe nuk kishte transport për t’u kthyer në shtëpi, L. e thirri të pandehurin i cili erdhi dhe i mori ato; dhe L. e thirrte atë “dajë”. Një herë, kur ajo shkoi tek H. P., H. P. i tha që ajo do të thirrte të pandehurin. Ai erdhi diku pasdite dhe ata shkuan në _____ për kafe. Gjatë kohës kur ata ishin duke pirë kafe, i pandehuri filloi të flas rreth akneve në fytyrë të saj dhe ai e përmendi një dermatolog i cili jetonte në _____, ajo ishte një mjeke shumë e suksesshme dhe ai gjithashtu tha ‘ne mundemi të shkojmë kurdo që ju dëshironi’. A. L. deklaroi ajo nuk refuzoi ofertën, pasi që gjatë diskutimit ajo mori përshtypjen që ai ishte një njeri i mirë; ai nuk e shikonte atë në mënyrë provokative apo me ndonjë shikim tjetër. A. L. nuk i kujtohet nëse ai e ka thirrur atë apo e kundërta; por nuk

¹³⁵ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 17 tetor 2014, faqe 6 dhe 7.

¹³⁶ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 17 tetor 2014, faqe 13.

¹³⁷ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 17 tetor 2014, faqet 7 dhe 8.

¹³⁸ Raport i intervistës së palës së dëmtuar – viktimës, dosja 1, faqet 110 dhe 111.

kaloi një kohë shumë e gjatë kur ata ranë dakord që ai të marrë atë tek ajo mjeke. Ajo ishte me H. P. afër shtëpisë, afër furrës, kur i pandehuri i mori ato me veturë të tij. A. L. i tregoi gjithashtu H. P. të shkoj me ata. Por kur H. P. hyri në veturë i pandehuri i tha që shumë njerëz nuk mundën të shkojnë me veturë sepse serbet mundën t'i ndalin ata dhe të u shkaktoj problem atyre. Dhe për shkak të kësaj H. P. doli nga vetura.¹³⁹

166. A. L. deklaroi që i pandehuri e mori atë tek mjekja; mjekja i tregoi atij të dal jashtë por pasi që ajo nuk kuptonte serbisht, mjekja e thirri prapa të pandehurin. Mjekja i përshkroi asaj një terapi për barna për të u blerë në barnatore. A. L. nuk e shihte se çfarë barna mjekja i kishte shkruar pasi që i pandehuri ishte duke e mbajtur recetën në xhep të tij. në rrugën prapa ata shkuan në drejtim të shtëpisë dhe i pandehuri i luti atë të hyj brenda dhe të pijë një kafe. A. L. nuk deshi të hyj brenda pasi që ishte vonë; ajo priti në veturë. Pas më pak se 5 minutave, i pandehuri hyri në veturë dhe ai voziti në drejtim të pompës së benzinës _____. Ishte një rrugë shumë e keqe dhe e ngushtë. I pandehuri u ndal në pompë të benzinës dhe i tha A. L. nëse ajo donte të merrte barnat ajo duhet të bënte seks me atë. Ai gjithashtu tha “unë do të paguaj për ju të merrni patentë shoferin; do të ju jap veturën time për të vozitur dhe ne do të vazhdojmë terapinë” dhe që çdo gjë do të mbulohej nga ai. Kur A. L. i tha atij “Jo”, ai tentoi të prek atë në krah por ajo u kthye në anën tjetër. Pastaj bllokoi dyert e veturës, ajo filloi të qaj. Ai gjithashtu provoi të bind atë që kjo nuk është asgjë sepse ai kishte seks me S. N., H. P., edhe pse ajo ishte e bindur që ai nuk kishte bërë seks me H. P, dhe që R. A. ishte e dashura e tij. disi dyert u hapën dhe ajo doli jashtë veturës dhe eci rrugës duke qarë. Ajo filloi të shkoj në drejtim të urës; ajo donte të kërcente nga ura. Pastaj i pandehuri erdhi me veturë të tijën, ai e luti atë të hyj brenda dhe pastaj ajo shkoi, ai i premtoi që nuk do ti bënte asaj asgjë.¹⁴⁰

167. A. L. deklaroi që ajo ishte frikësuar prej të pandehurit sepse ajo nuk e njihte atë mirë, ajo ishte shumë më e vjetër se ajo; ai mundet të ishte gjyshi i tij. dhe ajo ishte gjithashtu e frikësuar prej _____ pasi që si _____ që ishte në ____, ajo ishte në dijeni

¹³⁹ Raport i intervistës së palës së dëmtuar – viktimës, dosja 1, faqe 117.

¹⁴⁰ Raport i intervistës së palës së dëmtuar –viktimës, dosja 1, faqe 118.

rreth kushteve ndërmjet _____ dhe _____; ajo frikësohej prej _____ dhe për këtë ajo nuk mundej të kërkonte ndihmë ¹⁴¹

168. Trupi gjykues konstaton që deklaratat e dhëna nga A. L. gjatë shqyrtimit gjyqësor më 10 nëntor 2014 dhe 9 dhjetor 2014 si të besueshme pasi që ato janë vërtetuar nga provat tjera. Ajo dha një llogari të detajuar të ngjarjeve, dëshmitet e saja kanë qenë në përputhje me këto të pranuarat si të sakta nga trupi gjykues.

169. I pandehuri deklaroi që gjatë shqyrtimit gjyqësor më 28 janar 2015 që ai e takoi A. L. përmes shokut të saj të quajtur L. L. e thirri atë të shkoj së bashku me A. L., H. P. dhe shogën e tretë. Pas këtij takimi ai nuk e takoi A. L. për një kohë të gjatë. Pastaj H. P. e thirri atë me qëllim të shkojnë dhe të ecin pas orëve të punës. Ata shkuan në _____ për darkë. ¹⁴²

170. I pandehuri deklaroi që biseda kyçe në restorant në _____ ishte në lidhje me aknen që A. L. e kishte në fytyrë të saj. ai i propozoi asaj tek një specialiste mjekë për të trajtuar lëkurën në _____ të _____, J. I. ¹⁴³

171. Ishte dëshmia e të pandehurit që kjo ndodhi në vitin 2011; në atë kohë ishte fundi i vitit shkollor dhe kur A. L. ishte në vit të parë. Ishte diku në mesditë kur ata shkuan tek mjeku. Së pari mjekja e pyeti për raport të mjekut të përgjithshëm dhe për libër mjekësor por ata nuk i kishin ato. Pastaj, mjekja i tha që në një rast të tillë ata duhej të paguanin. A. L. nuk kishte të holla me vete, kështu i pandehuri e pyeti mjeken sa të holla kishin për të paguar. Mjekja u përgjigj “për herë të parë _____”, e cila ishte e barabartë me 30 euro. Mjekja tha gjithashtu që ajo duhej të vinte edhe për një kontroll tjetër pas shtatë ditëve që do të kushtonte _____, që ishte e barabartë me 25 euro. Pasi që i pandehuri e njihte mjeken nëse ata mund të paguanin të dy shumat kur ata të vijnë në kontroll për herë të dytë. Mjekja u pajtua; ajo e kontrolloi A. L., i përshkroi asaj 3 deri në 4 lloj të barnave dhe mënyrën se si ajo duhej të përdorte ato barna. Pas asaj ata kërkuan barnat në _____ së paku në katër vende; dhe vetëm një bari ishte në dispozicion, dy të tjera duhej të porositeshin, të tjerat nuk ishin në dispozicion. Ata i kërkuan ato edhe në _____ ¹⁴⁴.

¹⁴¹ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 20 tetor 2014, faqet 12 dhe 22.

¹⁴² Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 28 janar 2015, faqet 2 dhe 3.

¹⁴³ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 28 janar 2015, faqe 3.

¹⁴⁴ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 28 janar 2015, faqe 4.

172. Pasi që ata nuk i gjetën barnat ata shkuan në _____ për të pirë kafe. I pandehuri deklaroi që ata nuk pinë kafe. Ai e parkoi veturën para restorantit dhe A. L. e pyeti ata nëse kishte aty _____. Kur ai u përgjigj që pronar është një _____, ajo refuzoi të dal jashtë veturës për të pirë kafe. I pandehuri e pyeti atë “si është e mundshme që ju të vini në një spital me plotë _____ por ju po mohoni të shkoni këtu?” pas kësaj bisede A. L. u mërzhit, ajo e ktheu kokën e saj në anën tjetër dhe tha “dua të shkoj në shtëpi”. I pandehuri u përgjigj “unë dua të pi një kafe”. Dhe pastaj A. L. tha “unë do të ec në këmbë”; ajo doli jashtë veturës dhe filloi të ec. I pandehuri e nisi veturën, shkoi atje dhe e mori atë përsëri.¹⁴⁵
173. I pandehuri deklaroi që ai nuk e preku atë as nuk tentoi të prek. Ai deklaroi gjithashtu që ai kurrë nuk kërkoi nga ajo të ketë marrëdhënie seksuale. Ajo ishte shumë e sëmurë në fytyrë të saj që ishte me shumë puçrra, dhe ideja për të prekur atë në fytyrë të saj do të shkaktonte gjakderdhje. Ai deklaroi që nuk i kishte bllokuar dyert e veturës gjatë kohës kur ishin para restorantit, ajo nuk ka bërëtitur, nuk ka qarë. Ajo gjithashtu nuk ka tentuar të kërcej prej urës.¹⁴⁶
174. I pandehuri deklaroi që ai e thirri atë ditën tjetër dhe i tregoi asaj që në lidhje me barnat atje nuk mundeshin të gjendeshin në _____. A. L. i tha atij “nuk dua t’i blej ato” I pandehuri i tha asaj “por ju duhet të shkoni për një kontroll brenda një jave dhe gjithashtu për të paguar 30 euro që i kemi borxh”. A. L. e mbylli telefonin dhe më pas nuk e hapi më. I pandehuri tentoi të thërras atë në telefon por nuk punonte. Ai e thirri shoqen e ngushtë të H. P. dhe ajo i tregoi asaj që A. L. e ka humbur telefonin e saj me numër gjithashtu. Nga ajo kohë ai kurrë nuk ka dëgjuar nga ajo më.¹⁴⁷
175. Kur i pandehuri e pyeti prokurorin, ai deklaroi që H. P. nuk erdhi me ata sepse ai frikësohej për arsyen që ajo nuk fliste serbisht. Dhe kur Ai dhe A. L. hynë tek mjeku, H. P. duhej të priste jashtë klinikës. Duke pasur parasysh që H. P. nuk dinte _____ dhe për shkak që spitali ishte plot me njerëz, ai frikësohej që diçka mund të ndodhte atje.¹⁴⁸

¹⁴⁵ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 28 janar 2015, faqe 5.

¹⁴⁶ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 28 janar 2015, faqet 5, 6 dhe 7.

¹⁴⁷ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 28 janar 2015, faqe 7.

¹⁴⁸ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 28 janar 2015, faqe 9.

176. Gjatë fazës së hetimit i pandehuri e dha deklaratën tek prokurori më 3 qershor 2013. Ai deklaroi që ai e njihnte A. L.; ajo ishte në vit të parë të shkollës së mesme; duke studiuar ekonominë apo mjekësinë.¹⁴⁹ Ai kurrë nuk e mori atë në shtëpi të tij. ai e mori atë dhe e dërgoi tek specialisti i lëkurës i cili i përshkroi 4 deri në 5 lloj të barnave të cilat ai nuk i gjeti në _____ dhe kështu shkuan në _____ dhe i kërkuan ato. Ata nuk i gjetën ato as atje, kështu që ata u kthyen dhe pinë kafe në _____ në rrugën kryesore. Ai kërkoi nga ajo të dilnin jashtë dhe të pinë kafe por ajo refuzoi; ajo mendoi që ai dëshironte të pi kafe vet dhe vet doli nga vetura; dhe pastaj ai i tregoi asaj që mos të dal jashtë; dhe që ata do të ktheheshin. Kjo ka ndodhur në _____ të _____ në vitin _____; dhe ishte mesditë.
177. Bazuar në të gjitha konstatimet e përmendura më lart dhe provat e paraqitura trupi gjykues konsideron si të dëshmuar faktin që A. L. ishte e lindur më _____; dhe që ajo takoi të pandehurin për herë të parë përmes shokut të saj L.; dhe kur ajo ishte 15 apo 16 vjeçe shoqja e saj H. P. e thirri të pandehurin dhe ata shkuan në Istog për drekë. Ato rrethana në lidhje me takimin e parë ishin vërtetuar gjithashtu nga H. P. dhe i pandehuri; edhe pse H. P. deklaroi që A. L. ishte 14 apo 15 vjeçe kur ata patën ngrënë drekë së bashku.
178. Faktet në vijim: që i pandehuri i propozoi dhe e mori A. L. tek mjeku i lëkurës në _____; që mjekja e kontrolloi A. L. dhe i përshkroi barna asaj dhe që A. L. dhe i pandehuri i kërkonin barnat në barnatore në _____ janë gjithashtu jo të kontestueshme.
179. A. L., shoqja e saj H. P., dhe i pandehuri deklaruan që H. P. ishte dashur të iu bashkohet atyre kur e kanë vizituar mjeken e lëkurës në _____. Ajo ishte me A. L. kur ata u takuan me të pandehurin. Por pastaj ajo nuk e shoqëroi atë pasi që i pandehuri i tregoi asaj që mos të vij. Trupi gjykues gjen si të dëshmuar faktin që ai ishte i pandehuri i cili e ka penguar H. P. për t'iu bashkuar A. L.. Arsyeja pse i pandehuri nuk dëshironte të merrte H. P. me vete ishte paraqitur në mënyrë tjetër nga i pandehuri dhe nga A. L. dhe H. P.. Trupi gjykues konstaton arsyen e paraqitur nga A. L. dhe H. P. si të saktë pasi që deklaratat e tyre ishin në përputhje me deklaratat e tyre si të besueshme. Arsyeja që ishte dhënë nga i pandehuri ishte shumë e zbehtë.

¹⁴⁹ Raport i seancës së të pandehurit, dosja 1, faqe 52.

180. Pasi që nuk kishte mospërputhje në dëshmimet e të pandehurit dhe A. L. trupi gjykues konstaton si të dëshmuar gjithashtu faktin që pas konsultimit me mjeken i pandehuri mori A. L. prapa në _____.
181. A. L. deklaroi që gjatë rrugës prapa i pandehuri së pari u ndal “në shtëpi”. Ishte kjo deklarata e A. L. që i pandehuri piu kafe përderisa ajo ishte duke pritur në veturë pasi që ajo nuk donte të pinte atë dhe kur u kthye ai përsëri ata vazhduan vozitjen; dhe që i pandehuri u ndal përsëri para pompës së benzinës. Dhe në atë vend i pandehuri kërkoi nga ajo marrëdhënie seksuale me atë në shkëmbim të blerjes së barnave dhe filloi të prek atë dhe të puth atë.
182. I pandehuri deklaroi që ata e parkuan “para restorantit” ku i pandehuri dëshironte të pinte një kafe. Kur A. L. e pyeti atë nëse _____ kishte atje në restorant dhe i pandehuri iu përgjigj që pronari është _____, ajo refuzoi të shkoj në restorant dhe e ktheu kokën në anën tjetër. Kur ajo deklaroi që ajo dëshironte të shkonte në shtëpi, i pandehuri iu përgjigj se ai dëshironte të pinte një kafe; ajo doli nga vetura dhe filloi të ec. Ai e mori atë dhe e solli prapa.
183. Për trupin gjykues nuk është shumë vendimtar fakti se ku saktë ata u ndalën rrugës prapa kur ngjarja sikurse është përshkruar në dispozitiv ka ndodhur; para restorantit apo para pompës së benzinës. Pasi që A. L. nuk kishte qenë në _____ të _____ është e mundshme që përshkrimi i saj të mos jetë i saktë; por fakti që ata janë ndalur rrugës duke u kthyer konsiderohet si e dëshmuar.
184. Trupi gjykues konstaton si të dëshmuar faktin që i pandehuri, kur janë ndalur rrugës duke u kthyer, i propozoi A. L. të ketë marrëdhënie seksuale me atë në shkëmbim të blerjes së barnave, që ai filloi të prek atë në gjoks dhe që ai tentoi të puth atë. Për trupin gjykues është me rëndësi fakti që deklaratat e A. L. gjatë fazës së hetimit, në pikët më vendimtare të tyre nuk janë në kundërshtim me deklaratën e saj të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor. Dhe gjithashtu është me rëndësi që deklarata e saj është në tërësi e vërtetuar me dëshmitë e H. P..
185. Është e vërtetë që para prokurorisë,¹⁵⁰ A. L. nuk e ka përmendur që i pandehuri ka provuar të puth atë, përderisa në seancë më 20 tetor 2014¹⁵¹ ajo deklaroi se ai ka tentuar

¹⁵⁰ Raport i intervistës së palës së dëmtuar – viktimës, dosja 1, faqe 118.

¹⁵¹ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 20 tetor 2014, faqe 20.

të puth atë. Ajo shpjegoi mospërputhjen në seancën e mbajtur më 8 dhjetor 2014 dhe e vërtetoi që “ai [i pandehuri] më është ofruar mua, më preku mua në kraharor dhe unë reagova në këtë mënyrë, duke bërëtitur dhe duke qarë.” Ajo gjithashtu deklaroi “ai u përpoq dhe kjo është arsyeja që më preku në kraharor por ai nuk më puthi mua.”¹⁵²

186. Përshkrimi i ngjarjes është pikë me rëndësi e vërtetuar nga deklaratat e dhënë nga H. P.. Ajo ishte shoqja e ngushtë e A. L. dhe A. L. e thirri atë ditën e njëjtë kur ajo u kthye dhe i tregoi asaj se çfarë i kishte ndodhur asaj. Nuk ka mospërputhje në deklaratat e tyre në lidhje me faktin që i pandehuri i propozoi A. L. të ketë seks me atë nëse ajo donte barnat dhe që ai provoi të rrëmbej atë dhe provoi të puth atë. H. P. nuk dëshmoi incidentin por ajo ishte ajo e cila e thirri menjëherë A. L. pas incidentit që kishte ndodhur dhe e cila i tregoi A. L. të gjitha detajet. Deklarata e H. P. është e besueshme, ajo ishte shoqja e ngushtë e A. L. në atë kohë; më vonë ato u ndanë dhe kur u dëgjuan si dëshmitarë nuk kanë pasur kontakte. Kështu H. P. nuk kishte ndonjë interes të jap deklarata në favor të A. L. dhe mund të besohet.

187. Dhe trupi gjykues konstaton si të dëshmuar faktin që A. L. është _____ e frikësuar dhe e vetme në _____ ndërmjet _____. Edhe pse i pandehuri tentoi të paraqes një frikë të tillë në kuptim tjetër, trupi gjykues nuk e ka përcjell këtë argument. Ky ishte shpjegimi i të pandehurit që ai nuk donte të merrte gjithashtu H. P. tek mjekja sepse ai frikësohej nga arsyeja që ajo nuk fliste _____; dhe që ajo duhet të pres jashtë klinikës kur ai dhe A. L. të vizitonin mjekun. Kjo ishte deklarata e tij që ai frikësohej që diçka mund t'i ndodhte asaj. Me një frikë të tillë i pandehuri gjithashtu konfirmoi faktin që A. L. kishte arsye të frikësohej kur ajo ishte në _____, ndërmjet _____.

188. Fakti që A. L. vuante nga sëmundja e lëkurës – akne në fytyrë të saj nuk ishte e kontestueshme.

189. Trupi gjykues konstaton si të dëshmuar faktin që i pandehuri e mbylli derën e veturës kur filloi të prek A. L.. Edhe pse ai e bëri, trupi gjykues është i mendimit që kjo nuk e ka ndaluar A. L. të hap derën pasi që ajo ishte e ulur në ulësen e përparme.

¹⁵² Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 8 dhjetor 2014, faqe 17.

Megjithatë, trupi gjykues konsideron që kjo rrethanë nuk është vendimtare për vërtetim të fakteve në lidhje me ngjarjen që ka ndodhur.

190. Trupi gjykues nuk i ka kushtuar vëmendje të veçantë gjithashtu të pandehurit kur u pretendua se sa e pabesueshme është për të marrë parasysh që qëllimi i tij ishte të ketë marrëdhënie seksuale me A. L. në veturë; përpara hyrjes së motelit; në mesditë. Nuk ishte përfshirë në pretendimet faktike që i pandehuri kishte ndërmend të kishte marrëdhënie seksuale në veturë kur ata u ndalën para restorantit, kështu ky fakt nuk duhet të provohet.
191. Duke i treguar A. L. që ai kishte bërë marrëdhënie seksuale me S. N.; që ai ishte në lidhje me R. A., që ai do të merrte një patentë shofer për atë; që ajo do të kishte një jetë të mirë; ai u përpoq të gënjente dhe të bind atë që të përfshihet me atë.
192. Bazuar në përfundimet e mësipërme trupi gjykues konstaton si të provuar jashtë dyshimit të arsyeshëm që në _____ të vitit ____ në kohë të panjohur në fshatin _____ – Komuna e _____, i pandehuri i propozoi dhe e mori palën e dëmtuar A. L., e lindur më _____, studente, me përkatësi _____, e cila kurrë më parë nuk kishte qenë në _____ e _____ dhe duke vuajtur nga sëmundja e lëkurës – akne në fytyrë të saj, me automjetin e tij shkuan tek një specialist i lëkurës një mjekë _____ në _____ të _____ (J. I.) e cila e caktoi diagnozën dhe terapinë. Pas konsultimit me mjekun, përshkrimi ishte marrë nga i pandehuri. Pas kërkimit të barnave në _____ të _____ dhe _____, rrugës për në fshatin _____, i pandehuri e ndali veturën afër pompës së benzinës, dhe kërkoi nga pala e dëmtuar që në shkëmbim të blerjes së barnave, ajo duhet të bëjë marrëdhënie seksuale me atë dhe ai filloi të prek atë në gjoks dhe të puth atë. Pala e dëmtuar refuzoi këtë dhe filloi të bërtas dhe qaj, iku nga vetura dhe kishte ndërmend të kërcej nga ura.
193. Prandaj, trupi gjykues e ri-kualifikoi akuzën fillestare të sulmit seksual, në kundërshtim me nenin 195, paragrafi (2), nën paragrafët (2) dhe (3) të KPK dhe e dënoi të pandehurin për kryerje të veprës penale të sulmit seksual, në kundërshtim me nenin 195, paragrafi (2), nën paragrafët (3) të KPK.
194. I pandehuri mori veprimet në drejtim të kryerjes së sulmit të cekur në pikën e mëparshëm. Pasi që A. L. refuzoi të ketë marrëdhënie seksuale me atë dhe iku nga vetura kur i pandehuri e preku atë dhe provoi të puth atë, vepra penale nuk është

përfunduar dhe trupi gjykues e dënoi të pandehurin për kryerjes të veprës së tentuar penale sipas nenit 20 të KPK.

H. Pika 8

195. Sipas pikës 8 i pandehuri është akuzuar që nga _____ i vitit ____ deri në _____ në vendin e tij tek _____ në _____ të _____ ai e ka detyruar palën e dëmtuar A. F. të ketë marrëdhënie seksuale pa pëlqimin e saj në mënyrë që i pandehuri kërkoi nga ajo të ketë marrëdhënie seksuale dhe në momentin që ajo do të refuzoj të bëjë atë, i pandehuri iu kërcënuar asaj që në rast se ajo do të refuzonte të ketë marrëdhënie seksuale me atë, ai do të përhapte fjalët që ai kishte marrëdhënie seksuale me atë kështu që familja e saj do të zbulonte këtë kështu pala e dëmtuar ishte e detyruar të pranojë në epshin e tij seksual deri në momentin e arrestimit të tij; kështu vepra penale e dhunimit, në kundërshtim me nenin 193, paragrafi (2) në paragrafët (3) të KPK.
196. Ishte dëshmia e A. F. gjatë shqyrtimit gjyqësor më 16 tetor 2014 që ajo e takoi të pandehurin përmes S. T.. S. T. e pyeti A. F. “a doni të pini kafe me një shok shumë të mirë timin?” dhe pastaj i pandehuri e mori S. T., A. F. dhe mostrën e saj B. F. me veturë të tij në _____ ku ata pinë kafe.¹⁵³
197. Ata qëndruan në Restorantin ____ në _____ për tre orë, ata biseduan, i pandehuri e pyeti atë në lidhje me shkollën, nëse ajo ishte e martuar, nëse kishte të dashur, a dilte shpesh me S. T..¹⁵⁴ I pandehuri nuk i dha asaj numrin e telefonit por ai i kërkoi asaj numrin e telefonit dhe A. F. i dha atij numrin e motrës së tij sepse ajo kishte të dashur në atë kohë. Pastaj i pandehuri i voziti ata prapa në _____.¹⁵⁵
198. Tre deri në katër ditë më vonë i pandehuri e thirri atë për të dalë me S. T.. A. F. nuk dëshoi të dilte atë ditë.¹⁵⁶

¹⁵³ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 16 tetor 2014, faqet 4, 22 dhe 41.

¹⁵⁴ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 16 tetor 2014, faqe 22.

¹⁵⁵ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 16 tetor 2014, faqe 23.

¹⁵⁶ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 16 tetor 2014, faqe 25.

199. Herën tjetër i pandehuri e thirri A. F. përsëri: ajo nuk deshi të dilte por atëherë i pandehuri i tha që ai do të thirrte S. T.. Kur S. T. e thirri A. F., ata u takuan me të pandehurin në restorant _____, i pandehuri i dha të holla S. T., ato i ndanë dhe A. F. piu kafe vetëm me S. T..¹⁵⁷
200. A. F. deklaroi që takimin tjetër në restorant _____ kishte qenë. I pandehuri e thirri atë në telefon të motrës së saj duke kërkuar nga ajo të dilnin; A. F. doli me atë dhe nga ajo ditë ai e detyronte atë të dal me të duke i thënë “prej këtij momenti ju do të jeni me mua”, “ju do të jeni me mua sepse më pëlqen”. Dhe kur A. F. e pyeti atë “si mundem të jem me ju kur unë mund të jem e bija jote”, i pandehuri tha “mos e thuaj atë”. I pandehuri i tregoi asaj se ai donte të martonte atë, që ai e dashuronte atë me zemër të tij kur A. F. e pyeti “si mund të jem gruaja jote, unë mund të jem e bija jote,” ai u përgjigj “nuk e qaj kokën, unë nuk i shikoj këto gjëra”. I pandehuri gjithashtu i tha asaj “ju do të jeni me mua deri në kohën kur ju të martoheni, ju do të jeni e imja.” A. F. deklaroi që ajo ndjeu që ai ishte një person i rrezikshëm dhe prej atij momenti ajo frikësohej nga ai.¹⁵⁸
201. Herën tjetër kur A. F. e takoi të pandehurin ishte verë; ishte shumë nxehtë dhe ajo doli me S. T.. Ata u ndanë; S. T. shkoi me një person tjetër dhe A. F. mbeti me të pandehurin. Ata shkuan deri në _____ dhe u kthyen prapa, i pandehuri ishte duke i treguar asaj rreth jetës së tij, rreth punës së tij, familjes së tij.¹⁵⁹
202. Pas këtij takimi, i pandehuri e thirri A. F. në telefon të motrës së saj duke i treguar asaj që ajo duhej të dilte. Herën tjetër kur ata u takuan, ai e mori atë rreth 40 metra afër shtëpisë së saj; ai erdhi me veturë të tij, me ngjyrë të _____ dhe e mori atë në shtëpi të tij në _____.¹⁶⁰
- A. F. e ka përshkruar sikur shtëpi dykatëshe , kati i parë është marrë me qira nga një familje dhe apartamenti i tij ishte ne katin e dytë. Aty ishin tri dhoma ,një kuzhinë, një tualet dhe një korridor. A. F. dhe i pandehuri kanë ndenjtur në kuzhinë’ ai e kishte një lëng, ishin duke biseduar dhe më pas i pandehuri i kishte thënë asaj: “hajde në dhomë.” A. F. ka thënë “jo, nuk dua të vij” dhe i pandehuri iu ka përgjigjur “ s’ më behet vonë”.

¹⁵⁷ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 16 tetor 2014, faqe 26.

¹⁵⁸ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 16 tetor 2014, faqet 27 dhe 28.

¹⁵⁹ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 16 tetor 2014, faqe 29.

¹⁶⁰ Procesverbal i shqyrtimit gjyqësor më 16 tetor 2014, faqe 29.

A. F. ka deklaruar se ishte e frikësuar dhe e shikonte atë; ai i rrudhte vetullat dhe ishte i çuditshëm dhe ajo ishte e vetme aty.¹⁶¹

203. A. F. ka shkuar në dhomë ku ishte vetëm një shtrat , një tavolinë dhe dy a po tre dyshekë. I pandehuri i ka thënë që të zhvishet; ajo është zhveshur dhe është shtrire në shtrat. I pandehuri e ka prekur atë , ajo nuk e lejoi që ta puth në gojë dhe ka ndjere neveri; ajo vetëm qëndroi aty e shtrire. Pastaj kanë kryer marrëdhënie seksuale, i pandehuri ishte sipër asaj, ai depërtoi , dëshmitarja tentoi që ta largoj , ajo e mbajti pjesën e sipërme të trupit të tij dhe i tha” largohu.” Ai nuk ndaloi deri sa e përfundoi. Gjithçka ka zgjatur pesëmbëdhjetë minuta. Pastaj ajo është larë dhe i pandehuri e bëri të njëjtën, ajo u vesh dhe pastaj i pandehuri e dërgoi në shtëpi.¹⁶²

204. Para se ta dërgonte në shtëpi , ai ia dha 50 euro. A. F. ka deklaruar se ai nuk deshi t’i merr ato para por ai e shtyri dhe ia futi paratë në xhepin e saj.¹⁶³

205. Pas kësaj ngjarje ata nuk u takuan për një kohe sepse familja e asaj nuk e lejonte të dilte nga shtëpia , ata e pyetnin se ku po shkonte. I pandehuri e telefonoi të nesërmen por ajo nuk u përgjigj. Pastaj i pandehuri ka thënë: “ pse nuk u përgjigje ne telefonatën time” dhe “ ti duhet të përgjigjesh kurdo që unë të telefonoj”.

206. Ata u takuan pas një jave ; dolën për kafe në një kafene afër ndërtesës e _____ për 30 minuta, ishte ne kohën e pushimit e tij.

207. Që nga kjo kohe ata janë takuar vetëm në shtëpinë e tij në _____. Ai zakonisht e merrte atë ne lokacionin e njëjtë si më parë dhe e dërgonte në shtëpinë e tij në _____. Dëshmitarja i ka thënë se nuk dëshiron të dal më të; ajo nuk dëshironte të shihej me të . Dhe i pandehuri i ka thënë “ Në rregull. E kam një shtëpi” dhe kur dëshmitarja i ka thënë “do të me shohin njerëzit me juve”, ai është përgjigjur “vetëm përkule kokën “. Dhe dëshmitarja ka deklaruar se deri sa e kalonin urën, koka e saj ishte e përkulur poshtë.¹⁶⁴ Ajo ishte ne shtëpinë e tij shumë herë ; katër herë në javë. Shumicën e kohës ata kishin marrëdhënie seksuale , ndonjëherë A. F. nuk donte; ata vetëm qëndronin në shtëpi një kohë dhe

¹⁶¹ Procesverbali i seancës të shqyrtimit gjyqësor më 16 tetor 2014, faqet 29 dhe 30.

¹⁶² Procesverbali i seancës të shqyrtimit gjyqësor më 16 tetor 2014, faqet 31 dhe 32.

¹⁶³ Procesverbali i seancës të shqyrtimit gjyqësor më 16 tetor 2014, faqe 33.

¹⁶⁴ Procesverbali i seancës të shqyrtimit gjyqësor më 16 tetor 2014, faqe 35.

pastaj ai e dërgonte në shtëpi.¹⁶⁵ Lidhja e tyre ka zgjatur një vit. I pandehuri i jepte shuma të vogla të hollave nga 10,20 euro kur ajo ishte në shtëpinë e tij, por jo çdo herë.¹⁶⁶

208. A. F. ka deklaruar se në fillim ka bërë seks me të pandehurin me dëshiron e saj.¹⁶⁷ Pas gjashtë muajve,¹⁶⁸ kur ai i tha të pandehurit që dëshiron të ndahet nga ai, i pandehur i ka thënë “ ne rregull, vetëm i ktheni parat që ia kam dhënë.” Ajo nuk mund t’ia jepte paratë dhe ai ka thënë: ”në rregull, nëse nuk mund të mi japësh paratë, atëherë do të vish kur unë të them të vish, dhe kur të mbaron me kthimin e këtyre parave, do të vish tri herë në ditë.”¹⁶⁹ I pandehuri e frikësoj atë duke i thënë se ai do të vinte të shtëpia e saj për ta turpëruar atë dhe për ti vrare anëtarët e saj të familjes, vëllezërit.¹⁷⁰ Kur A. F. i tha “Nuk dëshiroj të jem me ty më”, i pandehuri i ka thënë: “nuk po e kupton. Nga dita e parë që ju kam parë, nuk do t’ju lë asnjëherë. Do të mendoj dy herë kur ju të martoheni, nëse do t’ju lejoj që të shkoni apo jo.” Dhe kur A. F. i tha: “ndoshta nuk do të martohem për dhjetë vite”, dhe ai i ka thënë “do të jeni me mua për 10.”¹⁷¹

209. Ai e telefononte atë për çdo ditë, dhe kur nuk përgjigjej, ai e pyeste perse ajo nuk është përgjigjur. Ajo i ka thënë: “nuk mund te përgjigjem çdo here. Edhe te ishit burri ime nuk mund te përgjigjem gjate gjithë kohës.” Kur ajo e tha këtë, i pandehuri ka thënë: “tani e tutje me ju do te sillem ndryshe”, dhe po ashtu: “kur t’ju kërkoj që të dilni me mua dhe ju refuzoni, ju do te keni probleme me mua”. Ai ka thënë se do të fliste me të dashurin e saj dhe do ti tregonte për lidhjen e tyre. Ai i ka thënë: “do t’ju truprojë.” dhe “Do te vij brenda në shtëpinë tuaj, nuk frikësohem.”¹⁷² Ai po ashtu thoshte: “Dëshiroj të të shoh saktë në orën gjashtë dhe nëse nuk vjen atëherë do të vij të të marr.”¹⁷³

210. Deklarata e A. F. është vërtetuar me dëshminë e motrës e saj B. F.. Ne seancën që është mbajtur me 2 dhjetor 2014 ajo ka deklaruar se ai ishte bashke me A. F. dhe S. T. dhe S. T. ka thënë:” E kam një mik, ai është njeri i mirë dhe nëse dëshiron mund të dalim me te.” B. F. ishte 17 vjeçare ne atë kohë dhe

¹⁶⁵ Procesverbali i seancës të shqyrtimit gjyqësor më 16 tetor 2014, faqet 35 dhe 36.

¹⁶⁶ Procesverbali i seancës të shqyrtimit gjyqësor më 16 tetor 2014, faqe 19 dhe 36.

¹⁶⁷ Procesverbali i seancës të shqyrtimit gjyqësor më 16 tetor 2014, faqet 7 dhe 12.

¹⁶⁸ Procesverbali i seancës të shqyrtimit gjyqësor më 16 tetor 2014, faqe 38

¹⁶⁹ Procesverbali i seancës të shqyrtimit gjyqësor më 16 tetor 2014, faqe 8.

¹⁷⁰ Procesverbali i seancës të shqyrtimit gjyqësor më 16 tetor 2014, faqet 10 dhe 17.

¹⁷¹ Procesverbali i seancës të shqyrtimit gjyqësor më 16 tetor 2014, faqe 38.

¹⁷² Procesverbali i seancës të shqyrtimit gjyqësor më 16 tetor 2014, faqet 33 dhe 34.

¹⁷³ Procesverbali i seancës të shqyrtimit gjyqësor më 16 tetor 2014, faqe, faqe 20.

motra e saj A. F. ishte 20 vjeçare.¹⁷⁴ I pandehuri i dërgoj ato në _____ dhe kjo ishte hera e parë që aho ia ka dhënë të pandehurit numrin e saj të telefonit..¹⁷⁵

211. Ajo po ashtu ka deklaruar se motra e saj A. F. ka pasur lidhje me të pandehurin për një vit; ajo nuk ishte me të me vullnetin e saj; pas takimit të tyre të parë , ai nuk e lente atë. Ajo ishte bashke me A. F. në shtëpinë e të pandehurit dy herë në javë, I pandehuri i ka dhënë motrës të saj para; qëllimi ishte për marrëdhënie seksuale.¹⁷⁶
212. Kur ajo dëgjoi se A. F. ishte në lidhje dashurore me të pandehurin , ajo diskutoi me A. F. dhe A. F. i ka thënë se nuk mundet t ndahet nga ai sepse ai i thoshte “ ose me i sjell paratë apo përndryshe ...”¹⁷⁷ B. F. kërkoi nga A. F. që të ndahet me të pandehurin por ajo ka thënë “ nuk guxoj.”¹⁷⁸
213. Ishte dëshmia e B. F. që i pandehuri e ka kontaktuar motrën e saj përmes telefonit të saj. Ai e telefononte B. F. dhe kërkonte që t’ia kalon telefonin motrës të saj.¹⁷⁹
214. B. F. ka deklaruar se A. F. ka dëshiruar ta ndalte lidhjen e saj me të pandehurin përafërsisht pas gjashtë muajve ; B. F. ishte 17 vjeçare në atë kohë.¹⁸⁰ Dhe A. F. nuk mund ta ndërpriste sepse i pandehuri e kërcënonte atë duke i thënë: “ose hajde, ose do të vij të familja jote dhe do të të turpëroj dhe do ti vras vëllezërit.”¹⁸¹
215. B. F. ishte dëshmitare kur A. F. dhe i pandehuri shkuan në dhomën tjetër dhe A. F. i tha të pandehurit: “dëshiroj të ndahem nga ti,” përderisa ajo ishte duke qëndruar në kuzhine dhe i pandehuri i ka thënë: “Jo. Ti asnjëherë nuk duhet të ndahesh nga unë apo duhet të mi kthesh 900 euro, ose do të vij të shtëpia jote. Do ti tregoj familjes tende.” Dhe A. F. po ashtu i tregoi se i pandehuri i ka thënë: “ nëse nuk del me mua, do të vij në shtëpinë tende; do të ti vras vëllezërit.”¹⁸²

¹⁷⁴ Procesverbali i seancës të shqyrtimit gjyqësor më 2 dhejtor 2014, faqe 4.

¹⁷⁵ Procesverbali i seancës të shqyrtimit gjyqësor më 2 dhejtor 2014, faqe 9.

¹⁷⁶ Procesverbali i seancës të shqyrtimit gjyqësor më 2 dhejtor 2014, faqe 5.

¹⁷⁷ Procesverbali i seancës të shqyrtimit gjyqësor më 2 dhejtor 2014, faqe 9.

¹⁷⁸ Procesverbali i seancës të shqyrtimit gjyqësor më 2 dhejtor 2014, faqe 10.

¹⁷⁹ Procesverbali i seancës të shqyrtimit gjyqësor më 2 dhejtor 2014, faqe 7.

¹⁸⁰ Procesverbali i seancës të shqyrtimit gjyqësor më 2 dhejtor 2014, faqe 15.

¹⁸¹ Procesverbali i seancës të shqyrtimit gjyqësor më 2 dhejtor 2014, faqe 6.

¹⁸² Procesverbali i seancës të shqyrtimit gjyqësor më 2 dhejtor 2014, faqe 16.

216. B. F. po ashtu deklaroi se A. F. për herë të parë ka pasur marrëdhënie seksuale me të pandehurin me pëlqimin e saj. Ajo dëshmoi se motra e saj nuk dinte asgjë dhe është mashtruar.¹⁸³
217. Për gjykatën është i rëndësishëm fakti se deklaratën që A. F. e ka dhënë gjatë fazës hetimore nuk është në kundërshtim në pikat më të rëndësishme me deklaratën e saj gjatë seancës të shqyrtimit gjyqësor. Ajo e ka dhënë deklaratën në polici më 4 qershor 2013. Ajo ka deklaruar se është takuar me të pandehurin përmes S. T., ata kanë shkuar në një restorant në _____ dhe dëshmitarja ia ka dhënë atij numrin e telefonit të motrës e saj. Ajo e filloi lidhjen seksuale me atë dhe i pandehuri i ka dhënë para. Ai deshi ta ndërpriste lidhjen por i pandehuri i ka thënë se ajo duhet ti kthej paratë që ai ia kishte dhënë, se do ti tregonte të gjithëve dhe po ashtu do të vinte ne shtëpinë e saj.¹⁸⁴
218. A. F. e ka dhënë deklaratën para prokurorit më 13 gusht 2013. Ajo ka deklaruar se e ka takuar të pandehurin përmes S. T. dhe ia ka dhënë numrin e telefonit të motrës të saj. Ajo po ashtu deklaroi se ata kanë filluar marrëdhënien seksuale dhe i pandehuri i ka dhënë para. Ai vazhdoi me te për t'ia kthyer paratë dhe kur dëshiroj të ndaloj ai i ka thënë: “ vetëm sipas kushteve të mija, ti kthesh 900 euro”. Ai vetë e llogariti se ajo ia ka borxh 900 euro dhe kur ajo nuk deshi të shkoj me te , ai i ka thënë se do të vinte të shtëpia e saj , do ti tregonte te gjithëve, gjithandej në Facebook. Dhe kur dëshmitarja i tha se do ti pastronte tualetet por do t'ia kthente paratë , ai ka thënë” “ nëse dëshiron të punosh hajde te unë, dhe do ti jap 5 euro për një natë. Dhe do të besh ashtu siç them unë.” Ai po ashtu i ka thënë: “ ose më i paguaj të gjitha paratë në para të gatshme ose unë asnjëherë nuk do të le të lirë.”¹⁸⁵
219. Gjatë seancës të shqyrtimit gjyqësor më 28 janar 2015 i pandehuri ka deklaruar se ai është njoftuar me A. F. përmes S. T. më __ _____. S. T. e telefonoi atë dhe më pas ai është takuar me S. T., A. F. dhe motrën e saj më të re B. F.. Ata shkuan se bashku në _____.¹⁸⁶
220. Pas këtij takimi , ai është takuar me A. F. për çdo ditë. Marrëdhënien e parë seksuale e kanë pasur pas tre ditëve. Ishin në shtëpinë e tij në veri dhe kanë kryer

¹⁸³ Procesverbali i seancës të shqyrtimit gjyqësor më 2 dhejtor 2014, faqe 12.

¹⁸⁴ Procesverbali I intervistës të palës se dëmtuar- viktimës binderi 1, faqet 126 dhe 127.

¹⁸⁵ Procesverbali I intervistës të palës se dëmtuar- viktimës binderi 1, faqet 133 dhe 134.

¹⁸⁶ Procesverbali i seancës të shqyrtimit gjyqësor më 28 Janar 2015, faqe 15.

marrëdhënie seksuale gjithnjë në shtëpinë e tij. I pandehuri ka deklaruar se asnjëherë nuk kanë bërë seks pa vullnetin e saj. Ndonjëherë ajo refuzonte dhe i pandehuri këtë e ka konsideruar normale pasi që nuk ishin se bashku për një kohë të gjatë. Ishin shumë të afërt; ishin sikur bashkëshorte të pamartuar.¹⁸⁷

221. Në fillim gjatë tre muajve të parë askush nuk ishte i pranishëm derisa a ata kryenin marrëdhënie seksuale. Pastaj A. F. është pajtuar me të dashurin e saj dhe e merrte motrën e saj më të re B. F. në mënyrë që mos të ekspozohet dhe që të tjerët mos ta zbulojnë se ajo ishte me dikë tjetër. Kur ata ishin se bashku, B. F. qëndronte në dhomën tjetër dhe shikonte televizorin.¹⁸⁸

222. I pandehuri e kishte numrin e telefonit të A. F. pasi që ajo ia kishte dhënë. Ai po ashtu e kishte numrin e telefonit të motrës e saj më të re B. F..¹⁸⁹

223. I pandehuri ka deklaruar se A. F. asnjëherë nuk i kishte kërkuar që ta përfundonte lidhjen. Ata ishin se bashku deri në ditën kur ai është arrestuar. Ajo ishte me të vullnetarisht. Ata flisnin përmes telefonit dhe pajtoheshin që të dilnin. A. F. zakonisht e telefononte rreth orës dhjetë kur u zgjonte nga gjumi, ia bënte një zile dhe ai e telefononte.¹⁹⁰

224. I pandehuri ka deklaruar se për herë të parë ia ka dhënë A. F. 50 euro për ti ruajtur. Ai nuk e din se për çfarë ajo i ka shpenzuar këto para por pas dy apo tre ditëve ia ka sjellë tri këmisha si dhuratë. Ai ka deklaruar se asnjëherë nuk i kishte kërkuar A. F. që t'ia kthente paratë.¹⁹¹

225. Në pyetjen e prokurorit i pandehuri ka deklaruar se ai i ka dhënë A. F. 50 euro në ditën e parë të çdo muaji kur e merrte rrogën. Ai i jepte para sepse asaj i pëlqente të hajë në restorantin ____ afër shkollës se mesme që vijonte motra e saj. Ai ka deklaruar që i ka dhënë para asaj që ato të dyja të shkonin të pinin kafe.¹⁹²

226. I pandehuri e ka dhënë deklaratën para prokurorit në fazën hetimore më 3 qershor 2013. Lidhur me ngjarjet që kanë të bëjnë me A. F. ai ka deklaruar se S. T i ka thënë atij që të shkoj të takohet me shoqen e saj e cila ishte e shkurorëzuar dhe është

¹⁸⁷ Procesverbali i seancës të shqyrtimit gjyqësor më 28 Janar 2015, faqe 16.

¹⁸⁸ Procesverbali i seancës të shqyrtimit gjyqësor më 28 Janar 2015, faqe 17.

¹⁸⁹ Procesverbali i seancës të shqyrtimit gjyqësor më 28 Janar 2015, faqe 16.

¹⁹⁰ Procesverbali i seancës të shqyrtimit gjyqësor më 28 Janar 2015, faqet 17 dhe 18.

¹⁹¹ Procesverbali i seancës të shqyrtimit gjyqësor më 28 Janar 2015, faqet 17 dhe 18.

¹⁹² Procesverbali i seancës të shqyrtimit gjyqësor më 28 Janar 2015, faqe 19.

ndare nga i dashuri i saj. Ai ka deklaruar se ka dalë me A. F. nga __ _____ deri ne __ të _____. Ata janë takuar pothuajse për çdo ditë , pastaj ajo është kthyer tek i dashuri i saj dhe janë takuar rrallë më pas. Ai i ka dhënë para 10 – 20 euro por jo për të bërë seks. Ai asnjëherë nuk i ka kërcënuar asaj ; ai nuk i kërkoi që ajo t’ia kthente paratë që ai ia kishte dhënë. Ai e ka marr B. F. në mënyrë që i dashuri i saj mos të dyshonte asgjë. Ai ka deklaruar se ishte me A. F. 22 orë para arrestimit të tij dhe gjithnjë janë takuar me pëlqimin e të dyve.¹⁹³

227. Bazuar në të gjitha gjetjet faktike të përmendura më lartë dhe provat e prezantuara , gjykata konsideron si fakt të provuar se A. F. e ka takuar të pandehurin përmes S. T.. Kjo është konfirmuar nga A. F. dhe i pandehuri.

228. Fillimisht dëshmitarja ka deklaruar se ishte 20 vjeçare kur është takuar me të për herë të parë.¹⁹⁴ Më vonë ajo ka deklaruar se ajo ka mbushur 21 vjet kur ishte në lidhje me të pandehurin dhe që lidhja ka zgjatur për një vjet dhe është ndërprerë kur është arrestuar i pandehuri. Sipas kësaj dhe faktit që ajo ka lindur më __ _____ , ajo ishte 21 vjeçare , pothuajse 22 vjeçare kur e filloi lidhjen me të pandehurin.¹⁹⁵ Gjykata nuk e konsideron mospërputhjen në deklaratën e A. F. për moshën e saj në kohën kur e ka takuar apo filluar lidhjen me të pandehurin sikur shumë vendimtare. Në cilindo rast dëshmitarja nuk ishte e mitur kur është takuar me të pandehurin për herë të parë. Megjithatë, është normale se disa njerëzve mund ti kujtohen datat e sakta e ngjarjeve që kanë ndodhur ; dhe të tjerëve nuk mund t’ju kujtohen.

229. Sipas deklaratës të A. F. lidhja ka zgjatur për një vjet. Sipas deklaratës të pandehurit ata janë takuar për herë të parë më __ _____ dhe ishin se bashku deri më __ _____ . Trupi gjykues nuk e konsideron këtë mospërputhje si vendimtare pasi që nuk është thelbësore për çështjen.

230. Gjykata e konstaton si fakt të provuar se në fillin A. F. kishte marrëdhënie seksuale më të pandehurin me vullnetin e saj. Ishte deklarata e A. F. dhe e të pandehurit të cilit kanë deklaruar se ai asnjëherë nuk kishte marrëdhënie seksuale me A. F. kundër vullnetit të saj.

¹⁹³ Procesverbali i seancës dëgjimore , binderi 1 faqet 54 dhe 55.

¹⁹⁴ Procesverbali i seancës të shqyrtimit gjyqësor më 16 tetor 2014, faqe 9.

¹⁹⁵ Procesverbali i seancës të shqyrtimit gjyqësor më 16 tetor 2014, faqe 37.

231. Fakti se i pandehuri i ka dhënë para A. F. nuk është kontestues. A. F. ka deklaruar se kur ishte në shtëpinë e tij i pandehuri i jepte shuma të vogla të parave të 10, 20 euro, por jo për çdo herë. Ishte deklarata e të pandehurit se ai ia kishte dhënë 50 euro herën e parë dhe me pas 50 euro për çdo muaj kur e merrte rrogën.
232. A. F. ka deklaruar në gjykatë se i pandehuri ia ka dhënë 50 euro kur ishte në shtëpinë e tij dhe ata kanë bërë seks për herë të parë. Ne deklaratën e saj në Polici ¹⁹⁶ ajo ka deklaruar se ai ia ka dhënë 50 euro kur janë takuar për herë të parë në restorant në _____, ku ishin bashkë me S. T.. Gjate seancës dëgjimore më 8 dhjetor 2014 ajo e shpjegoi mospërputhjen dhe konfirmoi se i pandehuri ia ka dhënë 50 euro për herë të parë në shtëpinë e tij dhe jo në _____.¹⁹⁷
233. Pas gjashtë muajve A. F. desh i ta ndërpriste lidhjen me të pandehurin. Ishte dëshmia e A. F. se ajo i ka thënë të pandehurit se dëshironte të ndahej nga ai. I pandehuri e ka mohuar këtë duke shpjeguar se ajo ka mundur ta ndërprerës lidhjen kurdo që ajo ka dëshiruar, pasi që ajo e kishte lënë bashkëshortin e saj pas 3 muajve dhe 1 jave martesë. Trupi gjykues e konstaton si fakt të provuar pasi që B. F., motra e A. F. ishte e pranishme në shumicën e rasteve kur A. F. ishte në shtëpinë e tij. B. F. po ashtu ishte dëshmitare kur A. F. i ka thënë të pandehurit se ajo dëshiron të ndahet nga ai dhe i pandehuri iu është përgjigjur duke thënë: “ Jo. Ti nuk duhet të ndahesh nga unë asnjëherë, apo duhet të mi kthesh 900 euro , përndryshe do të vij në shtëpinë tende. Do ti tregoj familjes tënde.”¹⁹⁸
234. Përfundimisht, trupi gjykues po ashtu konstaton si fakt të provuar se pasi që A. F. i ka thënë të pandehurit se dëshiron të ndahej nga ai , ajo është shtyrë të vazhdoj të ketë marrëdhënie seksuale me te. Edhe pse i pandehuri i ka mohuar pretendimet e tilla, gjykata konsideron se deklaratën të cilën A. F. e ka dhënë gjate seancave të shqyrtimit gjyqësor më 10 nëntor 2014 dhe më 8 dhjetor 2014 si të besueshme. Ajo e ka dhënë një tregim të hollësishëm të ngjarjeve se si i pandehuri e kërcënoi atë dhe e shtyri të vazhdoj lidhjen.; dëshmitë e saj lidhur me kërcënimet janë të qëndrueshme.
235. Kërcënimet po ashtu janë konfirmuar nga B. F. e cila ishte dëshmitare në atë se si është përgjigjur i pandehuri kur A. F. i ka thënë se ajo do të ndahej nga ai. B. F.

¹⁹⁶ Procesverballi I intervistës të palës së dëmtuar- viktimës binderi 1, faqe 126.

¹⁹⁷ Procesverballi i seancës të shqyrtimit gjyqësor më 8 dhjetor 2014, faqe 12.

¹⁹⁸ Shih pikën 215.

ishite me A. F. në shumë raste kur A. F. ishte bashkë me të pandehurin në shtëpinë e tij; kjo po ashtu ishte deklarata e të pandehurit. B. F. e ka ditur se A. F. kishte marrëdhënie seksuale me të pandehurin; ajo kërkoj nga A. F. që të ndahej nga ai dhe A. F. iu është përgjigjur :” Nuk guxoj.” B. F. po ashtu dëshmoi se çfarë i kishte thënë A. F. për përgjigjen e të pandehurit kur ajo deshi të ndahej nga ai.

236. Lidhur me numrin e telefonit që i përket B. F., A. F. ka deklaruar se ajo nuk ia ka dhënë motrës të saj SIM kartelën dhe as nuk është e vërtet që i pandehuri ia ka dhënë asaj SIM kartelën. A. F. shpjegoi se motra e saj B. F. e ka blerë atë vete dhe nuk është e vërtet se ka qenë SIM kartela e **D. K.**¹⁹⁹

237. Lidhur me mospërputhjet ne deklaratat e dëshmitares B. F. dhe A. F. kur ato ishin bashkë me të pandehurin në _____, A. F. ka deklaruar se ky takim ka ndodhur pasi që ajo tashmë ka qenë në shtëpinë e të pandehurit në _____.²⁰⁰ Gjykata konsideron deklaratën e A. F. si të saktë pasi që ajo ka deklaruar se B. F. në fillim nuk ishte gjithnjë e pranishme kur ajo e takonte të pandehurin.

238. Bazuar në të gjitha faktet e sipërpërmendura Gjykata konstaton si fakt të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm që nga _____ i vitit _____ deri më _____ në shtëpinë e tij e cila gjendet në _____ ne _____ të _____, i pandehuri e ka detyruar palën e dëmtuar A. F. të vazhdoj të ketë marrëdhënie seksuale disa herë pa pëlqimin e saj, ashtu që kur ajo i ka thënë të pandehurit se dëshironte të ndaloj marrëdhëniet seksuale me atë, i pandehuri e kërcënoi atë me përhapjen e fjalës që ajo ka pasur marrëdhënie seksuale me atë, kështu që familja e saj do ta zbulonte këtë, ai do të vinte në shtëpinë e saj, ta turpëronte atë, ti tregonte vëllezërve të saj për lidhjen e tyre. Edhe pse A. F. dhe motra e saj deklaruan kështu, trupi gjykues ke konsideron jo të provuar se i pandehuri e kërcënoi A. F. duke i thënë se ai do ti vriste vëllezërit të saj.

239. Prandaj, trupi gjykues e ka ri kualifikuar akuzën fillestare të dhunimit, në kundërshtim me nenin 193, paragrafi (4) lidhur me paragrafin (2) nën paragrafin (3) të KPK-së dhe e ka dënuar të pandehurin për kryerjen e veprës penale të dhunimit, kundërshtim me nenin 193, paragrafi (1) i KPK-së.

¹⁹⁹ Procesverbal i seancës të shqyrtimit gjyqësor më 8 dhjetor 2014, faqe 13.

²⁰⁰ Procesverbal i seancës të shqyrtimit gjyqësor më 8 dhjetor 2014, faqe 13.

I. Akuza 9

240. Në akuzën 9 i pandehuri është akuzuar me një kohë të panjohur që nga _____ _____ deri më _____ _____ në vendin si në akuzën 1 të dispozitivit më qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete , ai e ka kanosur palën e dëmtuar A. F. që të kryej një veprim , kështu që fillimisht pasi që i ka dhënë palës së dëmtuar kohë pas kohe shumen e parave nga 20 – 50 euro, dhe kur pala dëmtuar i ka thënë se ajo dëshironte ti ndal kontaktet me të , i pandehuri e ka kanosur seriozisht dhe e detyroi atë të kryej akt seksual me te apo t’ia kthej 900 euro , kur pala e dëmtuar i kërkoi të ja jep dy muaj deri sa ta gjen një punë, ai i thotë asaj: “ një natë seks me mua dhe 5 euro do të hiqen nga borxhi i yt”, prandaj ka kryer veprën penale të Mundësimit ose detyrimi në prostitucion në kundërshtim me nenin 241, paragrafi (3) me reference në nenin 228, paragrafi (8) të KPRK.
241. Ishte dëshmia e A. F. gjate seancës të shqyrtimit gjyqësor se i pandehuri ia ka dhënë asaj 50 euro kur kanë kryer marrëdhënie seksuale për herë të parë. Me vonë ai i jepte asaj shuma të vogla të parave 10, 20 euro kur ajo ishte në shtëpinë e tij , por jo çdo herë.²⁰¹
242. Deklarata e A. F. është vërtetuar me deklaratën e B. F..²⁰²
243. Ishte dëshmia e të pandehurit se ai ia ka dhënë asaj 50 euro kur kanë kryer marrëdhënie seksuale për herë të parë dhe më vonë ia ka dhënë 50 euro për çdo muaj kur e merrte rrogën.²⁰³
244. I pandehuri ka deklaruar gjatë seancës të shqyrtimit gjyqësorë më 28 janar 2015 se ai asnjëherë nuk ushtri dhunë ndaj askujt. Ai asnjëherë nuk e kërkoi nga A. F. shumen e 900 eurove dhe asnjëherë nuk i ka thënë asaj se një natë seks me të për 5 euro do të zbritet nga borxhi i saj. Ai deklaroi se asnjëherë nuk e detyroi A. F. ti pranoj paratë ; ai ia ka dhënë paratë asaj për nevojat e saja.²⁰⁴

²⁰¹ Shih piken 207.

²⁰² Shih piken 211.

²⁰³ Shih piken 225.

²⁰⁴ Procesverbali i seancës të shqyrtimit gjyqësor më 28 Janar 2015, faqe 21.

245. Trupi gjykues konsideron se i pandehuri ne rastin kur ai kërkoi nga A. F. t'ia kthente 900 euro i ka përdor kërcënimet për ta detyruar A. F. të vazhdoj lidhjen e tyre seksuale dhe si të tilla tashme janë marr parasysht në akuzën paraprake.
246. Mund të jetë çështja e bashkimit të dy veprave penale kur kryesi me një apo më tepër veprime kryen disa vepra penale.
247. Megjithatë, bazuar në të gjitha gjetjet faktike të mëparshme, provat e paraqitura dhe përshkrimin faktik siç është prezantuar në dispozitivin e aktakuzës trupi gjykues nuk mund të konstatojë si të provuar se i pandehuri më veprim të tillë po ashtu ka kryer veprën me të cilën është akuzuar me akuzën 9. Prandaj, trupi gjykues e liron sipas nenit 364, paragrafi (1) nën- paragrafi (1.3) të KPK-së.

VII. Arsyetim ligjor

A. Akuza 1

248. I pandehuri e ka kryer veprën penale të *keqpërdorimit seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet*, në kundërshtim me nenin 198, paragrafi (1) i KPK-së. Në këtë nen thuhet:
- (1) Kushdo që e detyron personin nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet për të kryer akt seksual dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet [...]*
249. Elementet objektive të veprës penale janë plotësuar. I pandehuri ka pasur disa herë marrëdhënie seksuale me S. N. në shtëpinë e tij në Mitrovicën veriore kur S. N. ishte nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet.
250. Edhe pse i pandehuri e ka dhënë datën e saktë se kur e ka pasur marrëdhënien seksuale me S. N. për herë të parë, është vërtetuar bazuar në prova se ai ka pasur marrëdhënie seksuale me të para se ajo i ka mbushur 16 vjet.
251. S. N. ishte 15 vjeçare kur është takuar me të pandehurin për herë të parë. Është njoftuar me të përmes shoqes e saj S. T.. I pandehuri e ka njohur S. T. nga përpara; ajo ishte 11 vjeçare kur ai e ka parë atë me motrën e saj N. T. dhe ai e dinte se ajo e vijonte shkollën fillore.

252. I pandehuri e ka ditur që S. N. dhe S. T. janë të moshës të njëjtë dhe e ka ditur që S. N. ishte 15 vjeçare. Ai e ka pyetur atë dhe S. N. ia ka treguar moshën e saj. Kur e ka zbuluar moshën e saj, ai ka thënë: “ madje edhe fëmijët sot dinë gjithçka.”
253. Elementet subjektive të veprës penale janë plotësuar. I pandehuri është penalisht përgjegjës për veprimet e tij; ai ka aftësi mendore dhe e ka kryer veprën penale qëllimisht. Ai nuk kishte shoqëri me shoke apo kolegë , ai kishte shoqëri me femra të reja; atij nuk i pengonte nëse ato kishin të dashur , madje edhe nëse ishin të fejuara; ai dilte me ato për të kryer marrëdhënie seksuale; po ashtu edhe me dy në të njëjtën kohë.
254. Për më tepër, gjykata nënvizon se i pandehuri nuk duhej ti ishte i sigurt nëse S. N. ishte nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet, është e mjaftueshme që ai ka supozuar që një rrethanë e tillë është e mundur. Faktet siç janë përshkruar në pikat e mëhershme, moshën e të pandehurit dhe dallimi i moshës ndërmjet të pandehurit dhe S. N., janë rrethana bazuar në të cilat i pandehuri e ka ditur, apo se paku ka supozuar që S. N. ishte nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet, por ai ka vendosur ta kryej veprën.
255. Nuk ka rrethanë e cila do ta mund ta përjashtonte përgjegjësinë penale të tij sipas nenit 25 dhe / apo nenit 26 të KPRK-së.
256. Nuk është i rëndësishëm pretendimi i të pandehurit që S. N. dhe shoqja e saj S. T. ishin ato që propozuan të kenë marrëdhënie seksuale me te, dhe rrjedhimisht nuk e përjashton përgjegjësinë e tij penale.
257. Përfundimisht, për shkak të rrethanave të shpjeguara më lartë, përgjegjësia penale e të pandehurit po ashtu nuk është përjashtuar bazuar në pretendimin e tij që S. N. nga dukja e gjoksit dhe prapnicës të saj është dukur sikur 20 vjeçare.
258. Trupi gjykues konstaton se KPK e ka pasur një dispozitë të veçante vetëm në rastin e përcaktimit të dënimit për bashkimin e veprave dhe nuk e ka cekur dispozitën e veçantë lidhur me dënimin për vepra penale në vazhdimësi sikur që është bërë në KPRK.
259. Trupi gjykues konstaton se vepra penale për të cilën i pandehuri është dënuar përbëhet nga disa vepra të njëjta dhe identike , të cilat i pandehuri i ka kryer në mes _____ dhe _____ ndaj personit të njëjtë [S. N.].Ai ke shfrytëzuar situatën e njëjtë dhe të njëjtën kohë të lidhjes ; të gjitha veprat janë kryer në të njëjtin vend [shtëpinë e tij në _____]; dhe me qëllim të njëjtë [për të kryer marrëdhënie seksuale].

260. Trupi gjykues konsideron që në rast të dhunimit të përsëritur [në këtë rast keqpërdorimi seksual] e të njëjtës viktimë nga i njëjti kryes, ndërtimi i veprës penale në vazhdimësi është i mundur , nëse vepra është kryer në kuadër të kornizës e një gjendjeje të krijuar, dhe nëse ekzistenca e të gjitha kushteve për më shumë vepra identike sipas vlerës jetësore dhe logjike lidhet në një aktivitet kriminal unik.
261. Sipas teorisë dhe praktikës gjyqësore, përsëritja e marrëdhënies nga i njëjti kryes në të njëjtën viktimë , në të njëjtin rast dhe kur marrëdhëniet e veçanta janë kryer si ngjarje kohore të ndara, atëherë ekziston vetëm një vepër penale të dhunimit [në këtë rast keqpërdorimi seksual], dhe jo bashkim.
262. Trupi gjykues konstaton se interpretimi i tillë do të zbatohet sipas nenit 3, paragrafit (2) të KPRK-së pasi që është më i favorshëm për të pandehurin.

B. Akuza 2

263. I pandehuri e ka kryer veprën penale të *mundësimit të prostitucionit në tentativë*, në kundërshtim me nenin 201, paragrafi (4) lidhur me paragrafin (1) dhe nenin 20 të KPK-së. Në këtë nen thuhet:
- (1) Kushdo që me dije rekruton, organizon ose ndihmon një person tjetër apo ia lëshon lokalet një personi tjetër për qëllime të prostitucionit dënohet me gjobë ose burgim deri në tre vjet.*
- [...] (4) Nëse vepra penale nga paragrafi 1, 2 ose 3 i këtij neni kryhet kundër personit të moshës mes gjashtëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjet, kryerësi dënohet me burgim pre një deri në dhjetë vjet. [...]*
264. Elementet objektive të veprës penale janë plotësuar. I pandehuri i ka propozuar S. N. të ketë marrëdhënie seksuale me vëllain e tij , me shokun e tij nga _____ dhe me një serb.
265. Edhe pse i pandehuri ka mohuar ta këtë ofruar S. N. këtyre personave , S. N. e ka përshkuar hollësisht situatën kur ai e ndaloi veturën ku ishte shoku i tij nga _____ dhe i ka thënë atij: “ a të pëlqen kjo?” Sa i përket serbit dhe vëllait të tij , i pandehuri fliste me ata përmes telefonit dhe pastaj i ka treguar S. N. për bisedën.

266. I pandehuri ka vepruar si ndërmjetësues; ai ka biseduar me ata persona dhe ishte i qartë që ‘të dalësh me atë’ nënkuptonte ‘të bësh seks me atë.’ Ai po ashtu ishte i qartë kur i ka thënë S. N. që një person i tillë do ti jepte asaj 50 euro dhe ajo do të duhet t’ia jepte atij 25 euro.
267. S. N. ishte 16 vjeçare kur i pandehuri e propozoi atë personave të ndryshëm dhe ai e ka ditur moshën e saj. Pasi që ata u ndanë para se ajo i mbushi 18 vjet, koha e kryerjes e veprës penale i korrespondon asaj periudhe.
268. Elementet subjektive të veprës penale janë plotësuar. I pandehuri është penalisht përgjegjës për veprimet e tij; ai ka aftësi mendore dhe qëllimisht i ka ndërmarrë veprimet në drejtim të kryerjes të veprës penale.
269. Pasi që S. N. nuk pranoi të ketë marrëdhënie seksuale me personat të cilit ia propozoi i pandehuri, vepra nuk është përfunduar.
270. Nuk ka rrethana që do ta përjashtonin përgjegjësin e tij penale sipas nenit 25 dhe / apo nenit 26 të KPRK-së.

C. Akuza 3

271. Gjykata ka shpallur të pandehurin të pafajshëm dhe nuk mban përgjegjësi penale për veprën penale të *sulmit seksual* në kundërshtim me nenin 195, paragrafi (4) lidhur me paragrafin (1) të KPK-së.
272. Gjykata konstaton si të vërtetuar faktin se i pandehuri e ka njohur S. T.. Ai e njoftoi atë përmes motrës të saj N. T..
273. Bazuar në provat të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor , gjykata konstaton se është vërtetuar që S. T. ishte 15 vjeçare kur i pandehuri ia ka dhënë asaj unazën për ditëlindjen e saj dhe që ata janë ndarë ne _____ të _____; kjo po ashtu vërteton se ata kanë pasur lidhje.
274. Në fotografi që janë bërë më _____ , mund të shihen i pandehuri dhe S. T.; duke u puthur; lakuriq në poza erotike. Nga këto fotografi gjykata erdhi në përfundim se ata kanë kryer marrëdhënie seksuale më herët dhe jo kur S. T. ishte 16 vjeçare sikur që i pandehuri ka pretenduar.

275. Ishte dëshmia e S. N. që i pandehuri ka filluar ta prekte S. T. kur ishin bashkë në veturë; që i pandehuri e ka ditur moshën e S. T. dhe i pandehuri kishte marrëdhënie seksuale me S. T.. Dhe deklarata e S. N. ishte e vetmja prove e paraqitur gjatë shqyrtimit gjyqësorë.
276. Bazuar në provë të tilla, gjykata nuk mund ta konstatojë të vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm që i pandehuri e ka kryer veprën penale siç përshkruar në dispozitiv. Nuk kishte prova të mjaftueshme se i pandehuri e ka prekur S. T. me qëllim seksual përderisa ai ishte e ulur në ulësen afër ulëses e shoferit, ndërsa S. N. i e ulur në ulësen e prapme.
277. Prandaj elementet e nenit 195 nuk janë plotësuar dhe i pandehuri lirohet nga kjo akuzë.

D. Akuza 4

278. Gjykata e shpalli të pandehurin të pafajshëm dhe nuk mban përgjegjësi penale për veprën penale të *keqpërdorimit seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet*, në kundërshtim me nenin 198, paragrafi (1), i lidhur me paragrafin (5), nën-paragrafin (3) dhe (4) të KPK-së.
279. Gjykata konstatoi të vërtetuar faktin se i pandehuri kishte disa herë marrëdhënie seksuale me S. T..
280. Sipas fotografisë ²⁰⁵ gjykata konstatoi të vërtetuar që S. T. ishte duke pirë birrë, alkoolikë dhe jo-alkoolikë.
281. Në provat e paraqitura gjatë procedurës të provave gjykata nuk e konstatoi përtej dyshimit të arsyeshëm që më _____ në orët e _____, i pandehuri e ka kryer veprën penale sikur që del nga përshkrimi faktik nën akuzën 4.
282. Prandaj, gjykata konstatoi se elementet e nenit 198 nuk janë plotësuar dhe duhet ta liroj të pandehurin nga kjo akuze.

E. Akuza 5

²⁰⁵ Lista e provave nr. 13 ; kopjet nga CD-ja, faqe 13

283. Gjykata e shpalli të pandehurin të pafajshëm dhe se nuk mban përgjegjësi ligjore për veprën penale të *dhunimit*, në kundërshtim të nenit 193, paragrafi (4) lidhur me paragrafin (2) nën-paragrafin (2) të KPK-së.
284. Gjykata konstatoi të vërtetuar faktin se i pandehuri kishte disa herë marrëdhënie seksuale me S. T..
285. Sipas fotografisë ²⁰⁶ gjykata konstatoi të vërtetuar që S. T. ishte duke pirë birrë, alkoolikë dhe jo-alkoolikë.
286. Bazuar në certifikatën e lindjes , gjykata e konstatoi si të vërtetuar që S. T. ishte 16 vjeçare më _____ dhe në _____ të vitit _____ ishte pothuajse 18 vjeçare.
287. Sipas provave të paraqitura gjate procedurës të provave , gjykata nuk e konstatoi të vërtetuar përtej dyshimit të bazuar m se në kohën dhe datën e panjohur në vitin _____ deri në _____ të vitit _____ , i pandehuri e detyroi S. T. të ketë marrëdhënie seksuale pa pëlqimin e saj dhe që pas që ajo ka refuzuar , i pandehuri qëllimisht i shkaktoi intoksikim me alkool, ia tregoi asaj armen duke i thënë : “ askush nuk të me bëjë asgjë mua , as _____ e as policia sepse te gjithë i mbaj në xhepin tim.”
288. Po ashtu nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm që S. T. për shkak kësaj kur shkoi në shtëpi të saj tentoi të vetëvritet duke pirë sedative dhe domestos , dhe si rezultat ishte shtrire në spital. Për më tepër, sikur që është shpjeguar hollësisht në këtë arsyetim më parë, kjo ka ndodhur në vitin _____ dhe jo në vitin _____.
289. Prandaj, gjykata konstaton se elementet e nenit 193 nuk janë plotësuar dhe duhet ta liroj të pandehurin nga kjo akuzë.

F. Akuza 6

290. Gjykata e shpalli të pandehurin të pafajshëm dhe se nuk mban përgjegjësi ligjore për veprën penale të *dhunimit*, në kundërshtim të nenit 193, paragrafi 3, nën- paragrafi (4) të KPK-së.
291. Gjykata e konstatoi të vërtetuar se i pandehuri dhe N. T. janë njoftuar kur N. T. ka shkuar te një francez për të gjetur marrëveshje për te ofruar shërbim të pastrimit dhe

²⁰⁶ Lista e provave nr. 13 ; kopjet nga CD-ja, faqe 13

më vonë, kur ajo filloi të punoj për R. A. 2., ata janë parë pothuajse për çdo ditë pasi që i pandehuri ishte vozitësi i tij.

292. Gjykata po ashtu e konstatoi të vërtetuar se N. T. dhe i pandehuri ishin në lidhje për se paku 3 deri 4 vite dhe se ata disa herë kanë kryer marrëdhënie seksuale në shtëpinë e tij.
293. Bazuar në provat e administruara gjate shqyrtimit gjyqësor dhe bazuar në deklaratat e N. T., gjykata nuk e konstatoi të vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm që i pandehuri në _____ e vitit ____ rreth orës __:__ në shtëpinë e tij në anën _____ t. _____ e kishte dehur atë me disa substanca të dyshimta , kur e ka përgatitur kafën për atë m dhe kur ka filluar ta pinte ajo ka filluar të ndihej e trullosur dhe më pas e ka humbur vetëdijen.
294. Po ashtu nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm që i pandehuri ka kryer veprën seksuale me N. T. përderisa ajo ishte pa vetëdije dhe se e ka xhiruar me kamerë.
295. Prandaj, gjykata konstatoi se elementet nga neni 193 nuk janë plotësuar dhe duhet ta liroj të pandehurin nga kjo akuze.

G. Akuza 7

296. I pandehuri ka kryer veprën penale të *sulmit seksual në tentativë* në kundërshtim me nenin 195, paragrafi (2) nën-paragrafi (3) lidhur me nenin 20 të KPK-së. Në këtë nen thuhet:

[...] (2) *Kushdo që e prek personin tjetër me qëllim seksual ose e cyt personin tjetër të prekë kryerësin a personin e tretë me qëllim seksual:*

[...] 3) *Duke shfrytëzuar një situatë në të cilën personi tjetër i tillë është i pambrojtur dhe siguria e viktimës është në rrezik; dënohet me burgim prej një deri në shtatë vjet.*

[...]

297. Elementet objektive të veprës penale janë plotësuar. Gjykata i konstatoi të vërtetuara faktet në vijim.

298. A. L. ka vuajtur nga sëmundja e lëkurës; ajo ka pasur akne në fytyrën e saj dhe i pandehuri i propozoi asaj dhe e dërgoi të një specialist i lëkurës në _____
299. Ishte në _____ të _____ të vitit _____ kur ai e mori atë në _____ të _____ me veturën e tij dhe e dërgoi atë te mjeku ne _____ të _____.
300. I pandehuri e ka ditur moshën e A. L.; ai ka deklaruar se në atë kohë ajo ishte duke e përfunduar shkollën dhe A. L. ishte në vitin e parë. Pasi që ajo nuk e kuptonte _____, i pandehuri ishte i pranishëm kur mjeku e ka pyetur A. L. për të dhënat e saj personale.
301. A. L. është pajtuar me shoqen H. P. që ajo të vijë me te; ato e priten të pandehurin por ai ka thënë H. P. që mos ti shoqëroj. Kështu që A. L. ka shkuar vetëm me të pandehurin ne _____.
302. A. L. është e kombësisë _____; ajo është rritur në pjesën veriore; ajo ishte e njohur me rrethanat në mes të _____ dhe _____; ajo kishte frikë nga _____; për më tepër ajo kishte frikë edhe nga i pandehuri pasi që nuk e njihnte mirë dhe ai ishte shume më i moshuar se ajo.
303. Pasi që mjeku e ekzaminoi A. L., ajo ia përshkroi A. L. 3 deri 4 lloje të ilaçeve. I pandehuri e mori A. L. dhe i kërkoi ilaçet; por nuk mund ti gjente të gjitha në një farmaci.
304. Gjate kthimit; ende diku ne _____ të _____; vend i cili ishte i panjohur për A. L., i pandehuri e ka ndaluar veturën afër pompës të benzinës dhe i ka propozuar të kryejnë marrëdhënie seksuale në shkëmbim për blerje të ilaçeve. Ai filloi ta prekte në krah dhe tentoi ta puth. A. L. e ka kthyer kokën në anën tjetër , filloi të bërtiste dhe qante ; më pas ka ikur nga vetura , ka vrapuar deri të ura më e afërt dhe ka dashur të hidhej nga aty.
305. Në anën subjektive i pandehuri ishte plotësisht i vetëdijshëm për veprimet e tij dhe e kishte për qëllim të veproj ashtu. I pandehuri është penalisht përgjegjës për veprimet e tij; ai ka aftësi mendore dhe ai qëllimisht ka ndërmarrë veprime në drejtim të kryerjes të veprës penale.
306. Mënyra e veprimit e të pandehurit e takimit e të miturve dhe femrave të reja, duke i dërguar ato për dreke apo darkë, duke i dhënë atyre shume të ndryshme të parave, duke i

ofruar atyre shërbime të ndryshme , p. sh duke e dërguar atë diku, duke i gjetur punë , duke i dërguar të mjeku , etj. Këto femra ishin të mitura apo shumë të reja , ende duke e vijuar shkollën, pa punësuar, pa para, të varura nga përkrahja e familjes.

307. Nuk ishte qëllimi i të pandehurit që ta krijoj një lidhje të dyanshme me femra; nuk i pengonte nëse femra kishe të dashur apo ishte e fejuar ; qëllimi i tij ishte që femra të bëhej e varur nga ai dhe të ketë marrëdhënie seksuale.
308. Arsyeja e mos marrjes të H. P. me ata të mjeku ishte të jetë vetëm me A. L.. Me blerjen e ilaçeve, qëllimi i tij ishte të ketë marrëdhënie seksuale më atë; jo në veturë por në shtëpinë e tij e cila po ashtu ishte në _____ .
309. Pasi që A. L. nuk pranoi të ketë marrëdhënie seksuale me të pandehurin , ajo nuk e lejoi atë ta prekte dhe ta puthte, ajo iki nga vetura , vepra nuk është përfunduar.
310. Nuk ka rrethana që do ta përjashtonin përgjegjësinë penale e tij sipas nenit 25 dhe/apo nenit 26 të KPRK.

H. Akuza 8

311. I pandehuri e ka kryer veprën penale të dhunimit në kundërshtim të nenit 193, paragrafi (1) KPK-së . Në këtë nen thuhet:

(1) Kushdo që e detyron personin tjetër për të kryer akt seksual pa pëlqimin e personit të tillë dënohet me burgim prej dy vite deri në dhjetë vjet. [...]

312. Elementet objektive të veprës penale janë plotësuar. Gjykata e konstaton të vërtetuara faktet në vijim siç janë paraqitur më poshtë.
313. A. F. e ka takuar të pandehurin përmes S. Te. dhe kur janë takuar për herë të parë i pandehuri i ka dërguar te dyja dhe motrën e A. F., B. F. në restorantin _____ në _____ .
314. A. F. dhe i pandehuri kanë kryer marrëdhënie seksuale për herë të parë në shtëpinë e tij; i pandehuri i e prekte atë, ajo nuk e lejonte ta puthte ne gojë pasi që është ndjere e neveritur ; ajo vetëm qëndronte aty e shtrirë; i pandehuri e depërtoi; A. F. tentoi që ta largoi me duar dhe duke i thënë. “ largohu.” I pandehuri ia dha asaj 50 euro. Më vonë ata kryen marrëdhënie seksuale disa herë; gjithnjë në shtëpinë e tij. Pasi që A. F. nuk

dëshironte që njerëzit ta shohin me të pandehurin duke shkuar në shtëpinë e tij; i pandehuri i ka thënë: “ vetëm përkule kokën.” Ajo ishte në shtëpinë e tij katër herë në javë; shumicën e herrave ata kryen marrëdhënie seksuale, ndonjëherë A. F. nuk donte ; kështu që ata vetëm qëndronin për një kohë, dhe më pas ai e kthente. Kur ishte në shtëpinë e tij, i pandehuri i jepte shuma te vogla te parave 10, 20 euro, por jo çdo herë.

315. Sidoqoftë, A. F. në fillim ishte më te pandehurin vullnetarisht. Pas gjashtë muajve ajo i ka thënë të pandehurit se dëshiron të ndahej nga ai. I pandehuri është pajtuar me kusht që ajo t’ia kthente paratë që ai a kishte dhënë. Ajo nuk ka pasur para; kështu që i pandehuri i ka thënë se në këtë rast ajo duhej të vinte për ti kthyer paratë , madje tri herë në ditë. Ai e telefononte atë për çdo ditë dhe në rast kur nuk është përgjigjur , ai i thoshte asaj gjera që do t’ia bënte.²⁰⁷
316. Motra e A. F., B. F. e ka ditur se A. F. dhe i pandehuri kanë pasur marrëdhënie seksuale; ajo nuk ishte në të njëjtën dhomë por A. F. e merrte atë kur shkonte në shtëpinë e tij dhe B. F. e ka ditur se A. F. kishte marrëdhënie seksuale me të pandehurin. B. F. i kërkoi A. F. që të ndahet nga ai dhe ajo ishte dëshmitare kur A. F. i tha që dëshiron të ndahet më te; dhe B. F. e ka dëgjuar të pandehurin kur i ka kërkuar t’ia kthej 900 euro ose ai do të vinte në shtëpinë e tyre dhe do ti tregonte familjes të saj.
317. A. F. ishte e detyruar të ketë marrëdhënie seksuale me të pandehurin; të vazhdoj pa pëlqimin e saj. Se pari ajo nuk kishte para qe i pandehuri ia kërkoi ti kthej. Se dyti, ajo ishte e frikësuar që i pandehuri do të realizonte atë çfarë i thoshte asaj. Ai i thoshte asaj që do të bisedonte me të dashurin e saj; ti tregonte për lidhjen e tyre; ai do të vinte në shtëpinë e saj që ta turpëronte atë dhe i thoshte si në vijim: “ Nëse unë ndonjëherë ë kërkoj të dalësh dhe ti refuzon, do të kesh probleme me mua.” , “ do të të turpëroj”; do të vij brenda në shtëpinë tende, nuk frikësohem”, Dëshiroj të të shoh saktë në orën gjashtë dhe nëse nuk paraqitesh , do të vij të të marr”, dhe “ Jo. Ti asnjëherë nuk duhet të ndahesh nga unë ose duhet ti kthesh 900 euro, ose do të vij ne shtëpinë tende, Do ti tregoj familjes tende.”
318. Këto fjalë përfaqësojnë kërcënime dhe bazuar në këto A. F. është detyruar që ti përshtatet në një sjellje të caktuar; kërcënimet ishin serioze dhe për shkak atyre A. F.

²⁰⁷ Shih piken 209.

ka vazhduar të ketë marrëdhënie seksuale me të pandehurin. Me kërcënime të tilla i pandehuri në mënyrë të qartë e ka shprehur se çfarë lloj dëmi A. F. do të vuante nëse ajo nuk do të vazhdonte të ketë marrëdhënie seksuale me te. A. F. ishte shume e vetëdijshme për kërcënime të tilla. Realizimi i kërcënimeve të tilla do të kishte ndikim në vetë A. F. sikur edhe në anëtarët e saj të familjes.

319. Të gjitha kërcënime ishin të realizueshme; A. F. kishte çdo bazë të besonte që i pandehuri do të realizonte atë çfarë i thoshte asaj; dhe rrjedhimisht kërcënimet konsiderohen sikur serioze. Nuk është jo e rëndësishme nëse i pandehuri me të vërtet do të bënte atë çfarë i ka thënë asaj. Paneli konsideron se realizimi i kërcënimeve të tilla mund të pritej, pasi që në rastin e S. N. ai nuk pati asnjë hezitim të shkonte të nëna e saj dhe te shtëpia e saj.

320. Dhe përfundimisht kërcënimet ishin serioze sepse kërcënimet ishin adekuate për të krijuar qëllimin e kërcënimeve të tilla në proporcion me dëmin e kërcënuar. Edhe pse ne ditët e sotme femrat në shoqëri janë shume shpesh mire të edukuara dhe konsiderohen të pjesëtare të barabarta në familje me liri që ta organizojnë dhe të jetojnë në një stil modern perëndimor , shume zakone dhe tradita janë ende të gjalla. Pavarësisht nga barazia ligjore dhe provueshmëria, ekzistojnë shume familje të cilat janë ende shoqëri patriarkale bazuar në predominimin e mashkullit, ku femrat vendosen në role vartëse. Nëse i pandehuri do ti realizonte kërcënimet dhe do të vinte te familja e A. F., vëllezërit do ta kishin mbrojtur atë, pasi që i pandehuri ishte person i moshuar; vëllezërit “ do të shkaktonin shume probleme nga kjo” dhe “ gjerat do të ktheheshin në të keq” sikur që B. F. ka deklaruar.²⁰⁸

321. Në anën subjektive i pandehuri ishte plotësisht i vetëdijshëm për veprimet të tij dhe ai e kishte për qëllim të veproj ashtu. I pandehuri është penalisht përgjegjës për veprimet e tij; ai ka aftësi mendore dhe ai qëllimisht ka ndërmarrë veprime në drejtim të kryerjes të veprës penale.

322. Veprimet e të pandehurit plotësisht përputhen më mënyrën e tij të veprimit. A. F. ishte një femër e re , e shkurorëzuar, e papunësuar pa para, e varur nga përkrahja e familjes të saj. Ai i pagoi asaj drekë; ai i ka dhënë asaj shume të vogla të parave [prej 10,20 euro apo madje 50 euro. Edhe pse ai ka thënë se ata ishin sikur burrë dhe grua të

²⁰⁸ Procesverballi i seancës të shqyrtimit gjyqësor më 2 dhjetor 2014, faqe 14.

pamartuar, ai nuk e kishte për qëllim të krijonte lidhje serioze me atë. Qëllimi i tij ishte të ketë marrëdhënie seksuale ; nuk i pengonte nëse A. F. kishte të dashur.

323. Nuk ka rrethana që do ta përjashtonin përgjegjësinë e tij penale sipas nenit 25 dhe/ apo nenit 26 të KPRK .
324. Sikur që tashme është shpjeguar në akuzën 1, trupi gjykues konstaton se KPK e ka pasur një dispozitë të veçante vetëm në rastin e përcaktimit të dënimit për bashkimin e veprave penale dhe nuk e ka çekur dispozitën e veçantë lidhur me dënimin për vepra penale në vazhdimësi sikur që është bërë në KPRK.
325. Trupi gjykues konstaton se vepra penale e dhunimit për të cilën i pandehuri është dënuar, përbëhet nga disa vepra të njëjta dhe identike , të cilat i pandehuri i ka kryer në periudhën në mes të _____ vitit ____ dhe datës __ _____ ____ ndaj personit të njëjtë [A. F.].Ai ke shfrytëzuar situatën e njëjtë dhe të njëjtën kohë të lidhjes; të gjitha veprat janë kryer në të njëjtin vend [shtëpinë e tij në _____ _____]; dhe me qëllim të njëjtë [për të kryer marrëdhënie seksuale].
326. Trupi gjykues konsideron që në rast të dhunimit të përsëritur e të njëjtës viktimë nga i njëjti kryes, ndërtimi i veprës penale në vazhdimësi është i mundur, nëse vepra është kryer në kuadër të kornizës e një gjendjeje të krijuar, dhe nëse ekzistenca e të gjitha kushteve për më shumë vepra identike, sipas vlerës jetësore dhe logjike lidhet në një aktivitet kriminal unik.
327. Sipas teorisë dhe praktikës gjyqësore, përsëritja e marrëdhënies nga i njëjti kryes në të njëjtën viktimë, në të njëjtin rast dhe kur marrëdhëniet e veçanta janë kryer si ngjarje kohore të ndara, atëherë ekziston vetëm një vepër penale të dhunimit, dhe jo bashkim.
328. Trupi gjykues është i vetëdijshëm se vepra penale ka filluar ne _____ të viti ____ kur KPK ishte në fuqi, ka vazhduar dhe ka përfunduar me __ _____ ____ kur tashme KPRK ishte në fuqi. Edhe pse vepra penale e dhunimit ka përfunduar kur është kryer vepra e fundit e cila është e përfshirë në veprën penale te dhunimit ne vazhdimësi, trupi gjykues konsideron që sipas nenit 3, paragrafi (2) të KPRK, do të zbatohen dispozitat ligjore të KPK-së pasi që ligji në fuqi ne kohën kur vepra penale është kryer është më i favorshëm për të pandehurin.

Akuza 9

329. Gjykata e shpalli të pandehurin të pafajshëm dhe se nuk mban përgjegjësi penale për veprën penale të *mundësimit ose detyrimit ne prostitucion* në kundërshtim me nenin 241, paragrafi (3), referuar nenit 228, paragrafi (8) i KPRK.
330. Gjykata e konstatoi të vërtetuar se i pandehuri ka pasur disa herë marrëdhënie seksuale me A. F. me anë të kërcënimit pa pëlqimin e saj.
331. Në rastin e tanishëm , trupi gjykues konstaton se çështja e bashkimit mund të rezultojë. Sistemi i ligjit penal në Kosovë zbaton rregullat e teorisë të bashkimit; bashkimit real dhe ideal. KPP nuk përmban asnjë dispozitë që ka të bëjë me këtë çështje përveç kur përcakton rregullat e dënimit nëse kryesi kryen me shumë vepra penale me një apo me shumë veprime për të cilat ai apo ajo është duke u gjykuar në të njëjtën kohë sikur që thuhet në nenin 80 të KPRK-së.
332. Trupi gjykues konstaton se veprimet e paraqitura në përshkrimin faktik dhe provat që vërtetojnë faktet kyçe nuk i mbështesin elementet e veprës penale të mundësimit ose detyrimit ne prostitucion. Për më tepër, veprimet e kërcënimit tashmë janë konsideruar si elemente objektive të veprës penale nën akuzën 8.
333. Prandaj, gjykata konstatoi se elementet e nenit 241 nuk janë plotësuar dhe duhet ta liroj të pandehurin nga kjo akuze.

VIII. Përcaktimi i dënimit

334. Sipas nenit 73 të KPRK dhe në mënyrë të ngjashme të nenit 64 të KPK-se, gjykata do të përcaktojë dënimin për veprën penale brenda kufizimeve të caktuara me ligj për atë veprën penale, duke marrë parasysh qëllimin e dënimit, parimet e përcaktuara në ligj dhe rrethanat lehtësuese apo rënduese lidhur me veprën penale të caktuar ose me dënimin, në veçanti shkallën e përgjegjësisë penale, motivet për kryerjen e veprës, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer vepra, sjelljen e mëparshme të kryesit, pranimin e fajit dhe rrethanat personale të kryesit dhe sjelljen e tij

pas kryerjes së veprës penale. Dënimi duhet të jetë në proporcion me peshën e veprës dhe me sjelljen dhe rrethanat e kryesit.

335. Paragrafët (2) dhe (3) të nenit 74 të KPRK numërojnë rrethanat renduese dhe lehtësuese që do të merren parasysh gjatë përcaktimit të dënimit por shprehimisht thotë se këto rrethana të përcaktuara nuk janë jo shteruese. KPK nuk kufizon shprehimisht se çfarë mund të konsiderohet si rrethane renduese apo lehtësuese.
336. Bazuar në këtë , gjatë përcaktimit të dënimit , trupi gjykues ka marr parasysh rrethanat renduese në vijim. I pandehuri ishte person i pjekur, i rritur i moshës afër 60 vjeçare , në të vërtet 57,58 apo 59, ndërsa viktimat ishin të moshës 15 deri 21 vjeçare në kohën kur është kryer vepra penale; kishte një dallim substancial në moshe në mes të pandehurit dhe viktimës. Disa nga viktimat ishin ende duke vijuar shkollën ; ishin të papunësuar, me status të dobët ekonomik. I pandehuri i ka zgjedhur ato me paramendim; qëllimi i tij ishte të ketë marrëdhënie seksuale me viktima; ai i ka dhënë atyre shuma të ndryshme të parave. Kohëzgjatja e krimit ishte më tepër se tri vite , duke mos treguar respekt ndaj kodit të sjelljes i cili zbatohet në _____. Nuk ka treguar keqardhje.
337. Gjykata nuk ka gjetur rrethana lehtësuese në favor të pandehurit , përveç faktit se i pandehuri nuk ka dosje penale dhe se pala e parë e dëmtuar S. N. ishte mbi moshën 16 vjeçare dhe ishte me provoje kur është kryer vepra penale. Megjithatë, rrethanat në të cilat janë kryer veprat penale bartin një peshë të tillë të lartë që gjykata nuk ka mundur ta gjej stimulimin për ta shqiptuar dënimin më të butë.
338. Sipas nenit 3, paragrafi (1) të KPRK-së dhe në mënyrë të ngjashme sipas nenit 2, paragrafi (2) të KPK-së ndaj kryesit do të zbatohet ligji në fuqi në kohën kur është kryer vepra penale.
339. I pandehuri është dënuar për vepra penale nën akuzën 1, akuzën 2, akuzën 7 dhe akuzën 8. Ai i ka kryer veprat penale kur KPK ishte në fuqi, i cili ka hyrë në fuqi më 6 prill 2004 me emër Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës dhe është ndryshuar më 6 nëntor 2008 thjesht me ndryshimin e emrit në atë Kodi Penal i Kosovës.
340. KPRK i ri ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013, prandaj para vendimit përfundimtar në këtë rast.
341. Sipas nenit 20, paragrafi (3) i KPK-së personi që tenton të kryejë vepër penale dënohet më butë se sa kryesi në pajtim më nenin 65, paragrafi (2) i cili përcakton se dënimi i

shqiptuar për tentative nuk duhet të jetë më i lartë se tri të katërtat e maksimumit të dënimit të paraparë për vepër penale.

342. Sipas nenit 28, paragrafi (3) KPRK-së personi që tenton të kryejë vepër penale ; dënimi mund të reduktohet. Gjykata po ashtu mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit në rastin kur kriteret të përcaktuara në nenin 75, paragrafi (1) janë plotësuar.

343. Sipas nenit 386, paragrafi (2) i KCCP-se trupi gjykues nuk është i detyruar ndaj dispozitave të përcaktuara nga prokurori. Për më tepër, në nenin 3, paragrafi (2) KPRK-së , sikur edhe në nenin 2, paragrafi (2) KPK-së thuhet se në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, , atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm. Trup gjykues ka konkluduar se elementet thelbësore e të gjitha veprave penale për të cilat i pandehuri është dënuar ishin të njëjta sikur në KPK edhe në KPRK.

344. Kështu që trupi gjykues duhej ta konsideroj për secilën akuze se cilat dispozita lidhur me dënimin , nëse ndonjë, do të ishin më të favorshme për të pandehurin.

345. Për *keqpërdorimin seksual të personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet* ne kundërshtim me nenin 198, paragrafi (1) i KPK-së (akuza 1) KPK parasheh burgim prej 1 deri 10 vjet. Sipas nenit 65, paragrafi (1) dhe duke marr parasysh rrethanat e sipërpërmendura renduese dhe lehtësuese , trupi gjykues do të dënonte të pandehurin më 5 vjet burgim.

346. Vepra e njëjtë penale është përfshire në KPRK në nenin 235, paragrafi (1) nen-paragrafi (1.1) lidhur me nenet 230, paragrafi (1) dhe 228, paragrafi (1) që parashohin burgim prej pesë deri njëzet vite. Sipas nenit 73 dhe 74, paragrafët (2) dhe (3) dhe duke marr parasysh rrethanat e sipërpërmendura renduese dhe lehtësuese trupi gjykues do ta dënonte të pandehurin me 9 vjet burgim.

347. Duke i marr parasysh dënimet, duke peshuar me kujdes kriteret renduese dhe lehtësuese te dënimit të parapara në KPK dhe KPRK ndaras sikur edhe dënimet e shqiptuara që i pandehuri do ti kishte marr në rastin kur KPK dhe KPRK do të zbatoheshin, trupi gjykues konstaton se neni 198, paragrafi (1) i KPK-se është më i favorshëm se sa neni 235, paragrafi (1) nen-paragrafi (1.1) KPRK-së.

348. Bazuar në këtë i pandehuri është dënuar me 5 vjet burgim sipas nenit 38, paragrafi (2) i KPK-së .
349. Për *tentim të mundësimit të prostitucionit* në kundërshtim me nenin 201, paragrafi (4) lidhur me nenin (1) dhe nenin 20 të KPK-së (akuza 2), KPK parasheh burgim prej 1 deri 10 vite. Dënimi maksimal për tentim është i dënueshëm 75% të dënimit maksimal të paraparë me KPK. Sipas nenit 65, paragrafi (1) dhe duke marr parasysh rrethanat e sipërpërmendura renduese dhe lehtësuese , trupi gjykues do ta kishte dënuar të pandehurin për tentim të veprës penale të mundësimit të prostitucionit me 3 vite burgim.
350. Vepra e njëjtë penale është përfshire në KPRK në nenin 241, paragrafi (4) lidhur me paragrafin (1) dhe nenin 28 i cili parasheh dënim me gjobë dhe burgim prej 1 deri 10 vite. Duke ju referuar tentimit, nuk ka reduktim mandator ne periudhën maksimale të dënimit; për më tepër trupi gjykues nuk ka gjetur asnjë arsye që të reduktoj dënimin sipas nenit 28, paragrafi (3) dhe nenit 75, paragrafi (1), nën-paragrafi (1.1). Sipas neneve 73 dhe 74, paragrafëve (2) dhe (3) dhe duke marr parasysh rrethanat e sipërpërmendura renduese dhe lehtësuese trupi gjykues do ta dënonte të pandehurin me 3 vite burgim dhe gjobë të 1000 euro.
351. Duke i marr parasysh dënimet, duke peshuar me kujdes kriteret renduese dhe lehtësuese te dënimit të parapara në KPK dhe KPRK ndaras sikur edhe dënimet e shqiptuara që i pandehuri do ti kishte marr në rastin kur KPK dhe KPRK do të zbatoheshin, trupi gjykues konstaton se neni 201, paragrafi (4) lidhur me paragrafin (1) dhe nenin 20 i KPK-së është më i favorshëm se neni 241, paragrafi (4) lidhur me paragrafin (1) dhe nenin 28 të KPRK-së.
352. Bazuar në këtë i pandehuri dënohet me 3 vite burgim sipas nenit 38, paragrafi (2) i KPK-së.
353. Për *tentim të sulmit seksual* në kundërshtim me nenin 195, paragrafi (2), nën-paragrafi (3) lidhur me nenin 20 të KPK-së (akuza 7), KPK parasheh burgim prej 1 deri 7 vjet. Dënimi maksimal për tentim është i dënueshëm 75% të dënimit maksimal të paraparë me KPK. Sipas nenit 65, paragrafi (1) dhe duke marr parasysh rrethanat e sipërpërmendura renduese dhe lehtësuese , trupi gjykues do ta kishte dënuar të pandehurin për tentim të veprës penale të sulmit seksual me 3 vjet burgim.

354. Vepra e njëjtë penale është përfshire në KPRK në nenin 232, paragrafi (2), nën-paragrafi (2.3) lidhur me nenin 28 i cili parasheh dënimin prej 1 deri 7 vjet. Duke ju referuar tentimit, nuk ka reduktim mandator ne periudhën maksimale të dënimit; për më tepër trupi gjykues nuk ka gjetur asnjë arsye që të reduktoj dënimin sipas nenit 28, paragrafi (3) dhe nenit 75, paragrafi (1), nën-paragrafi (1.1). Sipas neneve 73 dhe 74, paragrafëve (2) dhe (3) dhe duke marr parasysh rrethanat e sipërpërmendura renduese dhe lehtësuese trupi gjykues do ta dënonte të pandehurin me 3 vite burgim.
355. Duke i marr parasysh dënimet, duke peshuar me kujdes kriteret renduese dhe lehtësuese te dënimit të parapara në KPK dhe KPRK ndaras sikur edhe dënimet e shqiptuara që i pandehuri do ti kishte marr në rastin kur KPK dhe KPRK do të zbatoheshin, trupi gjykues konstaton se neni 195, paragrafi (2) nën-paragrafi (3) lidhur me nenin 20 të KPK-se të zbatohen sipas nenit 3, paragrafi (1) i KPRK-së dhe ngjashëm nenin 2, paragrafi (1) i KPK-së.
356. Bazuar në këtë, i pandehuri dënohet me 3 vjet burgim sipas nenit 38, paragrafi (2) i KPK-së.
357. Për *dhunim* në kundërshtim me nenin 195, paragrafi (1) i KPK-së (akuza 8), KPK parasheh dënimin prej 2 deri 10 vjet. Sipas nenit 65, paragrafi (1) duke marr parasysh rrethanat e sipërpërmendura renduese dhe lehtësuese trupi gjykues do ta dënonte të pandehurin me 6 vjet burgim.
358. Vepra e njëjtë penale është përfshire në KPRK në nenin 230, paragrafi (2) i cili parasheh dënimin me burgim prej 3 deri 10 vjet. Sipas neneve 73 dhe 74, paragrafëve (2) dhe (3) dhe duke marr parasysh rrethanat e sipërpërmendura renduese dhe lehtësuese trupi gjykues do ta dënonte të pandehurin me 7 vjet burgim.
359. Duke i marr parasysh dënimet, duke peshuar me kujdes kriteret renduese dhe lehtësuese te dënimit të parapara në KPK dhe KPRK ndaras sikur edhe dënimet e shqiptuara që i pandehuri do ti kishte marr në rastin kur KPK dhe KPRK do të zbatoheshin, trupi gjykues konstaton se neni 195, paragrafi (1) i KPK-se është më i favorshëm se neni 230, paragrafi (2) i KPRK-së.
360. Bazuar në këtë, i pandehuri dënohet me 6 vjet burgim sipas nenit 38, paragrafi (2) i KPK-së.

361. Sipas nenit 71, paragrafi (2) nën -paragrafi (2.2) i KPK-se dënimi unik duhet të jetë më i madh se çdo dënim i veçantë, por dënimi unik nuk mund ta arrijë shumën e të gjitha dënimeve të përcaktuara dhe as të tejkalojë periudhën prej njëzet vjetësh. Prandaj periudha e dënimit unik është 17 deri 20 vjet.
362. Sipas rregullave për matjen për bashkimin e veprave penale sipas nenit 80, paragrafi (2) nën- paragrafi (2.2) të KPRK-së dënimi unik duhet të jetë më i madh se çdo dënim i veçantë, por dënimi unik nuk mund ta arrijë shumën e të gjitha dënimeve të përcaktuara dhe as të tejkalojë periudhën prej njëzet e pesë (25) vjetësh. Prandaj periudha e dënimit unik është 17 deri 25 vjet.
363. Duke marr parasysh dispozitat e lartpërmendura lidhur me rregullat për bashkimin e veprave penale KPK është më i favorshëm se KPRK.
364. Duke marr parasysh dhe duke peshuar me kujdes të gjitha rrethanat e përgjithshëm dhe të veçanta , trupi gjykues shqipton dënimin unik prej 14 vjet të burgimit.

I. Shpenzimet

365. Vendimi mbi shpenzimet siç është përcaktuar në dispozitiv është marr sipas nenit 453, paragrafi (1) dhe (2) i KPP-së.

II. Kalkulimi i kohës se kaluar në paraburgim

366. Sipas nenit 365, paragrafi (1) nën-paragrafi (1.5) i KPK-se koha e kaluar në paraburgim nga data 3 qershor 2013 deri sa aktgjykimi e merr formën e prere do të llogaritet në dënim.

III. Konfiskimi i aseteve

367. Gjykata urdhëron që veturat _____, ngjyre _____ me tabela të regjistrimit të identifikuar ___-___-__ dhe _____, ngjyre _____ të identifikuar me tabela të regjistrimit ___-___-__ të cilat janë konfiskuar përkohësisht nga Policia , do të kthehen menjëherë kur aktgjykimi në këtë rast ta merr formën e prerë.

368. Veturat nuk ishin ne aktakuzë sipas nenit 241, paragrafi (1), nen-paragrafi (1.9) KPP.

IV. Kërkesat pasurore juridike

369. Sipas neneve 458, 459, 460 dhe 463, paragrafëve (1) dhe (2) të KPP-së , gjykata refuzon kërkesat pasuroro juridike të paraqitura nga dëshmitarët R. A. dhe H. P..

370. Sipas neneve të njëjta, palët e dëmtuara S. N., N. T. dhe A. L. janë udhëzuar që ato mund ti paraqesin kërkesat e tyre pasuror juridike në kontest civil.

MJETI JURIDIK : I pandehuri, avokati i tij mbrojtës dhe Prokurori apo palët e dëmtuara brenda 15 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi kanë të drejtë ta paraqesin ankesën sipas neneve 380 paragrafi (1) dhe 381 paragrafi (1) KPP-së. Çdo ankese duhet të paraqitet pranë gjykatës të shkallës së parë sipas nenit 388 paragrafi (1) i KPP-së. .

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICE
P nr. 42/14
12 shkurt 2015

Franciska FISER
Kryetarja e trupit gjykues

Jana Božović
Procesmbajtëse

E përpiluar në gjuhën angleze si gjuhë e autorizuar.